

**PROCESI I RREGULLT LIGJOR
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE
NË FUNKSION TË PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR
(Vështrim Krahases)**

Agron BAJRI

Dorëzuar:
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, me profil e Drejta Publike, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor : Prof. Ass. Dr . Shefqet Muçi

Numri i fjalëve : 57,753

Tiranë, Janar, 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

© Të gjitha të drejtat të rezervuara: Agron Bajri

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull: “**PROCESI I RREGULLT LIGJOR, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE NË FUNKSION TË PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR (Vështrim Krahases)**”; është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Agron Bajri

Tiranë, 2016

ABSTRAKTI

Ky punim ka për qëllim të pasqyrojë në mënyrë sa më të plotë trajtimin në lidhje me procesin e rregullt ligjor, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve në funksion të realizimit të procesit të rregullt ligjor.

Punimi fillon me trajtimin e të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me procesin e rregullt ligjor në aspektin historik, duke trajtuar atë që nga lindja e për të vazhduar më tej me ndryshimet e ndodhura gjatë zhvillimit historik të të drejtave të njeriut, zanafillën e tyre, që nga *'Magna Carta Libertatum'*, e deri në parashikimet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare të ditëve të sotme.

Trajtimi historik është i domosdoshëm, ndaj dhe do të paraqitet në çdo periudhë kohore pasi në saj të tij bëjmë një analizë në lidhje me evoluimin e konceptit të të drejtave të njeriut që në fillimet e saj, për të përfunduar tek ditët e sotme, arrijtjet e bëra dhe përpjekjet për një proces të rregullt ligjor.

Rregullimi që i bën procesit të rregullt ligjor, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, është një pjesë e posaçme e trajtimit të këtij punimi. Sipas parashikimeve të kësaj konevente përcaktohen standardet minimale nën të cilat shteti shqiptar nuk mund të zbresë, në kuadrin e realizimit të të drejtave të individit duke garantuar një proces të rregullt ligjor. Në këtë aspekt, interpretimi i ligjit nga ana e gjykatës duhet të jetë i tillë që të mos kufizojë më tepër, se çka parashikuar Konventa Evropiane, në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të individit.

Ky punim ka si qëllim evidentimin e problematikës me të cilën hasen subjektet e procedimit për realizimin e kërkesave ligjore në funksion të një procesi të rregullt. Problematikat e hasura, tregojnë që praktika evidenton raste të cilat gjejnë zgjidhje të sforcuara, për shkak të mospërshtatjes në mënyrë të plotë me legjislacionin, apo dhe për shkak të interpretimit në mënyrë jo të drejtë të tij. Kostoja e kësaj pasaje bie mbi palën, bie mbi subjektin procedural që është i interesuar për një proces të rregullt ligjor.

Fjalët Kyçe: *proces, rregullsi, ligj, penologji, procedurë, gjykim.*

ABSTRACT

This subject is addressed due process of law, the rights and obligations of entities criminal proceedings. Originally topic addresses the emergence and historical development of human rights, their origins, from 'Magna Carta Libertatum', and to international and domestic legal provisions of today.

Historical treatment is necessary and will therefore appear in any period of time after its due to make an analysis regarding the evolution of the concept of human rights as in its infancy, to be completed in days, achievements and efforts made to a due process.

The regulation that makes due process, the European Convention of Human Rights, is a special part of this paper handling. Is this convention, which provides minimum standards under which the Albanian state cannot come in the framework of realization of rights of the individual by ensuring a fair trial. In this regard, the interpretation of law by the court should be such as not to restrict further, predicting what the European Convention, in relation to rights and fundamental freedoms.

This paper aims at identifying the subjects that faced the proceedings for implementation of legal requirements in the context of a regular process.

Identified problems indicate that identifies practices which case solutions enforced, due to inadequacy in full with the legislation, or because the interpretation and so not fair to him. The cost of this impact falls on the party, falls on procedural entity that is interested in a fair trial.

Key words: *process, orderly, law, penology, procedure, trial.*

FALËNDERIME

Dëshiroj të përcjell një falënderim shumë të singertë tek Universiteti European i Tiranës, i cili na krijoi kushte të përshtatshme për mbarimin e këtij cikli studimesh.

Krijimi i kushteve të përshtatëshme si në mësimdhënie, nëpërmjet një stafi të përzgjedhur profesionistësh, ashtu edhe ambientet që ky fakultet ofron, i dhanë shtysë studimeve të mia dhe përfundimit të tyre.

Një falënderim të veçantë i dedikoj udhëheqësit shkencor të këtij disertacioni Prof. Ass.Dr. Shefqet Muçi, që u përfshi në këtë studim shkencor, me impenjimin e tij maksimal dhe profesionalizmin që e karakterizon.

Shpreh mirënjohje të veçantë për të gjithë bashkëpunëtorët e mi në UET të cilët ndikuan pozitivisht për arritjen e objektivit.

Falenderimin më të përzemërt ia dedikoj familjes time, për mbështetjen që më kanë dhënë gjatë gjithë ciklit të studimeve.

Përfundimi me sukses i këtij disertacioni nga ana ime do t'i shpërblente deri diku, sakrificat e tyre.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	II
ABSTRAKTI	II
Fjalët Kyçe	III
ABSTRACT	IV
Kay words	IV
LISTA E SHKURTIMEVE.....	IX
KAPITULLI I: HYRJE	10
1.1. Hyrje.....	10
1.2. Shtrimi i problemit.....	12
1.3. Qëllimi i studimit.....	16
1.4. Burimet e referimit	18
1.5. Hipoteza / hipotezat e punimit	19
1.6. Pyetjet kërkimore të punimit	20
1.7. Metodatat dhe metodologjia e kërkimit	21
1.8. Mundësitë dhe kufizimet	21
KAPITULLI II: TË DREJTAT DHE PROCESI I RREGULLT LIGJOR	
2.1. Të drejtat e njeriut.....	25
2.1.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut	27
2.1.2. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut	28
2.2. Parimi i ligjshmërisë në Kushtetutë	30
2.3. Parimet e procesit të rregullt ligjor	35
2.3.1 Aspekte praktike të parimeve të procesit të rregullt ligjor.....	41
2.3.2. Prezumimi i Pafajësisë: Neni 6(2).....	46
2.3.3. E drejta për t'u vënë në dijeni brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai kupton dhe në mënyrë të hollësishme: Neni 6(3)a	48
2.3.4. E drejta për kohë dhe lehtësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes: Neni 6(3)b	49
2.3.5. E drejta për t'u mbrojtur vetë ose nëpërmjet ndihmës ligjore të zgjedhur: Neni 6 (3)c	52
2.3.6. E drejta për t'u ballafaquar me dëshmitarët: Neni 6 (3)d.....	55

2.3.7. E drejta për përkthim pa pagesë: Neni 6 (3) e.....	61
KAPITULLI III: INSTRUMENTET LIGJORE PËR REALIZIMIN E NJË PROCESI TË RREGULLT LIGJOR.....	63
3.1. Parimet bazë të punës së gjykatës.....	63
a) Parimi i drejtësisë në dispozicion të të gjithëve.....	63
b) Parimi i barazisë dhe i ndershmërisë	64
c) Parimi i rritjes së besimit të publikut ndaj gjykatave.....	65
3.2. Aksesit në gjykatë.....	68
3.3. Llojet e përfaqësuesve.....	69
3.3.1. Përfaqësuesi Ligjor.....	69
3.3.2. Përfaqësuesi me Prokurë(Vullnetar)	71
3.4. Kuptimi i akteve procedurale në funksion të realizimit të procesit të rregullt ligjor	71
3.5. Kuptimi i juridiksionit.....	74
3.6. E drejta për t’u mbrojtur	76
3.7. Barazia e armëve në proces.....	79
KAPITULLI IV: POZITA E TË PANDEHURIT NË KUADRIN E NJË PROCESI TË RREGULLT LIGJOR.....	98
4.1. Parimet themelore dhe të drejtat e të pandehurit.....	98
4.1.1. Ligjshmëria e heqjes së lirisë së Personit.....	99
4.1.2. Garancitë e Parimeve të së Drejtës Penale.....	105
4.2. Pozita procedurale e të pandehurit	109
4.2.1. E drejta për t’u dëgjuar drejtësisht	110
4.2.2. E drejta për një gjykim publik.....	111
4.2.3. E drejta për gjykatë të përshtatshme	115
4.2.4. E drejta për një gjykim të arsyeshëm	118
4.2.5. E drejta për një proces të rregullt ligjor si një nga standardet e të drejtave dhe lirive themelore në çështjet penale.....	119
4.2.6. E drejta për të mos kontribuar në vetë-inkriminim	122
4.2.7. Barazia në mjete dhe e drejta për t'u vënë në dijeni për faktet e argumentet e palës kundërshtare dhe anasjelltas	124
4.3. Parashikimet ligjore.....	126

4.4. Roli i Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese	128
4.4.1. E drejta për një proces të rregullt ligjor - Neni 42 i Kushtetutës së Shqipërisë	131
4.4.2. Çfarë nënkupton neni 42 i Kushtetutës me proces të rregullt gjyqësor?....	132
KAPITULLI V: ZHVILLIMI I PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE SIPAS PRAKTIKËS TË GJYKATAVE TË HUAJA	135
5.1. Ndryshimi në vite i kuptimit dhe zbatimit të procesit të rregullt ligjor	135
5.1.1. Kuptimi i procesit të rregullt sipas GJEDNJ	138
5.1.2. Kuptimi i procesit të rregullt ligjor sipas Gjykatës së Lartë Amerikane....	142
5.2. Procesi i rregullt ligjor sipas Sistemit Gjyqësor në Gjermani	148
5.3. Procesi i rregullt ligjor në sistemin inkuizitor	150
5.4. Procesi i rregullt ligjor në sistemin akuzator	153
KAPITULLI VI: GJYKATA, PROKURORIA DHE ROLI I SAJ PËR NJË PROCES TË RREGULLT LIGJOR	156
6.1. Përbërja e gjykatës dhe parashikimi në ligj	156
6.2. Kuptimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm	158
6.3. Kuptimi pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës	159
6.4. Prokuroria si organ Kushtetues dhe roli i saj në Procesin e Rregullt Ligjor	161
6.5. Pozita procedurale e prokurorit	163
6.6. Veprimet procedurale gjatë fazës së hetimit paraprak	165
KAPITULLI VII: DISA VËSHTRIME RRETH VËSHTIRËSIVE QË SHFAQEN NË PRAKTIKË LIDHUR ME PROCESIN E RREGULLT LIGJOR NË SHQIPËRI	168
7.1. Shpallja e listave të gjykimeve në mjedise të caktuara të gjykatës	171
7.2. Respektimi i orareve të gjykimeve	172
7.3. Shtyrja e gjykimit si faktor negativ në publicitetin e gjykimit	174
7.4. Numri i madh i çështjeve gjyqësore dhe efektet e tyre negative në procesin e rregullt gjyqësor	178
KAPITULLI VIII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	180
LISTA E REFERENCAVE/BIBLIOGRAFIA	200

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtimi	Shpjegimi
GJEDNJ	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuse
GJL	Gjykata e Lartë
GJLA	Gjykata e Lartë Amerikane
KDM	Kodi i drejtësisë për të Mitur
KEDNJ	Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KPPSH	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
KPSH	Kodi i Penal i Republikës së Shqipërisë
LGJ	Ligji për Gjykatat
QNL	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
RSH	Republika e Shqipërisë
UM	Urdhri i Mbrojtjes
UMM	Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes

KAPITULLI I: HYRJE

1.1. Hyrje

Procesi i rregullt ligjor përfaqëson një të drejtë kushtetuese të individëve, me të cilën ata kërkojnë realizimin e procedurave të drejta dhe të ndershme ligjore.

E parë në këtë këndvështrim, e drejta për një proces të rregullt ligjor karakterizohet nga dyanshmëria. Nga njëra anë paraqitet si një garanci për çdo shtetas kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit shtetëror dhe nga ana tjetër, ajo përbën një detyrim për këto të fundit që të mos çenojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve pa ua siguruar respektimin e procedurave të rregullta ligjore. Në këtë mënyrë themi se ndodhemi përballë një mbrojtje të dyfishtë për shtetasin përballë veprimeve arbitrave të mundshme.

Konventa Evropiane e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe e Lirive Themelore në nenin 6 të saj, të titulluar “E drejta për një proces të rregullt ligjor”, ka sanksionuar të drejtën e shtetasve për t’u dëgjuar drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj si një nga të drejtat themelore të shtetasve. Në këtë nen të Konventës janë përfshirë, gjithashtu, edhe parimi i prezumimit të pafajësisë për të akuzuarit, derisa fajësia e tyre të vërtetohet plotësisht me vendim gjykate, si dhe disa të drejta të rëndësishme të të akuzuarit që lidhen me procedimin penal ndaj tij.

Janë organet gjyqësore ato të cilat mundet të përcaktojnë përfundimisht se cili është fitimtari në konfliktin e pashmangshëm ndërmjet individëve; ndërmjet qeverisë dhe të qeverisurve, duke përfshirë edhe ata që akuzohen nga shteti se kanë shkelur ligjin; ndërmjet individëve dhe shoqërive dhe ndërmjet organizatave, si publike ashtu edhe private. Vetë mënyra sesi e ushtrojnë veprimtarinë e tyre gjykatat, atmosfera që i

rrethon ato, dhe ngjarjet në gjykata është formale dhe e pazakontë për shkak se gjykatat janë unike. Janë gjykatat ato të cilat zgjidhin konflikte duke zbatuar ligjin mbi faktet e çështjeve të veçanta, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

Kur ligji zbatohet mbi faktet që sillen në gjykatë, çdo palë ka të drejtën absolute për të pasur një arbitër që është i pavarur nga palët e asaj çështjeje dhe avokatët e tyre dhe është pikërisht personi i veshur me petkun e gjyqtarit ai që përfaqëson arbitrin.

Proceset gjyqësore në tërësinë e tyre duhet të reflektojnë qëllimet e gjykatës, siç janë drejtësia individuale në çështje gjyqësore individuale, dukshmëria e drejtësisë individuale në çështjet gjyqësore individuale, sigurimi i një vendi gjykimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, mbrojtja e individëve ndaj përdorimit arbitrar të pushtetit qeverisës si dhe regjistrimi i statusit ligjor. Çështjeve gjyqësore individuale duhet t'u jepet vëmendje individuale. Zbatimi i ligjit duhet të jetë i paevitueshëm për çdo çështje. Të drejta të tilla janë të pavarura nga statusi ekonomik dhe pavarësisht nga statusi ekonomik, për të gjithë duhet të ekzistojë qasje e barabartë në gjykatë.

Ballafaqimi i individit me gjykatën që në momentin e parë dhe më tutje vjen mbi bazën e trajtimit të tij sipas parashikimeve të duhura. Çdokush që vjen në gjykatë dhe para saj duhet të trajtohet me respekt, drejtësi dhe në mënyrë të barabartë.

Proceset gjyqësore dhe zbatimi i ligjit mbi faktet në çështjet individuale duhet të jenë të qëndrueshme dhe të parashikueshme.

Individët në jetën e përditëshme përballen me problematika të ndryshme, të cilat ndodh dhe ti nënshtrohen proceseve gjyqësore. Ndaj janë këta individë të cilët në mnyrë direkte apo indirekte janë të demtuar nëse këto procese gjyqësore nuk kanë funksionimin në mënyrën e duhur. Kur flasim për procesin gjyqësor kemi para sysh

sistemin gjyqësor në tërësi pa specifikuar nëse është ai civil apo ai penal, sepse në fund të fundit të gjitha proceset duhet të jenë të drejta dhe të paanëshme.

1.2. Shtrimi i problemit

Punimi ka si qëllim të bëjë pasqyrimin e zhvillimit të procesit të rregullt ligjor në Republikën e Shqipërisë në periudha të ndryshme kohore e në veçanti në periudhën kohore të pas rrëzimit të diktaturës deri në ditët e sotme.

Ngritja dhe zhvillimi i sistemit të rregullt ligjor në funksion të ofrimit të një procesi të mirëfilltë të lirive dhe të drejtave të qytetarëve, paraqet një proces me interes përmes të cilit krijohet imazhi dhe vlera progresiste e vendit tonë.

Përpara se të ndalemi hollësisht në kuptimin në tërësi dhe elementët e veçantë të procesit të rregullt ligjor, vlen t'i kushtojmë vëmendje zhvillimit historik. Për këtë arsye, më poshtë do të paraqesim dy faza të rëndësishme të zhvillimit historik:

Faza e parë është ajo e viteve 1992-1998, gjatë së cilës gjeti zbatim ankimi kushtetues real sipas modelit gjerman, ku individit kishte të drejtë t'i drejtohej GJK për kundërshtimin e akteve të pushtetit publik (qeveri, parlament, gjykatë), nëse i cënoheshin të drejtat e tij të parashikuara në paketën kushtetuese.

Faza e dytë i referohet viteve pas miratimit të Kushtetutës në fuqi, pra pas 1998 e në vazhdim. Kjo fazë njihet si faza e ankimit kushtetues të kufizuar, pasi ankimet individuale mund të drejtohen kryesisht kundër vendimeve gjyqësore dhe në raste mjaft specifike edhe ndaj akteve të tjera të pushtetit publik, kur pretendohet se cënohet e drejta për proces të rregullt ligjor dhe individit nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj aktit (Zaganjori, Anastasi, Methasani (Cani), 2011: 88).

Duke analizuar në mënyrë profesionale tërë procesin dhe fazat nëpër të cilat ka kaluar organizimi organik dhe ligjor i organeve të ofrimit të procesit të rregullt ligjor

dhe funksionimi i tyre, gjatë këtij punimi janë vënë në dukje edhe të metat dhe rreziqet që sjell çdo improvizim apo kopjim i ndonjë Shteti nga Bashkësia Ndërkombëtare.

Kjo ndodh për shkak se modelet e ndryshme të shteteve të ndryshme nuk do të ishin efektive dhe nuk do të përshateshin me nevojat, strukturën dhe funksionin e institucioneve vendore.

Në vendimin tonë për të realizuar studimin e një çështjeje të tillë janë disa faktorë me karakter ndikues.

I pari konsiston në aktualitetin e procesit dhe forcimin e sundimit të ligjit. Momenti i dytë ka të bëjë me përkushtimin individual profesional e praktik në aktivitete nga fusha.

Gjatë hartimit të punimit janë shfrytëzuar literaturë kombëtare dhe ndërkombëtare që i referohet zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, si dhe janë shfrytëzuar akte kushtetuese dhe ligjore që i referohen kësaj fushe.

Duhet të marrim parasysh se ky punim mund të shoqërohet me të meta të caktuara teknike, por shpreh besimin se në punën e mëtejshme në këtë fushë do të përpiqem që t'i evitoj ato duke mos rënë pre e përsëritjes.

I gjithë punimi është konceptuar i ndarë në disa kapituj. Kjo ndarje është bërë duke u nisur nga parashikimet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, trajtimi sipas konventës dhe trajtimi sipas rregullave proceduriale.

Një vëmendje e posaçme gjatë këtij punimi, në funksion të evidentimit të procesit të rregullt ligjor në rangun penal, do i kushtohet të pandehurit, pozitës procedurale dhe garantimin e të drejtave të tij.

Një element për t'u nënvizuar është ndryshimi procedural i trajtimit të procesit ligjor në këndvështrimin e legjislacionit shqiptar.

Ndryshimet e ndodhura pas vitit 90-të, i dhanë tjetër formë dhe karakter zhvillimit te procesit, parashikimit të të drejtave dhe garantimit të tyre. Në momentin e ndryshimit, moment në të cilin vendi ynë bëri kthesën e madhe, nga një regjim totalitar, njohja dhe zbatimi i normave që lidhen me të drejtat e njeriut u pa si një nevojë e ngutshme.

Kjo nevojë, e ngutshme në fillimet e saj, u shoqërua me përpjekjet për realizimin e garantimit të të drejtave të individit dhe procesit të rregullt ligjor në standarde të larta, duke u kthyer jo vetëm në përpjekje, por në sfidë për t'u arritur.

Ky parim shkon përtej të drejtës sonë të brendshme duke u ngritur në një të drejtë, detyrim dhe vlerë europiane e sanksionuar si e tillë në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si ligji me i lartë dhe themelor i vendit e parashikon të drejtën për një proces të rregullt ligjor në disa nene. Megjithatë, kushtetuta nuk jep një përkufizim të konceptit se çfarë kuptohet me proces të rregullt ligjor. Sipas parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës sanksionohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me kushtetutë dhe me ligj nuk mund të çenohen pa një proces të rregullt ligjor,

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Sipas parashikimeve të nenit 43 të Kushtetutës së RSh-së, parashikohet se;

“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë është parashikuar ndryshe”.

Sipas parashikimeve të nenit 131/f parashikohet se Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në analizë të parashikimeve të mësipërme kushtetuese rezulton se e drejta për një proces të rregullt lidhet me proceset gjyqësore (neni 131/f). Gjykata kushtetuese mund të vihet në lëvizje për rishikimin e vendimeve nga gjyqësori të cilat pretendohet se kanë cënuar procesin e rregullt ligjor. Megjithatë koncepti i procesit të rregullt shtrihet përtej proceseve gjyqësore. Edhe termi i përdorur në Kushtetutë “ligjor” ka dashur të jap idenë se e drejta për procesin e rregullt nuk do të kufizohet vetëm brenda gjyqësorit.

Siç e theksuam më sipër, pjesë e këtij punimi do të jetë analiza e parimeve të procesit të rregullt ligjor. Ndër parimet thelbësore përmendim *prezumimin e pafajësisë*, i sanksionuar në parashikimet kushtetuese dhe ato procedurale. Neni 4 i Kodit të Procedurës Penale garanton individin që konsiderohet i pafajshëm derisa nuk është deklaruar fajtor me një vendim të formës së prerë. E drejta për t’u mbrojtur përbën një element të rëndësishëm të këtij të parimi, dhe paraqitet në forma të ndryshme si; e drejta për t’u njohur në lidhje me çështjen, e drejta e realizimit të mbrojtjes, e drejta e paraqitjes së kërkesave, etj.

Bazuar në parashikimet kushtetuese dhe legjislacionin ndërkombëtar, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë dhe Gjykata Evropiane të Drejtave të Njeriut kanë marrë një seri vendimesh të rëndësishme për respektimin në praktikë të parimit të gjyimit të drejtë.

Ajo çfarë prezanton neni 42 i Kushtetutës, sikurse edhe dispozitat e tjera, vijnë në përputhje të plotë me përmbajtjen e Konventës Evropiane të drejtave të Njeriut.

Në këndvështrim të nenit 42/2, gjykimi ka këto elemente:

- a) gjykimi duhet të jetë i drejtë
- b) gjykimi duhet të jetë publik
- c) brenda një afati të arsyeshëm
- d) nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme
- e) nga një gjykatë e caktuar me ligj

Pjesë e këtij punimi do të bëhen këta elementë, me trajtimet teorike dhe me zgjidhjet praktike të dhëna për çështje të ndryshme.

Qëllimi i punimit është nxjerrja në pah e bazave të procesit të rregullt, për të analizuar problematikat që lidhen me këtë proces, duke parashtruar zgjidhjet e mundshme për problemete hasura.

A mjaftojnë parashikimet tona procedurale t'i garantojnë individit procesin e rregullt ligjor, a janë në përshtatshmëri të plotë parashikimet procedurale me frymën kushtetuese dhe me Konventën Evropiane për të drejtat e Njeriut, a respektohet procesi i rregullt dhe në çfarë mase. Këto dhe pyetje të tjera do të jenë objektivi i trajtimit të këtij punimi, duke e ilustruar dhe me raste praktike.

1.3. Qëllimi i studimit

Legjislacioni shqiptar gjatë viteve ka njohur rrugën e vet të zhvillimit dhe të transformimit që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar deri në ditët e sotme. Ai ka pësuar ndryshime në varësi të zhvillimeve ekonomike, shoqërore, politike ideologjike etj.

Për të respektuar të drejtat dhe liritë e individit dhe për të pasur një shtet të së drejtës me baza të shëndosha, është e domosdoshme që Kushtetuta të garantojë parimin e një procesi të rregullt ligjor.

Kështu, nga neni 42 i Kushtetutës buron e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejtë kjo që ka të bëjë veçanërisht me mbrojtjen e të drejtave të individëve, duke qenë se ata mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm në lidhje me shkeljen e të drejtave për një proces të rregullt ligjor. Përgjithësisht të gjitha të drejtat e individit në një proces qoftë ai penal ose jo, lidhen drejtpërdrejt me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Në këtë mënyrë e drejta për t'u mbrojtur është element themelor i së drejtës për një gjykim të rregullt ligjor në procesin penal dhe shërben ndër të tjera, për të siguruar respektimin e parimit të barazisë së palëve. Kushtetuta njeh të drejtën për t'u mbrojtur në nenin 31 pikat "b" dhe "ç" në të cilët përcaktohet se i pandehuri ka të drejtë:

- b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

Respektimi i së drejtës së mbrojtjes nënkupton një proces të drejtë dhe të paanshëm. Realizimi i së drejtës së mbrojtjes s'mund të bëhet veçse nëpërmjet një procedure të tillë. Në të njëjtën kohë s'mund të kemi një proces të drejtë dhe të paanshëm nëse e drejta e mbrojtjes nuk respektohet. Ndërsa parimi i barazisë së palëve nënkupton detyrimin për t'i ofruar secilës palë mundësinë për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vënë në disavantazh me palën tjetër.

Objektivat e këtij punimi konsistojnë në:

1. Arritjen e një interpretimi ligjor dhe kushtetues të sigurimit të një procesi të rregullt ligjor.
2. Matjen dhe monitorimin e proceseve gjyqësore.

3. Analizimin e kontekstit ligjor, metodologjik, konceptual dhe krahasimor të proceseve të rregullta ligjore.
4. Studimin e procesit administrativ në gjykata që siguron procesin e rregullt ligjor përmes ofrimit të rekomandimeve dhe sugjerimeve konkrete.
5. Rritjen e ndërgjegjësimit të qeverisë, ligjvënësve e më së shumti gjyqësorit, por edhe të aktorëve të tjerë me interes, lidhur me problematikat e evidentuara dhe mundësitë për zgjidhje.

1.4. Burimet e referimit

Në shoqëritë bashkëkohore demokratike të drejtat e njeriut konsiderohen parime bazë pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjitet dhe shoqëria nuk mund të njohë progres. Pikërisht, duke u nisur nga roli i padiskutueshëm që ato luajnë në zhvillimin e individit dhe shoqërisë, një vend të rëndësishëm zë trajtimi i çështjeve që lidhen me garantimin që i rezervohet të drejtave të njeriut, pjesë e pandashme e të cilave është dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Me proces të rregullt ligjor duhet kuptuar ai proces i rregulluar në mënyrë të tillë që realizon nxitjen apo favorizimin në respekt të garancive procedurale, dhënien e një vendimi të saktë e të drejtë nga një gjykatë e paanshme, bazuar në një rindërtim "të vërtetë, të arsyeshëm dhe të kontrollueshëm të rastit konkret ose më mirë, të pretendimeve faktike që e përbëjnë atë"(Diritto e ragione, 2000: 8).

Për të kuptuar mirë këtë parim, në radhë të parë, duhet të evidentojmë paraqitjen e tij si një element thelbësor për të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*neni 42 i Kushtetutës*). Për këtë, një ndihmësë të posaçme ka dhënë Josep Casadevall Medrano (Zv-kryetar i GJEDNJ), i cili e përkufizon si vijon “Gjykatën e paanshme”:

“Nocioni i Gjykatës së paanshme, në kuptimin e mungesës së paragjykitimit ose të pozicionimit, nënkupton së pari: një analizë subjektive për të përcaktuar bindjen dhe sjelljen e gjykatësit në një çështje dhe pastaj, një analizë objektive që mundëson krijimin e garancive të mjaftueshme me qëllim që, personi që është subjekt i procesit të mund të shmangë çdo lloj dyshimi legjitim” (Josep Casadevall Medrano, 2012:101).

“Garancitë kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit u lejojnë gjyqtarëve t’i mbrojnë të drejtat dhe liritë e individëve të përcaktuara me ligj. Megjithatë, këto garanci kushtetuese dhe mbrojtje ligjore humbin rëndësinë e vet atëherë kur vendimet gjyqësore nuk zbatohen. Veç kësaj, kur individëve u mungon besimi në zbatueshmërinë e vendimeve, ka gjasa që ata më pak të mbështeten në gjykata për zgjidhjen e kontesteve dhe si rezultat mund t’u kthehen mënyrave të tjera jozyrtare dhe private për të kërkuar drejtësi. Me kalimin e kohës, dështimi për t’i zbatuar në mënyrë efektive vendimet do të zbeh besimin në sistemin e drejtësisë dhe sundimin e ligjit(CEELI, 2003: 1)”.

Gjyqtari rumun Kristi Danilet sheh tri vlera kryesore që mbajnë në këmbë një sistem drejtësie të pakorruptuar: *paanshmërinë, pavarësinë dhe integritetin* e punonjësve të drejtësisë.

Ndërsa, studiuesja shqiptare Arta Vorpsi, duke renditur treguesit e korrupsionit në gjyqësor, shënon konfliktin e interesit dhe paragjykimin e palëve, ndër treguesit më të qartë të një gjyqësori të korruptuar (Vorpsi, 2012: 122-123).

1.5. Hipoteza / hipotezat e punimit

Për shkak të rëndësisë, e drejta për një proces të rregullt ligjor ka qenë vazhdimisht objekt trajtimesh dhe interpretimesh nga doktrina dhe jurisprudenca. Ajo përbën një nga

bazat thelbësore të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore dhe ka marrë tashmë vlerën e një parimi të përgjithshëm të së drejtës.

Pas identifikimit të burimeve parësore dhe dytësore të përdoruar për këtë studim, duke u mbështetur në analizën e rezultateve primare dhe hulumtimeve në terren, është arritur në ngritjen e hipotezës qendrore të punimit, si mëposhtë:

Sigurimi i një procesi të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore për individin, kontribuon në rritjen e vlerës njerëzore dhe ndikon në besueshmërinë ndaj drejtësisë dhe gjyqësorit!

Ndërsa hipotezat ndihmëse të punimit janë:

- Sigurimi i një procesi të rregullt ligjor si proces kompleks, në Republikën e Shqipërisë është përcjellë me nevojën e vazhdueshme për të reformuar sistemin tonë ligjorë dhe për të arritur standarte të reja të të drejtave të njeriut.
- Pothuajse të gjitha të drejtat dhe liritë e njohura nga Kushtetuta dhe ligji mund të kufizohen për arsye të përligjura dhe të justifikueshme, ndërkohë që e drejta për një proces të rregullt ligjor, për çfarëdo lloj rrethane, mbetet e pakufizueshme.
- E drejta për një proces të rregullt ligjor konsiston në një garanci për shtetasit ndaj veprimeve të padrejta të pushtetit shtetor, nga njëra anë dhe si detyrim i kërtë të fundit për të mos cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve pa siguruar respektimin e procedurave ligjore, nga ana tjetër.

1.6. Pyetjet kërkimore të punimit

- Cilat janë parimet e procesit të rregullt ligjor?
- Cili është roli i gjyqësorit në sigurimin e procesit të rregullt ligjor?
- Cili është roli i institucioneve të tjera kushtetuese dhe ligjore në sigurimin e

procesit të rregullt ligjor?

- Sa është i rregulluar me konventa dhe ligje ndërkombëtare procesi i rregullt ligjor?
- Cila është ndërlidhja mes Gjykatës Kushtetuese dhe procesit të rregullt ligjor?
- A ka rregullim kushtetues mbi procesin e rregullt ligjor në vend dhe me gjerë?
- Cilat janë karakteristikat që kanë përcjellë procesin e rregullt ligjor nëpër sisteme të ndryshme socio-politike që ka kaluar vendi në periudha të ndryshme kohore?

1.7. Metodatat dhe metodologjia e kërkimit

Në zhvillimin e këtij punimi shkencor kam përdorur disa metoda shkencore, të cilat kanë për objekt studimin e procesit të rregullt ligjor në kontekstet e ndryshme të evoluimit të legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar, duke i kushtuar vëmendje të veçantë trajtimit që i bën këtij procesi, doktrina dhe jurisprudenca.

Metodat të cilat kam përdorur janë: Metoda analitike; Metoda e intervistimit; Metoda përshkruese; Metoda statistikore-përpunimit të rezultateve.

Po ashtu gjatë punës kërkimore kam shfrytëzuar dhe analizuar ligjete periudhave të ndryshme kohore, aktet nënligjore, vendimet e ndryshme, udhëzimet dhe urdhëresat, programet e trajtimit të burgosurve, rregullat e brendshme të institucioneve dhe literaturën profesionale nga kjo fushë shkencore.

Gjatë hulumtimit tim më ka ndihmuar edhe stafi i Prokurorisë dhe Zyra e avokatisë time, të cilët kanë kontribuar në grumbullimin e materialeve dhe raporteve me interes.

1.8. Mundësitë dhe kufizimet

Me proces të rregullt ligjor duhet kuptuar ai proces i rregulluar në mënyrë që të

nxisë apo favorizojë në respekt të garancive procedurale, dhënien e një vendimi të saktë e të drejtë, bazuar nënjë rindërtim të vërtetë, të arsyeshëm dhe të kontrollueshëm të rastit konkret ose më mirë, të pretendimeve faktike që e përbëjnë atë. (Diritto e ragione, 2000: 8)".

Neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përcakton një listë të gjatë të të drejtave procedurale që u njihen të gjithë personave që janë palë në një proces në kuptim të gjerë: e drejta për proces publik, që procesi të përfundojë në një afat të arsyeshëm dhe të drejtohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e drejta e prezumimit të pafajësisë, etj.

Që në fillim neni 6 afirmon se “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet rregullisht”. Kjo shprehje e përgjithshme mbulon të gjitha të drejtat e veçanta që paraqiten në këtë nen, por edhe këtu nuk ka asnjë përkufizim. Përcaktimi i mësipërm nxjerr në pah një sërë elementësh të cilët lidhen me evdientimin e çështjes, dëgjimin e saj dhe trajtimin e saj mbi baza të rregulluara.

Duke lexuar nenin 6 të KEDNJ-së ligjshmëria mund të përkufizohet në dy mënyra: në kuptimin e ngushtë ligjshmëri do të thotë se secila prej palëve në proces mund të mbrojë çështjen e vet në kushte përgjithësisht të barabarta në raport me palën kundërshtare (De Salvia, 1995: 265). E parë në një kuptim më të gjerë ‘ligjshmëri’ është sinonimi i drejtësisë dhe përfshin disa të drejta të veçanta si e drejta për t’u gjykuar nga gjykata në afat të arsyeshëm etj. Këtu duhet të shtojmë prezumimin e pafajësisë pa të cilin nuk ka proces të vërtetë, pra proces të rregullt ligjor.

Madje nëpërmjet disa vendimeve Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e miraton këtë konceptim të gjerë, sidomos kur thotë se paragrafi i parë i nenit 6 është norma bazë, paragrafët 2 dhe 3 janë zbatime të veçanta të tij (Çështja Lutz

kundër Spanjës 25 Gusht 1987, Seria A nr. 123 – B), ose kur thekson se kërkesat e paragrafit të 3 analizohen si aspekte të veçanta të së drejtës për një proces të rregullt ligjor që garantohet nga paragrafi 1 (Çështja Isgro kundër Italisë 19 Shkurt 1991, Seria A nr. 34 – B).

Mundësitë e shumta për studimin, shtrihen në teorinë e së drejtës në përgjithësi, dhe në vecanti në të drejtën materiale penale që përcakton qëllimin, llojin dhe zgjatjen e sanksioneve penale. Në mënyrë të posacme ato që lidhen me denimin dhe kushtet për zbatimin e tij. Në këtë kënvështim del dhe qëllimi i çdo sanksioni penal, e veçanërisht qëllimi i dënimit që është i përcaktuar në bazë të së drejtës penale materiale dhe që mund të realizohet vetëm përmes saj (Hysi, 2012: 16-45).

Në teorinë juridike dallohen edhe ndarje të tjera si pasojë e veprës penale, si p.sh. në pasoja kryesore dhe sekondare, të afërme dhe të largëta.

Në aspektin praktik mundësitë e studimit evidentohen në periudhën e pas rrëzimit të komunizmit, nëpërmjet mundësisë së analizës së informacioneve dhe raporteve konkrete gjyqësore dhe studimore mbi fushën.

Ajo çka mund të konkludohet nga studimet e deritanishme, rezulton në faktin se, përkundrejt përpjekjeve për të trajtuar problematikën që lidhen me respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, nuk ka pasur një studim cilësor deri në këtë kohë, mbi çështjen në fjalë.

KAPITULLI II: TË DREJTAT DHE PROCESI I RREGULLT LIGJOR

Realizimi i një gjykimi të drejtë krijon mbrojtje në kuadër të realizimit të të drejtave të individit. Prania dhe qasja e publikut në gjykime shikohet si një nga format e nevojshme për të dhënë garancinë e një gjykimi të drejtë që do të krijojë mbrojtje ndaj gjykimeve të njëanshme dhe do të ofrojë garancinë e mjaftueshme për sistemin gjyqësor. Një qasje e tillë ndikon në krijimin e mundësive që publiku të jetë dëshmitar në administrimin e drejtësisë nga autoritetet përkatëse. Për të konkluduar nëse kemi të bëjmë me një gjykim të hapur ndaj publikut duhen marrë parasysh kërkesat e nenit 6(1) të KEDNJ. Është e panevojshme të merret në konsideratë procedura në tërësi.

Jemi mësuar të shohim praninë e publikut dhe sidomos gjatë gjykimit në shkallë të parë. Ndërkohë konstatohet mungesa e publikut në Gjykatën e Apelit dhe përfaqësimin në Gjykatën e Lartë. Ekzistojnë mendime të ndryshme në lidhje me mungesën e qasjes së publikut në apel dhe më lart.

Për shembull, mungesa e publikut në apel vetëm, mund të konsiderohet një shkelje e nenit 6(1) të KEDNJ. P.sh. në çështjen Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë të vitit 1982, një çështje ku përfshihej padia për dëmtim personal, një gjykim i hapur dhe publik u organizua në gjykatën e shkallës së parë, por apeli i saj sa u organizua nëpërmjet ndihmës së kamerave për të lehtësuar ngarkesën e gjykatës.

U tha se kjo nuk konsistonte në shkeljet e neni 6(1) i Konventës sepse, marrë në tërësi, gjykimi ishte publik. Roli i gjykatës së apelit ishte mospranimi i gabimeve në pikat ligjore siç pretendohet nga pala paditëse dhe me këtë vendim vendimin e gjykatës së shkallës së parë e mbante final. Në sistemin ligjor Anglez, aplikimet e bëra për

lejimin e një apeli kundrejt një vendimi apo dënimi të marrë, zakonisht dëgjohej pa praninë e publikut. Gjithashtu, neni 6(1) të KEDNJ, përmban një listë limitimesh për të drejtën e një gjykimi të hapur dhe publik, kur një gjë e tillë kërkohet nga rregulli publik, siguria kombëtare, nevoja për privatësi ose kur kërkohet në mënyrë të domosdoshme për interes të drejtësisë. Por, duhet kuptuar që interpretimi i këtyre situatave përjashtuese është shumë i ngushtë. Në çështjen Szucs kundër Austrisë e vitit 1997, ku vendimi as nuk u shpall publikisht nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, as nuk ishin vënë në dispozicionin e plotë për publikun në regjistrat e tyre dhe aksesit ishte i kufizuar në ato që përbënin një interes legjitim.

2.1. Të drejtat e njeriut

Në nenin 1 të Deklaratës së Përgjithëshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, parashikohet se të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të lindur me të drejta dhe dinjitet të barabartë.

Të drejtat e njeriut janë parimet bazë, pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjitet. Të drejtat njerëzore përbëjnë bazën e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes. Respektimi i tyre bën të mundur progresin e plotë të individit dhe të shoqërisë.

Zhvillimi i të drejtave të njeriut i ka rrënjët e veta në luftën për liri dhe barazi kudo në botë. Bazën e të drejtave të njeriut - siç është respekti për jetën e njeriut dhe dinjitetin njerëzor - e hasim në pjesën më të madhe të feve dhe të filozofive.

Ato janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Dokumente si "Marrëveshja ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", gjithashtu, përcaktojnë se ç'duhet të bëjnë e çfarë nuk duhet të bëjnë qeveritë për të respektuar të drejtat e qytetarëve të tyre.

Të drejtat e njeriut nuk blihen, nuk fitohen, apo nuk trashëgohen, ato u përkasin njerëzve, thjesht sepse ato janë qenie njerëzore - të drejtat e njeriut lindin bashkë me njeriun.

Të drejtat e njeriut janë të njëjta për të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht nga raca, nga seksi, nga feja, nga bindja politike ose nga ndonjë bindje tjetër, nga prejardhja kombëtare ose shoqërore. Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë dhe përsa i takon dinjitetit dhe të drejtave të tyre - të drejtat e njeriut janë universale.

Të drejtat e njeriut nuk mund t'i merren atij - askush nuk ka të drejtë ta privojë dikë nga këto të drejta për çfarëdolloj arsye. Njerëzit i kanë të drejtat e njeriut edhe kur ligjet e vendit të tyre nuk i njohin ato ose kur ata i shkelin ato p.sh. në sistemin skllavopronar, skllavërit i kanë të drejtat, ndonëse këto të drejta shkelen - të drejtat e njeriut janë të patjetërsueshme. Ato lindin bashkë me individin që prej momentit kur ai vjen në jetë. Ndaj, çdo e drejtë lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me vetë individin.

Për të jetuar me dinjitet, të gjitha qeniet njerëzore gëzojnë të drejtën e lirisë, të sigurisë dhe të niveleve të denja jetësore njëkohësisht.

Të drejtat ndahen në tri grupe, ku në grupin e parë bëjnë pjesë ***të drejtat civile dhe politike***. Të drejtat që bëjnë pjesë në këtë grup quhen dhe të drejta të shkallës së parë. Këto të drejta kanë lidhje me lirinë dhe përfshijnë të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e individit; çlirimin nga tortura dhe nga skllavëria; pjesëmarrjen politike, lirinë e bindjes, të shprehjes, të mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; lirinë e grumbullimit dhe të pjesëmarrjes në shoqata.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë të drejtat ekonomike dhe shoqërore, të cilat quhen të drejta të shkallës së dytë. Këto të drejta kanë lidhje me sigurinë, p.sh. të drejtat: për të

punuar, për t'u arsimuar, për të pasur nivel të arsyeshëm jetëse; për t'u ushqyer, për t'u strehuar dhe për kujdes shëndetësor.

Në grupin e tretë bëjnë pjesë të drejtat e mjedisit, të kulturës dhe të zhvillimit, dhe këto të drejta quhen të drejta të shkallës së tretë. Këto përfshijnë të drejtat për të jetuar në një mjedis që është i pasur dhe i mbrojtur nga shkatërrimi, si dhe të drejtat për të pasur një zhvillim kulturor, politik dhe ekonomik.

Kur themi që çdo njëri gëzon të drejtat njerëzore, nënkuptojmë gjithashtu që, çdo njëri është përgjegjës për respektimin e të drejtave njerëzore të të tjerëve.

2.1.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Universal Declaration of Human Rights- UDHR) është Deklarata e pranuar më gjerësisht për të drejtat e njeriut. Mesazhi themelor i saj është vlera e trashëguar e qenieve njerëzore. Deklarata u miratua njëzëri më 10 dhjetor 1948 nga Kombet e Bashkuara (megjithëse 8 vende abstenuan).

Ajo shpall listën e të drejtave themelore për çdo njeri në botë, pavarësisht nga raca, nga ngjyra, nga seksi, nga gjuha, nga feja, nga bindja politike ose ndo një bindje tjetër, nga origjina kombëtare apo shoqërore, nga prona, nga statusi i lindjes etj.

Ajo thekson me të madhe se qeveritë premtojnë të mbrojnë të drejta të caktuara, jo vetëm të shtetasve të tyre, por edhe të shtetasve në vende të tjera. Me fjalë të tjera, kufijtë kombëtarë nuk janë pengesë për të ndihmuar të tjerët që të gëzojnë këto të drejta. Që nga viti 1948, Deklarata Universale ka shërbyer si modeli ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Më 1993, konferenca botërore me pjesëmarrjen e 171 shteteve që përfaqësonin 99% të popullsisë botërore riafirmoi angazhimin e saj ndaj të drejtave të njeriut.

2.1.2. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “Konventa”) është një pasqyrim unik i vlerave të civilizimit dhe demokracisë dhe konventa e parë e Këshillit të Evropës që synon mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Konventa u nënshkrua rreth 60 vjet më parë nga qeveritë e shteteve evropiane, anëtare të Këshillit të Evropës, me një pasuri të përbashkët idealesh dhe traditash politike, me synimin për të respektuar liritë dhe epërsinë e të drejtës, si dhe për të marrë masat e përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale. Gjatë këtyre 60 viteve Konventa është përballur me sukses me sfida të shumta, çka ka konfirmuar përkushtimin e thellë të shteteve nënshkruese ndaj lirive themelore të sanksionuara në Konventë, të cilat përbëjnë themelet e drejtësisë dhe të paqes në botë.

Në vitin 1950, kur u miratua Konventa, as mund të mendohej se Shqipëria mund të ishte një nga Palët e Larta Kontraktuese, por rrëzimi përfundimisht i sistemit komunist, u shoqërua me një valë ndryshimesh demokratizuese, që, midis të tjerash, solli edhe anëtarësimin e saj në Këshillin e Evropës më 13 Korrik 1995. Ashtu si dhe për vendet e tjera që kishin qenë për një kohë të gjatë nën regjimet diktatoriale (Spanja ose Italia) anëtarësimi në Këshillin e Evropës për Shqipërinë ishte një hap gjigant, pasi i dha asaj njohje ndërkombëtare si vend që kishte hyrë në rrugën e demokratizimit dhe po ashtu, përbënte inkurajim për forcimin e mëtejshëm të demokracisë, çka, midis të tjerash, nënkuptonte, demonstrim nga ana e institucioneve shqiptare të më shumë angazhimi ndaj vlerave demokratike. Anëtarësimin e saj me të drejta të plota përfaqësimi në këtë Këshill, Republika e Shqipërisë e realizoi krahas zhvillimeve të karakterit politik, ekonomik, social dhe juridik që kishte arritur dhe kalimit gradual drejt një shoqërie të lirë e demokratike, por edhe kundrejt disa angazhimeve dhe detyrimeve

të karakterit juridik ndërkombëtar, të cilat ajo i mori përsipër për t'i përmbushur brenda disa afateve të caktuara (Shih vendimin nr.65, datë 10.12.1999 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nuk e kishte përmbushur formalisht detyrimin juridik dhe politik të nënshkrimit, ratifikimit dhe zbatimit të Protokollit nr.6, i cili që në nenin 1 të tij sanksionon heqjen e dënimit me vdekje).

Shqipëria e ratifikoi Konventën dhe njohu të drejtën e peticionit individual më 2 Tetor 1996 dhe disa Protokolle shtesë të saj. Po në këtë datë Shqipëria ka ratifikuar edhe tetë Protokollat e para shtesë të KEDNJ-së, kurse Protokollin nr.11 u nënshkrua në datën 13.07.1995, u ratifikua në 02.10.1996 dhe hyri në fuqi në 01.11.1998; Protokollin nr.12 u nënshkrua në datën 26.05.2003, u ratifikua në 26.11.2004 dhe hyri në fuqi më 01.04.2005; Protokollin nr.13 për shfuqizimin e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat, u nënshkrua më 26.05.2003, u ratifikua më 06.02.2007 dhe hyri në fuqi më 01.06.2007; Protokollin nr.14 u nënshkrua më 10.11.2004, u ratifikua më 03.02.2006 dhe hyri në fuqi më 01.06.2010.

Sipas parimeve kryesore të së drejtës ndërkombëtare, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre të plotë në Kushtetutën e re, shtetet si subjekte të kësaj të drejte, janë të detyruara të përmbushin të gjitha angazhimet, që ato i kanë marrë përsipër për t'i realizuar. Përndryshe, në rast mospërmbushje të këtyre detyrimeve dhe angazhimeve ndërkombëtare, shtetet përkatëse nuk do të mund t'i shmangen përgjegjësisë, e cila zakonisht shfaqet shumëplanëshe, por që ndikimin më të madh e ka kryesisht në aspektin politik, juridik, ekonomik dhe social. Fatmirësisht, RSH-ja nuk u përball me asnjë prej përgjegjësisë të mësipërme, pasi Gjykata Kushtetuese, në vitin 1999, e vënë në lëvizje me një kërkesë për kontroll incidental të paraqitur nga Gjykata e Lartë, vendosi të pranonte kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të disa

neneve të Kodit Penal dhe të dy dispozitave të Kodit Penal Ushtarak (Ky gjykim u bë i mundur bazuar në kompetencën për të shqyrtuar tej objektit të kërkesës në bazë të nenit 37 të ligjit nr .8373, datë 15.07.1998 - Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, duke qenë se ekzistonte lidhja e drejtpërdrejtë midis normave ligjore. Ndërkohë, Protokolli nr. 6 që parashikonte shfuqizimin e dënimit me vdekje, i hapur për nënshkrim e ratifikim në 28.04.1983, që në nenet 4 dhe 5 nuk lejonte dërgime dhe rezerva nga Palët e Larta Kontraktuese, u nënshkrua nga Shqipëria në datën 4.04.2000, u ratifikua në datën 21.09.2000 dhe hyri në fuqi në datën 01.10.2000).

2.2. Parimi i ligjshmërisë në Kushtetutë

Me ligjshmëri kuptohet kërkesa për respektimin e përpiktë dhe pa kushte të kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore nga ana e të gjithë organeve shtetërore, personave zyrtare, organizatave shtetërore dhe shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Parimi i ligjshmërisë është një ndër bazat kryesore për realizmin e procesit të rregullt ligjor.

Ky parim gjen shprehjen e vet në nenet 29, 34, 116 dhe 118 të kushtetutës, të cilët po i pasqyrojmë sa më poshtë.

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë (Kushtetuta , neni 116, 118):
 - a) Kushtetuta;
 - b) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
 - c) Ligjet;
 - d) Aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre (Dispozitat kryesore kushtetuese , 145/1 and 145/3). "Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në kushtetutë," vetëm në sensin e respektimit të plotë të kushtetutës dhe ligjeve të tjera por do shohim, respektimin e parimit të ligjshmërisë në vendosjen e masave të sigurimit, në heqjen e lirisë së personit, në të drejtën e ankimit, në sigurimin e mbrojtjes, ndalimi i gjësë së gjykuar, çfarë trajtimi i bën KEDNJ parimit të ligjshmërisë, parimi i prezumimit të pafajësisë etj. Zbatimi i parimit të ligjshmërisë është kusht për ekzistencën e shtetit ligjor. Ligjshmëria nënkupton qeverisjen në bazë të ligjit. Ai ka karakter politik dhe juridik dhe kërkon ndërtimin e raporteve të ndërsjella midis pushtetit dhe shtetasve në bazë të ligjit, mbështetjen në ligje të të gjitha veprimeve dhe procedurave jo vetëm të organeve administrative por të të gjitha organeve shtetërore, garantimin e të drejtave të njeriut. Këtu paraqitet edhe rëndësia e parimit të ligjshmërisë.

Me kushtetutshmëri do të kuptojmë një nocion me tre kuptime kryesore:

Në kuptimin juridik, kushtetutshmëria është pajtueshmëria me kushtetutën dhe të gjitha akteve të tjera normative. Bazën e hierarkisë së tyre e paraqet Kushtetuta si akti më i lartë dhe ligji themelor injë shteti.

Në kuptimin politik, kushtetutshmëria është zbatimi i kufizimeve dhe masave mbrojtëse në ushtrimin e pushtetit shtetëror, të cilat kanë qëllim të evitojnë mundësinë e lindjes së konflikteve të ndryshme, arbitraritetit etj. Këto dy kuptime, qoftë ai politik qoftë ai juridik nuk përmbajnë elementët e mjaftueshme për të paraqitur të plotë edhe të saktë përmbajtjen e kushtetutshmërisë.

Në kuptimin politiko- juridik, kushtetutshmëria nënkupton ekzistencën e rregullave themelore kushtetuese, në bazë të të cilave organizohet sistemi politik në një shtet, ushtrohet apo kufizohet ky sistem, garantohet liria dhe të drejtat e njeriut. Pra nga pikëpamja politike kushtetutshmëria është shprehje i institucionalizimit të pushtetit politik, kurse nga pikëpamja juridike parashikon nënshtrimin e këtij pushteti ndaj disa rregullave, të cilat duhet ti zbatojë deri ne detaje.

Zbatimi i parimit të ligjshmërisë është kusht për ekzistencën e shtetit ligjor. Ligjshmëria nënkupton qeverisjen në bazë të ligjit. Ai ka karakter politik dhe juridik dhe kërkon ndërtimin e raporteve të ndërsjellta midis pushtetit dhe shtetasve në bazë të ligjit, mbështetjen në ligje të të gjitha veprimeve dhe procedurave jo vetëm të organeve administrative, por të të gjitha organeve shtetërore, garantimin e të drejtave të njeriut (Leksione, Legjislacioni Kombëtar, Modoli I, Portali Juridikal).

Nrjedhimisht respektimi i përpiktë i parimit të ligjshmërisë siguron parandalimin e krijimit të situatave jo të rregullta në fushën e marrëdhënieve juridike. Ligjshmëria i shtrin efektet e saj edhe mbi veprimtarinë që ushtrojnë organet shtetërore për ekzekutimin e normave juridike. Për këtë arsye ata duhet të kenë parasysh të respektojnë të gjitha urdhërimet e ligjeve dhe akteve nënligjore. Pikërsht kjo është kërkesa prej së cilës organet shtetërore duhet të udhëhiqen edhe kur kryejnë veprime thjesht materiale dhe teknike që nuk kanë karakter juridik, por që paraqesin kushtet për kryerjen e veprimeve juridike. Zbatimi i këtij parimi shfaqet edhe në rastin kur organet shtetërore nuk veprojnë në përputhje me kërkesat e ligjit. Kjo sjell si pasojë përgjegjshmërinë që kanë përpara ligjit të gjithë subjektet në rastet e shkeljeve të këtyre kërkesave. Kjo përgjegjësi mund të jetë penale, disiplinore, administrative apo monetare.

Si bëhet mbrojtja e kushtetutshmërisë?

Ligjshmëria përbën një aspekt tjetër të kushtetutshmërisë. Instrumentet për sigurimin e ligjshmërisë janë të ngjashme me ato të sigurimit të kushtetutshmërisë: ekzistenca e pushtetit të institucionalizuar, mbrojtja efikase e të drejtave të njeriut. Kontrolli i akteve të administratës organizohet brenda hierarkisë së këtyre organeve.

Lufta për mbrojtjen e kushtetutshmërisë ka lindur që para se të kishim kushtetuta të shkruara. Janë disa forma kryesore për mbrojtjen e kushtetutshmërisë, por më kryesoret janë:

- **Kontrolli dhe mbrojtja parlamentare e kushtetutshmërisë.** Shumë autorë mendojnë, se është vetëm organi ligjvënës, kompetent, për të konstatuar pajtueshmërinë ose jo të ligjeve me kushtetutën. Mbi këtë bazë është krijuar sistemi i kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve nga ana e organit ligjvënës. Ky sistem kontrolli është karakteristikë për vendet që kanë një kushtetutë të paqëndrueshme, ose në vende socialiste. Kjo tregohet me faktin e autoritetit dhe epërsisë së parlamentit, si formë e shprehjes së sovranitetit popullor.
- **Kontrolli dhe mbrojtja e kushtetutshmërisë nga ana e organit të veçantë kushtetues.** Ky sistem kontrolli është i rrallë dhe kryhet nga një organ tjetër jashtë parlamentit.
- **Kontrolli dhe mbrojtja gjyqësore e kushtetutshmërisë.** Me të kuptojmë mbrojtjen e saj nëpërmjet gjykatave të zakonshme, si edhe nëpërmjet gjykatave të posaçme apo kushtetuese.
- **Kontrolli dhe mbrojtja gjyqësore e kushtetueshmërisë.** Me të kuptojmë mbrojtjen e saj nëpërmjet gjykatave të zakonshme (sistemi “difuz” apo “i shpërndarë”), si dhe nëpërmjet gjykatave të posaçme ose kushtetuese (sistemi i

centralizuar). Mbrojtja nëpërmjet gjykatave të zakonshme, është paraqitur kur kushtetuta ka zënë vendin e saj si akti më i lartë politik e juridik në shtet. Ky lloj sistemi përdoret në SHBA, dhe i lejon çdo gjyqtari, të kontrollojë kushtetueshmërinë e akteve shtetërore. Ky sistem ka disa tipare:

- Është kontroll i shpërndarë, sepse kryhet nga çdo gjyqtar në çdo hallkë të gjyqësorit;
- Është kontroll konkret, sepse gjyqtari vendos në kuadrin e çështjeve konkrete;
- Është kontroll aposteriori, sepse ushtrohet pasi ligji është miratuar dhe ka hyrë në fuqi;
- Ka vlerë “*inter partes*”, sepse ka fuqi vetëm për palët në proces.

Kontrolli nga ana e gjykatave kushtetuese, është karakteristikë e vendeve europiane, dhe ka disa veçori:

- Është kontroll i centralizuar, sepse ushtrohet nga një organ i specializuar kushtetues siç është Gjykata Kushtetuese dhe nuk është objekt i veprimtarisë së çdo gjykate të zakonshme;
- Është kontroll abstrakt, sepse objekt i tij nuk janë aktet e zbatimit të ligjit por vetë ligjet si njësi abstrakte.
- Kontrolli mund të jetë “*paraprak*” ose “*a posteriori*”. Kontrolli paraprak ushtrohet pasi normat janë votuar në parlament, por para shpalljes së tyre. Ky lloj kontrolli është edhe parandalues, pasi ka për qëllim moslejimin e hyrjes në fuqi të ligjeve, përmbajtja e të cilëve bie ndesh me kushtetutën. Kontrolli a posteriori ushtrohet, pasi ligji ka hyrë në fuqi, me kërkesë të subjekteve që e vënë në lëvizje gjykatën (Ligji nr. 8436, datë 28.12.1996, ligji nr. 8546, 5.11.1999).

- Vendimet që deklarojnë antikushtetueshmërinë e ligjit kanë vlerë “*erga omnes*”. Ato iu përkasin të gjithë shtetasve në përgjithësi dhe jo vetëm palëve pjesëmarrëse në çështjen gjyqësore. Në Shqipëri është gjykata kushtetuese që garanton respektimin e kushtetutës dhe të legjislacionit dhe bën interpretimin përfundimtar të kushtetutës. Detyra e saj nuk është e njëjtë me atë të gjykatave të zakonshme sepse ndryshe nga ato, ajo nuk është pjesë e shkallëve të procesit gjyqësor. Gjukata kushtetuese ka një rol balancues midis tre pushteteve. Edhe aktet e Kuvendit, megjithëse organi më i lartë ligjvënës në vend, i nënshtrohen rishikimit gjyqësor nga ana e gjykatës kushtetuese (Ministria e Financave, Leksione, Parimi i Kushtetueshmërisë). Kjo gjykatë mjaftohet vetëm me deklarin nëse një ligj është antikushtetues apo jo (Ligji nr.8656, datë 31.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8546, datë 5.11.1999). Ajo nuk mund t’i ndryshojë apo modifikojë ligjet sepse kjo detyrë i përket ekskluzivisht Kuvendit. Vendimet e kësaj gjykate kanë vlerë përfundimtare dhe procesi i përfunduar nuk mund të hapet përsëri.

2.3. Parimet e procesit të rregullt ligjor

Neni 6 i KEDNJ, parashikon se: “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuzë penale kundër tij , çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit”. Kjo shprehje përfshin shumë aspekte të procesit të duhur të së drejtës, si e drejta për akses në gjykatë, për një seancë në prezencën e të akuzuarit, e drejta për të mos kontribuar në vetë-inkriminim, barazia në mjete, e drejta për seanca gjyqësore me palë kundërshtuese dhe një gjykim i arsyeshëm.

Ashtu siç mund të vërehet edhe më sipër, neni 6 garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe të hapur në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të një individi ose të ndonjë akuzë penale kundër tij. Gjykata, dhe më parë edhe Komisioni, e kanë interpretuar gjerësisht këtë nen, me motivin se është me rëndësi themelore për funksionimin e demokracisë. Në çështjen Delcourt kundër Belgjikës, Gjykata deklaroi se:

Në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të Konventës, e drejta për një ushtrim të drejtë të drejtësisë zë një vend kaq të rëndësishëm sa një interpretim i kufizuar i Nenit 6 (1) nuk do t'i korrespondonte synimit dhe qëllimit të asaj dispozitë (Delcourt kundër Belgjikës, 17 Janar 1970, paragrafi 25).

Nuk ka dënim pa ligj. Në nenin 2, prg 2, të Kodit Penal na thuhet se: “Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj”. Këtë mbrojtje e gjejmë edhe tek KEDNJ, neni 7/1 i saj, ku lexojmë tekstualisht se:

“Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare.

Në latinisht tekstualisht do të thonim se: *“Item nulla gravior culpa irrogabitur quam illa quae applicari potuit cum delictum factum est”* pra: Nuk mund të vendoset një dënim më i rëndë nga ai që ka qenë zbatuar në kohën kur është kryer vepra penale.

Në çështjen që do të trajtoj më poshtë, ashtu siç i vihet rëndësi dhe në çështjet pararendëse, do përqëndrohem në trajtimin e kuptimit bazë të sundimit themelor kushtetues të çështjes së ligjit në Republikën e Shqipërisë. Parimi i ligjshmërisë (*“asnjëri nuk ndëshkohet për një krim që nuk gjen parashikim më përpara në një ligj”*), është një ndër parimet bazë juridike, me synimin e plotë dhe të qartë për të mbrojtur individin kundër rasteve të imponimit arbitrar të dënimeve nga ana e shtetit (Skender, Haxhia 2007). Këtë parim, siç e përmenda edhe më sipër e parashikojnë gjerësisht edhe

akte të tjera ndërkombëtare (KEDNJ). Kjo e përforcon mbrojtjen që individi merr prej sistemit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar.

Formulimin konçiz të këtij parimi në gjuhën latine “*Nullum Crimen, Nulla Poena sine lege*” për herë të parë e dha penalisti i njohur gjerman Anselm Fojer Bahu.

Parimi i ligjshmërisë “*Nullum crimen nulla poena sine lege*” në gjuhën shqipe d.m.th” Një veprë nuk mund të konsiderohet veprë penale dhe autori i saj nuk mund të dënohet nëse më parë nuk është paraparë me ligj”. Për shkak të rëndësisë së shumëfishtë për të drejtat, liritë dhe sigurinë juridike të qytetarëve, në sistemin tonë judik parimi i ligjshmërisë është ngritur edhe në rang të normës kushtetuese dhe është përvetësuar në kushtetutë. Për t’u konsideruar një veprë penale, ajo duhet që para se të jetë kryer, të përcaktohet me ligj si veprë penale. Ky parim, pavarësisht ndryshimeve në formulim, është sanksionuar në kodet penale kudo, përfshirë edhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në nenin 2. Sipas kësaj dispozitë, “*Askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundravajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj*”. Kuptohet, se me parashikimin nuk duhet kuptuar vetëm emërtimi i llojit të veprës penale, i cili nuk përfaqëson gjë tjetër veçse sintezën e elementëve përbërës të saj, por edhe përshkrime, pavarësisht formës dhe masës, të tipareve objektive dhe subjektive konkrete të veprës penale të caktuar, tërësia e të cilave nuk përbën gjë tjetër, veçse figurën e veprës penale konkrete që parashikohet në një dispozitë, të caktuar në tërësinë e dispozitave, neneve që përmban Pjesa e Posaçme e Kodit Penal.

Po të analizojmë pjesën e dytë të shprehjes “*sine lege*” është një lloj mbrojtje që personi që dyshohet se ka kryer një vepër penale, të mos marri një dënim më të rëndë se dënimi që vetë ligji parashikon për veprën penale në fjalë.

Parimi i ligjshmërisë konsiderohet fare mirë si një nga bazat e demokracisë, pra qeverisje e vendit, nëpërmjet sigurimit të zbatimit të normave kushtetuese dhe akteve të tjera ligjore. Garancia e zbatimit të këtij parimi në praktikë, përbën padyshim një kusht të domosdoshme për t’i siguruar shoqërisë ku jetojmë lirinë, qetësinë dhe sigurinë sociale në kuadër të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Guerini, Ligji Penal i së drejtës Ndërkombëtare 2005).

Të kërkuarit një vend me një demokraci të konsoliduar, ka bërë që të lindi nevoja për të kërkuar dhe zbardhur standardet kryesore të parimit të ligjshmërisë, të merren masat e nevojshme dhe të përcaktohen mekanizmat e duhura për të siguruar ndarjen e elementëve të saj, sa më të plotë dhe sa më efektive. Historikisht, është siguruar një përvojë e vlefshme si një ndihmë e çmuar që demokracitë e reja, t’i shfrytëzojnë në favor të tyre dhe të shtetasve të tyre.

Pa dyshim vështirësitë dhe problemet më të mëdha, lindin në zbatimin e elementeve të shumta e të veçantë, të parimit të shtetit të së drejtës dhe ligjshmërisë në jetën e përditshme. Pikërisht për këtë arsye, me të drejtë u vu në dukje se zbatimi praktik i këtyre elementeve, është një nga sfidat kryesore, me të cilat përballen shteti dhe shoqëria.

- Karakteristikat dalluese të sundimit të ligjit në Shtetin e së drejtës, janë:

1. Supermacia e ligjit si një shprehje e sovranitetit popullor nëpërmjet parimit të përfaqësimit.

2. Një sistem hierarkik normash juridike, në krye të së cilës qëndron Kushtetuta (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998 - Neni 116).

3. Ndarja e pushteteve, secili me një sferë të caktuar të kompetencave, si garanci e demokracisë.

4. Parimi i ligjshmërisë (përputhja me kushtetutën dhe ligjet).

Parimi i ligjshmërisë ("*crimen nullum, nulla poena sine lege*") është një parim themelor juridik që synon të mbrojë individin kundër imponimit arbitrar të dënimeve nga ana e shtetit.

Në këtë aspekt mund ti referohemi "*Magna Carta*", si dokumenti më i famshëm i Anglisë dhe qytetërimit perëndimor, që konsiderohet nga shumë si themeli i demokracisë. Dokumenti është lartësuar gjithmonë si garantues i lirisë dhe barazisë në SHBA, për shkak të ndikimit që pati në Deklaratën e Pavarësisë. Në fjalimin e tij të marrjes së postit më 1941, Presidenti Roosevelt tha: "*Aspirata demokratike nuk është thjesht një togfjalësh në historinë njerëzore... ajo është shkruar te "Magna Carta". Neni më i famshëm i "Magna Carta" thotë se: "Asnjë njeri i lirë nuk mund të arrestohet apo burgoset, nuk mund t'i merren të drejtat apo posedimet, nuk mund të nxirret i jashtëligjshëm apo të internohet. Ne nuk do të pëdorim forcën kundër tij, me përjashtim të rasteve kur ka një gjykim të ligjshëm nga të barabartët e tij ose nga ligji i tokës. Askujt ne nuk do t'ia shesim apo mohojmë, apo vonojmë të drejtën".*

Karta nënvijëzoi të drejtat themelore së bashku me parimin se askush nuk është mbi ligjin, përfshirë edhe mbretin. Ajo sanksionoi të drejtën për një gjykim të drejtë, si dhe kufizimet për taksim pa përfaqësim. Ka frymëzuar shumë dokumente të tjera, përfshirë Kushtetutën e SHBA-së dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Mbrojta e lirive dhe të drejtave të njeriut janë shtyllë kryesore në funksionimin normal të shteteve demokratike sepse nga respektimi i të drejtave dhe lirive varet drejtpërdrejt zhvillimi politik, ekonomik dhe juridik i një shteti demokratik.

Si bazament i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe si aktet më të rëndësishme konsiderohet të jenë: Magna Carta në Angli e vitit 1215 dhe Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit në Francë e vitin 1789. Pas luftës së Dytë Botërore u nxorrën këto akte shumë të rëndësishme: Karta e OKB-ës, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, e shumë akte të tjera të cilat i garantojnë dhe i mbrojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Fakti që baza e veprimtarisë konsiderohet ligji përcaktohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e cila bën një përcaktim të detajuar të faktit që veprimtaria e shtetit bazohet në të drejtën. Në këtë mënyrë në nenin Neni 4 pg 1 të Kushtetutës së RSh-së parashikohet se: ‘E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit’. Një përcaktim i tillë na prezanton dy elementë, së pari jepet përcaktimi që veprimtaria në vetvete kryhet nga organet shtetërore dhe së dyti kjo veprimtari bazohet në normat e së drejtës. Këta dy elementë dhe plotësimi i tyre e vendosin individin përballë garancive. Në nenin 4 pg2 parashikohet se: ‘Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë’. E parë në këtë këndvështrim përforcohet rregullimi i veprimtarisë së organeve shtetërore të cilat e kryejnë atë mbi bazën e një hierarkie në zbatimin e normave të së drejtës, ku kushtetuta dhe normat e saj zënë vendin kryesor. Në nenin 4 pg 3 të kushtetutës parashikohet se: ‘Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe’. Ky parashikim lidhet

drejtëpërsëdrejti me përcaktimin e peshës së Kushtetutës, dhe zbatimin e saj në mënyrë direkte. Në nenin 5 të Kushtetutës së RSH-së parashikohet se: ‘Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të’. Ky përcaktim e lidh zbatimin e normave në tërësi me përshtatëshmërinë e tyre me normat ndërkombëtare.

Po në të njëjtën frymë janë dhe rregullimet proceduriale në të cilat përcaktohen që në momentet e para fakti që veprimtaria e organeve të ndryshme bazohet në normat e të drejtës. Në këtë mënyrë në Kodin e Procedurës Penale në nenin 2 të tij parashikon se ‘Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjyqimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit’. Një parashikim i tillë të orienton dhe siguron bazueshmërinë e punës së organeve në normat e të drejtës. Në të njëjtën frymë është dhe rregullimi që bëhet në normat procedurale civile dhe ato administrative.

2.3.1 Aspekte praktike të parimeve të procesit të rregullt ligjor

Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndonjë akuzë penale kundër tij, çdo person ka të drejtë për një proces të drejtë gjyqësor dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit.

Vendimi shpallet publikisht, por prania në sallën e gjyqit për përfaqësuesit e shtypit dhe për publikun mund të ndalohej, kur një gjë e tillë e kërkon interesi i ruajtjes së moralit, rendit publik ose sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur e kërkojnë interesat e të miturve, mbrojtja e jetës private të palëve në gjykim, tërësisht ose në atë masë që gjykata e mendon rreptësisht të nevojshme në rrethana të veçanta kur publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë.

Çdo person që akuzohet për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj (Neni 5/1 i KEDNJ). Askush nuk duhet të jetë objekt i një arrestimi ose burgimi arbitrar. Askush nuk duhet të privohet nga liria, përveç, për arsye, dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj. (Neni 9/1, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Ligji Nr. 7510 / 8.8.1991)

Çdo person që akuzohet për vepër penale ka këto të drejta minimale:

- i. Të vihet në dijeni brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe me hollësi për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij; ((Neni 5 paragrafi 2, KEDNJ)
- ii. Të ketë kohën dhe lehtësitë e përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen e tij;
- iii. Të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës ligjore që e zgjedh vete dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme që të paguajë për ndihmë ligjore, kjo t'i jepet pa pagesë kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- iv. Të pyesë vete ose të kërkojë të pyetën dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve në favor të tij në tënjëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij;
- v. Të ketë ndihmën pa pagesë tënjë përkthyesi, nëse ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në gjykatë.

Neni 5 paragrafi 2 i KEDNJ na thotë se:

“Çdo person i arrestuar duhet të informohet, brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet”.

Po të zbresim më poshtë në analizën tonë paragrafi i 3 i nenit 5 së KEDNJ, na citon:

“Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një magjistrati tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë procedurës. Lirimi mund të kushtëzohet me një garanci që siguron paraqitjen e personit në fjalë në gjykim”.

Ndërsa paragrafi i 4 parashikon se:

“Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm (Neni 5 paragrafi 4 i KEDNJ)”.

Paragrafi i 5 vazhdon plotësimin me parashikimin e cituar:

“Çdo person, që arrestohet ose burgoset në rrethana që bien ndesh me dispozitate këtij neni ka të drejtën e dëmshpërblimit”(Neni 5 paragrafi 5 i KEDNJ).

Neni 6, është interpretuar nga Gjykata Evropiane e të drejtave të Njeriut në precedentin e saj. Duke pasur parasysh faktin se asnjë ankesë nuk do të konsiderohet si e pranueshme nga Gjykata, derisa të jenë ezauruar të gjitha shkallët gjyqësore vendase, konstatojmë se gati të gjitha çështjet që pretendojnë se ka pasur shkelje të Nenit 6 do të gjykohe në gjykatat e shkallës më të lartë kombëtare përpara se të paraqiten në Strasburg. Gjykata shpesh ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të Nenit 6, sepse konsideron që procedimet “*të marra si një e tërë*” ishin të drejta, pasi një gjykatë e shkallës më të lartë do të mund të korrigjojë gabimet e gjykatës së shkallës së ulët.

Duke qënë se gjyqtari që i përket gjykatës së shkallës së ulët është përgjegjës për të siguruar përputhshmërinë me Nenin 6 në procedimet që ai ndjek, ai nuk mund të mbështetet në mundësinë që një gjykatë e shkallë më të lartë do të mund të korrigjojë gabimet (Vorpsi, 2011).

Garancitë e parashikuara në Nenin 6 zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por edhe gjithashtu edhe në fazat që paraprijnë dhe pasojnë ato. Në çështjet penale garancitë përfshijnë hetimet paragjyqësore të kryera nga policia. Gjykata deklaron në vendimet e saj, se koha e duhur që garantohet fillon që nga momenti kur ngrihet një akuzë, dhe se kushtet e tjera të Neni 6 - veçanërisht të paragrafit 3 - mund të jenë gjithashtu të përshtatshme përpara se një çështje të parashikohet në gjyq, nëse, dhe për sa kohë që drejtësia e gjyqit të paragjykohet seriozisht nga një dështim fillestar për të qënë në pajtim me to. Gjykata gjithashtu është shprehur, se në çështjet që kishin lidhje me Nenin 8 të Konventës - të drejtën për jetën e familjes. Neni 6 gjithashtu, zbatohet për fazat administrative të procesit gjyqësor. Neni 6 nuk parashikon të drejtën për apelim. Megjithatë, kjo e drejtë parashikohet për çështjet penale nga Nenin 2 i Protokollit Nr. 7 të Konventës Evropiane. Gjykata ka deklaruar në precedentin e saj se, kur një shtet nuk parashikon, në të drejtën vendase një të drejtë të tillë për apelim, këto procedime mbulohen nga garancitë që parashikohen në Nenin 6, edhe nëse Neni 6 nuk parashikon një të drejtë për apel. Megjithatë, mënyra sesi këto garanci vihen në zbatim duhet të jenë në varësi të tipareve të veçanta të procedimeve të tilla. Në bazë të precedentit të Gjykatës, duhet marrë parasysh tërësia e procedimeve të kryera në rendin ligjor vendas, funksionet në ligj dhe praktikë të organit të apelimt dhe pushteti e mënyra në të cilën paraqiten dhe mbrohen interesat e palëve. Kështu, nuk ekziston asnjë e drejtë e tillë për ndonjë lloj të caktuar apeli ose mënyrë për t'u marrë me apelimet.

Neni 16 mbulon gjithashtu procedurat pas seancës gjyqësore, të tilla si ekzekutimi i një vendimi. Gjykata është shprehur në *“Hornsby kundër Grekisë”*, se e drejta për një proces gjyqësor që mbulohet nga Neni 6, do të ishte i rremë nëse një sistem ligjor vendos i një Shteti Kontraktues do të lejonte që të mbetej mosveprues në dëm të një pale, një vendim përfundimtar përfaqëson një vendim gjyqësor të detyrueshëm për tu zbatuar. Është i qartë fakti se Neni 6 mbulon procedimet të marra si një e tërë. Gjykata ka deklaruar se ndërhyrja e një legjislature për të përcaktuar rezultatet e procedimeve duke aprovuar një ligj, mund të shkelë parimin e barazisë në mjete.

Gjykata Kushtetuese ka rolin e saj në aspektin e zbatimit procesit të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese ka kompetenca të kufizuara lidhur me të drejtën e saj për të shqyrtuar ankesat e individëve. Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Neni 42 i Kushtetutës që i korrespondon (pjesërisht) nenit 6 të KEDNJ, sanksionon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. GJEDNJ ka theksuar se, edhe pse një praktikë gjyqësore që në pamje të parë nuk duket se përbën një mjet të efektshëm, mundet që me kalimin e kohës dhe akumulimin e jurisprudencës në fund të konsiderohet një mjet efektiv, që në parim duhet të ezaurohet.

.

2.3.2. *Prezumimi i Pafajësisë: Neni 6(2)*

Neni 6(2) konstaton në Konventë, të drejtën për t'u prezumuar i pafajshëm.

Parimi themelor i kësaj të drejte është se një individ i akuzuar për kryerjen e një vepre penale ka të drejtën e përfitimit të dyshimit (parimi *In dubio pro reo*).

Neni 6 (2) nuk ndalon domosdoshmërisht prezumimin e të drejtës ose faktit, por çdo rregull që zhvendos barrën e provës ose që zbaton një prezumim që operon kundër të akuzuarit duhet të kufizohet brenda "*kufijve të arsyeshëm që marrin parasysh rendësin e asaj që është në rrezik dhe respektojnë të drejtat e mbrojtjes*". Në çështjen e *Salabiaku kundër Francës*, kërkuesi mori dërgesën e një mauneje të ngarkuar, që doli se përmbante drogë, dhe iu nënshtrua prezumimit të përgjegjësisë. Gjykata megjithatë u shpreh, se meqë gjykatat vendase respektonin lirinë e vlerësimit dhe i kushtuan vëmendje fakteve të çështjes, nuk konstatoi shkelje me shfuqizimin e dënimit.

Neni 6 (2) zbatohet për ndjekjet penale në rregullin e tyre dhe komentet e bëra nga gjyqtarët mbi përfundimin e procedimeve, ose kur i akuzuari është liruar nga akuzat, do të rezultojnë në shkelje të prezumimit të pafajësisë. Në çështjen e *Minelli kundër Zvicres*(1983), ndjekja ligjore e kërkuesit qëndronte për shkak të skadimit të një periudhe kufizimi statusor. Megjithatë, gjykata vendase urdhëroi që ai duhet të paguante një pjesë të shpenzimeve të ndjekjes penale dhe kompensonte viktimën e pretenduar, dhe po të mos kishte qënë për përjashtimin kohor, kërkuesi me shumë mundësi do të ishte dënuar. Kështu u konstatua shkelje e Nenit 6 (2), duke qënë se drejtimi i gjyqit nga ana e gjykatës vendase ishte në mospajtim me prezumimin e pafajësisë.

Deklarimi i fajësisë ishte bërë nga polici pa ndonjë kualifikim apo rezervë dhe nxiti publikun të besonte se kërkuesi ishte fajtor përpara se të bëhej vlerësimi i fakteve nga një gjykatë kompetente. Kjo u konstatua se përmbente shkelje të parimit të

prezumimit të pafajësisë, dhe nuk u korrigjua nga fakti se kërkuesi me vonë u lirua nga një gjyqtar për mungesë provash.

Prezumimi i pafajësisë duhet të miratohet njësoj, si përpara gjykimit edhe pas lirimit. Gjykata u shpreh se, nuk është më e pranueshme për gjykatat vendase që të mbështeten në dyshime, përse i përket fajësisë së një kërkuesi kur lirimi i tij është bërë përfundimtar (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2004).

Prezumimi i pafajësisë është një parim me themele të qarta kushtetuese dhe procedurale penale (Vasilika Hysi, “Respektimi i të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës—kushte të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, realitete dhe sfida”, f.5).

Në doktrinë dhe në jurisprudencat kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, rezulton se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Presumimi i pafajësisë, përmban në vetvete dy nënparime të rëndësishme, njëri prej të cilit është “*in dubio pro reo*”, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie mbi organin e akuzës. Kuptimi i prezumimit të pafajësisë orientohet në interpretimin e përgjithshëm, që aktet proceduriale paraprocesuale dhe ato procesuale, nuk duhet të hartohen dhe të shprehin në frymën e tyre, bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza. (Vendimet nr.23, datë 23.7.2009, dhe nr.9, datë 28.4.2004, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë).

Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, ky parim cenohet nese: “...një vendim gjyqësor, që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është

fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal mjafton që të ketë një arsyetim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor”.

2.3.3. E drejta për t’u vënë në dijeni brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai kupton dhe në mënyrë të hollësishme: Neni 6(3)a

Deri më sot ka pasur pak praktikë gjyqësore për këtë dispozitë të nenit 6(3)a.

Lista e garancive minimale që parashtrihen në Nenin 6 (3) *a-e*, nuk është e plotë. Ajo përfaqëson aspekte specifike të së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor. Gjykata është shprehur se marrëdhënia midis Nenit 6 (1) dhe Nenit 6 (3), është *"ajo që fillon nga e përgjithshmja tek e veçanta"*. Një proces penal si rrjedhim mund të dështojë në përmbushjen e kushteve për një proces të drejtë gjyqësor, edhe nëse respektohen garancitë minimale të Nenit 6 (3) .

Neni 6 (3) a, deklaron që çdokush që akuzohet për vepër penale ka të drejtë për t’u vënë në dijeni menjëherë, në një gjuhë që ai/ajo e kupton dhe në detaj, mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij/saj (Mole, Harby, 2003).

Kjo dispozitë ka si synim informacionin që kërkohet t’i jepet të akuzuarit në kohën e akuzës ose në fillimin e procesit gjyqësor. Për sa i përket marrëdhënies ndërmjet kësaj dispozite dhe Nenit 5 (2), ky i fundit përgjithësisht kërkon më pak detaje dhe nuk është aq i saktë (Mole, Harby, 2003).

Ne çështjen e *De Salvador Torres kundër Spanjës*, kërkuesi u ankimua se gjykata vendase ishte mbështetur në rrethanat rënduese që nuk ishin përmendur në akuzë, për të rritur dënimin. Megjithatë, Gjykata nuk konstatoi shkelje, duke qënë se rrethana ishte një element themelor për akuzën e bërë kundër kërkuesit, të ditur nga ai nga fillimi i

procesit gjyqësor. Komisioni u shpreh se faktet materiale gjithmonë kishin qënë të ditura nga kërkuesi, por nuk kishte prova të informimit të kërkuesit nga ana e autoriteteve përkatëse, mbi propozimin për të riklasifikuar veprën penale përpara seancës se apelit. Informacioni për akuzën duhet të jetë në një gjuhë që i akuzuari e kupton.

]Në çështjen e *Brozicek kundër Italisë*, i akuzuari ishte gjerman, shprehu qartë vështirësitë e tij gjuhësore për gjykatën vendase. Gjykata Evropiane u shpreh se autoritetet italiane duhet të kishin përkthyer njoftimin, përveç, nëse ato do të ishin në pozitë të tillë që të konkludonin se ai e zotëronte mirë gjuhën italiane, që nuk ishte e vërtetë në këtë rast.

Po kështu, Gjykata u shpreh në *Kamasinski kundër Austrisë*, ku i pandehuri që nuk e fliste gjuhën e gjykatës, mund të ishte vënë në pozita, në disavantazh, nëse nuk do t'i ishte siguruar një përkthim me shkrim i padisë në gjuhën që ai kuptonte.

Është thelbësor fakti, që vepra penale për të cilën është dënuar një person, të jetë ajo për të cilën ai është akuzuar. Në *Pelissier dhe Sassi kundër Francës*, i akuzuari u akuzua vetëm për aktin e falimentimit penal, por u dënua për komplot për kryerje të falimentimit penal. Gjykata u shpreh, se meqënëse thelbi i dëshmisë së të dy oficerëve ndryshonte, kjo përbënte shkelje të Konventës (KEDNJ, 2004).

2.3.4. E drejta për kohë dhe lehtësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes: Neni 6(3)b

Neni 6 (3) b, deklaron që çdokush që akuzohet për një vepër penale, ka të drejtën për të pasur në dispozicion kohën e lehtësitë e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij/saj.

Roli i gjyqtarit në lidhje me këtë dispozitë, është që të arrij të vërë ekuilibrin e duhur midis këtij kushti dhe detyrimit për të siguruar që gjyqet të përfundohen brenda një kohe të arsyeshme. Kjo dispozitë është e lidhur ngushtë edhe me Nenin 6 (3) c, të drejtën për të marrë asistencë ligjore dhe ndihmë ligjore.

Ankimet në këtë pikë, në lidhje me dënimet janë deklaruar si të papranueshme kur janë kryer nga një person që është liruar me pas nga apeli në ndjekjen penale, ose nga një i akuzuar që deklaron se ai/ajo nuk do të marrë pjesë më në procesin gjyqësor. Roli i gjyqtarit megjithatë është që të sigurojë që kjo mbrojtje të respektohet në procesin gjyqësor përpara tij/saj dhe të mos mbështetet në mundësinë e gabimit që mund të ndreqet në apel (Vorpsi, 2011).

Përshtatshmëria e kohës do të jetë në varësi të gjitha rrethanave të çështjes duke përfshirë kompleksitetin dhe fazën ku kanë arritur procedimet, të mjaftueshme për të mundësuar që të bëhet përgatitja e duhur për çështjen. Ky parim nënkupton prezumimin që avokati i të akuzuarit të këtë akses të pakufizuar e konfidencial për çdo klient që mbahet në paraburgim, me qëllim që të diskutojë të gjithë elementet e çështjes. Gjyqtarët duhet të bëjnë të qartë për të gjitha palët, kur japin autorizime ose zgjasin kohën e mbajtjes në paraburgim, ku leja e tyre nuk kërkohet për kryerjen e vizitave ligjore. Nëse prokurori gjithashtu dëshiron të autorizojë vizitat ligjore, kjo dispozitë jo vetëm që do të cënohet, por mund të vihet në dyshim i gjithë drejtimi me drejtësi i gjyqit. Ajo vijon duke thënë se autoritetet e burgjeve nuk mund të kërkojnë autorizim nga gjyqtari me qëllim që të lehtësojnë vizitat ligjore. Gjithashtu, ata duhet të sigurojnë që lehtësitë e duhura të sigurohen për të mundësuar që vizitat ligjore të mbahen në konfidencë dhe pa u dëgjuar nga autoritetet e burgut (Mole , Harby, 2003).

Kur i akuzuari ose avokati i tij pretendojnë se nuk janë siguruar lehtësitë e duhura, gjyqtari ka përgjegjësinë për të vendosur nëse gjyqi mund të vazhdojë apo jo, pa krijuar shkelje të Nenit 6 (3) b. Për këtë gjyqtari do të ketë parasysh se e drejta e të akuzuarit për të komunikuar lirshëm me avokatin e tij në përgatitjen e mbrojtjes së tij konsiderohet si absolutisht qendrore për konceptin e një procesi të drejtë gjyqësor.

Për sa i përket të drejtës se kërkuesit për të pasur akses në prova Komisioni u shpreh në çështjen e *Jespers kundër Belgjikes* se:

Komisioni ka pikëpamjen se "lehtësitë" të cilat çdokush që është i akuzuar për veprë penale duhet të gëzojë, përfshijnë mundësinë për të qënë në dijeni, për qëllime të përgatitjes së mbrojtjes së tij, për rezultatet e hetimeve të kryera, megjithë procesin gjyqësor. Gjithashtu, Komisioni ka njohur tashmë faktin se megjithëse një e drejtë për akses për dosjet e akuzës nuk garantohet shprehimisht nga Konventa, një e drejtë e tillë mund të supozohet nga Neni 6, paragrafi 3. B... Për më tepër, ka pak rëndësi, se nga kush dhe kur urdhërohen hetimet, ose nën autoritetin e kujt janë kryer.

Komisioni vijoi duke deklaruar se (Mole , Harby, 2003):

Shkurtimisht, Neni 6, paragrafi 3. b njeh të drejtën e të akuzuarit për të pasur në dispozicionin e tij, për qëllime të lirimit të tij ose të përfitimit të uljes së dënimit, të gjithë elementet përkatës që janë ose mund të mbledhen nga autoritetet kompetente.

Komisioni shtoi se kjo e drejtë u kufizua në ato lehtësira që asistojnë ose mund të asistojnë mbrojtjen. Parimi në praktikë ka pasur një interpretim mjaft të ngushtë. Në çështjen e sipërpërmendur të *Jespers kundër Belgjikës*, kërkuesi pretendoi mungesën e qasjes për një dosje të veçantë të prokurorit publik. Komisioni, megjithëse theksoi faktin se refuzimi i qasjes do të cënonte Nenin 6 (3) b, në rast se do të kishte në përmbajtje të tij, ndonjë gjë që do të mundësonte lirimin e tij ose reduktimin e masës së dënimit, konstatoi se nuk kishte prova të tilla nga kërkuesi dhe Komisioni nuk ishte i përgatitur për të prezumuar se Qeveria nuk kishte përmbushur detyrimet e saj.

Më tej Gjykata është shprehur se një shtet mund të kufizojë aksesin për dosje për

avokatin e mbrojtjes. Kufizimet për zbulimin e provave nga kërkuesi janë konstatuar të pranueshme kur ka arsye të forta në interes të ushtrimit të drejtësisë, megjithëse mund të argumentohet se provat ishin të rëndësishme për mbrojtjen (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2004).

2.3.5. E drejta për t'u mbrojtur vetë ose nëpërmjet ndihmës ligjore të zgjedhur: Neni 6 (3)c

Dispozita bazë e Nenit 6, në fjalinë e parë të paragrafit 1, është "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet në një proces të rregullt, publik ligjor dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij." (Portali zyrtar i Këshillit të Europës, 2015). Procesi i rregullt ligjor është garanci me rëndësi jetike në çdo shoqëri demokratike, kështu që ky nen është një ndër dispozitat më të rëndësishme dhe më të atakuara të Konventës. Për procesin e rregullt ligjor ka më shumë çështje në gjykatë se për çdo lloj të drejtë tjetër të parashikuar në Konventë. Përgjegjësia për sigurimin e procesit të rregullt ligjor bie shumë më tepër mbi gjyqtarët, prokurorët publikë dhe ligjbërësit sesa mbi zyrtarët që merren drejtpërsëdrejti me publikun, për të cilin është hartuar ky dokument. Por, policia (e cila në disa sisteme mund të luajë rolin e prokurorisë) dhe oficerët e burgjeve kanë përgjegjësi në çështjet penale, ndërsa edhe zyrtarë të tjerë, për shembull, zyrtarët e gjykatave, punonjësit socialë, zyrtarët licencues dhe sekretarët, mund të kenë po ashtu përgjegjësi për çështjet civile.

Për shkak se Konventa duhet të zbatohet për shumë shtete anëtare, sistemi ligjor i

të cilave është në thelb i ndryshëm, Gjykata i ka dhënë kuptim “autonom” në Konventë shumë prej termave në nen. Kjo gjë zbatohet, për shembull, për termat "penale", "akuzë" dhe "e drejtë civile". Këto terma jo gjithmonë kanë të njëjtin kuptim që u jepet nga sistemet ligjore kombëtare (Portali zyrtar i Këshillit të Europës, 2015).

Neni 6 (3) c, siguron për të akuzuarin, të drejtën për t'u mbrojtur personalisht ose nëpërmjet asistencës ligjore sipas zgjedhjes së tij/saj ose nëse ai/ajo nuk ka mjete të mjaftueshëm për të paguar asistencë ligjore, t'i jepet pa pagesë kur e kërkojnë këtë interesat e drejtësisë.

Gjykata është shprehur se e drejta për t'u përfaqësuar vete nuk është një e drejtë absolute. Në (çështjen e *Croissant kundër Gjermanisë*), ajo u shpreh se kushti që një i pandehur të asistohet nga një avokat në procesin e gjykatës vendase nuk ishte në pajtim me Nenin 6 (3) c. Kur i akuzuari ka të drejtën e asistencës ligjore pa pagesë, ai/ajo ka të drejtë për asistencë ligjore, e cila është praktike dhe efektive dhe jo thjesht teorike dhe e gënjeshtërt. Gjykata u shpreh në *Artico kundër Utilise* se, edhe nëse autoritetet nuk mund të jenë përgjegjëse për çdo gabim të një avokati të ndihmës ligjore dhe drejtimin e mbrojtjes, theksoi se:

... Neni 6 (3) flet për "asistencë". Përsëri, edhe thjesht emërimi nuk siguron asistencë efektive duke qënë se avokati i caktuar për qëllime të ndihmës ligjore mund të vdesë, të sëmurët rëndë, të ndalohet përnjë periudhe të gjatë të veprojë si i tillë ose t'i shmanget detyrimeve të tij. Nëse ata nuk vihen në dijeni mbi situatën, autoritetet ose duhet ta zëvendësojnë atë, ose ta detyrojnë të përmbushë detyrimet e tij (Mole, Harby, 2003).

Gjykata më tej deklaroi në çështjen e *Kamasinski kundër Austrisë* se:

“...autoritetet kompetente vendase kërkojnë që të ndërhyjnë në bazë të Nenit 6 (3) vetëm nëse një këshilltar i ndihmës ligjore dështon të sigurojë përfaqësimin efektiv ose i ka tërhequr vëmendjen kjo gjë në mënyra të tjera.”

Aty ku është e qartë se avokati që përfaqëson të akuzuarin përpara gjykatës

vendase nuk ka pasur kohën dhe lehtësirat për të përgatitur siç duhet çështjen, gjyqtari që drejton procesin ka detyrimin që të marrë masa te natyrës pozitive për të siguruar që detyrimet e tij/saj ndaj të pandehurit të përmbushen siç duhet. Në rrethana të tilla mund të kërkohej zakonisht një shtyrje procesi.

Komisioni u shpreh se e drejta për të zgjedhur një avokat lind vetëm kur i akuzuari ka mjete të mjaftueshme për të paguar avokatin. Një i akuzuar i ndihmuar ligjërisht si rrjedhojë nuk ka të drejtë që të zgjedhë përfaqësuesin e tij, ose të konsultohet mbi këtë çështje. Edhe kështu e drejta për të zgjedhur nuk është absolute: Shteti ka të drejtë të rregullojë shfaqjen e avokatëve në gjykata dhe në disa rrethana të përjashtojë kualifikimet e individëve të veçantë.

E drejta për ndihmë ligjore për një të akuzuar varet nga dy rrethana. Së pari, fakti që i akuzuari ka mungesë të mjetëve të mjaftueshme për të paguar asistencë ligjore. Jo shumë çështje në lidhje me këtë gjendje janë ngritur përpara Gjykatës, por duket se niveli i kërkuar nga një i pandehur për të vërtetuar se ai/ajo nuk disponon burimet e duhura për mbrojtje nuk duhet të vihet shumë lartë.

Kushti i dytë është që interesat e drejtësisë kërkojnë që të sigurohet ndihma ligjore. Një sërë faktorësh duhen marrë parasysh në këtë rast. Gjykata duhet të marrë parasysh aftësinë e të pandehurit për të paraqitur çështjen në mënyrën e duhur pa asistencë. Gjykata është shprehur në çështjen e *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar* se "*kur privimi nga liria është në rrezik interesat e drejtësisë në parim kërkojnë përfaqësim ligjor*". Megjithatë Gjykata theksoi gjithashtu se procesi gjyqësor nuk ishte i drejtpërdrejtë.

Gjykata vijoi me vendimin e marrë në *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Kjo çështje kishte të bënte menjë numër aplikantësh që ishin burgosur për shkak se nuk

kishin mundur të paguanin detyrimin e komunitetit. Gjykata u shpreh se duke pasur parasysh rëndesën e dënimit të rrezikuar nga kërkuesit dhe kompleksitetin e së drejtës së aplikueshme, interesat e drejtësisë kërkonin që, me qëllim që të siguronin një seance të drejtë gjyqësore, kërkuesit duhet të përfitonin nga përfaqësimi i lirë ligjor (Mole, Harby, 2003).

Faktorët në lidhje me çështjen e ndihmës ligjore mund të ndryshojnë, dhe çdo refuzim për ndihmë ligjore si rrjedhim duhet rishikuar. Në *Granger kundër Mbretërisë së Bashkuar*, shkalla e kompleksitetit përfshinte një nga çështjet, sepse përcaktimi u bë vërtet i qartë gjatë seancës së apelit. Gjykata u shpreh se do të ishte në interes të drejtësisë që ndihma ligjore të ishte e disponueshme që nga ai moment e më vonë dhe se në mungesë të ndonjë rishikimi të vendimit origjinal, do të kemi shkelje të Nenit 6 (3) c. (Mole, Harby, 2003).

Gjykata ka theksuar se nuk është e nevojshme që të provohet se mungesa e asistencës ligjore ka shkaktuar paragjykim faktik me qëllim që të përcaktohet shkelja e Nenit 6 (3) c.

Nëse prova të tilla do të ishin të nevojshme, kjo do të privonte konsiderueshëm dispozitën nga thelbi i saj (në çështjen *Artico kundër Italisë*, 1980). E drejta për ndihmë ligjore në çështjet civile nuk parashtrohet shprehimisht në Konventë, por Gjykata është shprehur se duhet të jetë e disponueshme nëse e kërkojnë këtë, interesat e drejtësisë (*Aiery kundër Irlandës*, 1979).

2.3.6. E drejta për t'u ballafaquar me dëshmitarët: Neni 6 (3) d

E drejta e pyetjes së dëshmitarëve të prokurorisë dhe thirrja e dëshmitarëve në

mbrojtje (paragrafi 3(d)). Në rastet kur dëshmia e dëshmitarit është vendimtare lidhur me fajësinë e të akuzuarit, këtij të fundit duhet t'i jepet mundësia e kundërpvetjes së dëshmitarit dhe, nëse është e nevojshme, dhe ndihmë ligjore (Portali zyrtar i Këshillit të Europës, 2015).

Parimi i përgjithshëm pra është se personat e akuzuar duhet të lejohen të kërkojnë dhe shqyrtojnë cilindo dëshmitar, dëshmia e të cilit konsiderohet nga ata, që ka lidhje me çështjen e tyre dhe duhet të jenë në gjendje të shqyrtojnë cilindo dëshmitar që thirret, ose kur provat e të cilit mbështeten nga prokurori.

Kjo dispozitë nuk i jep një të akuzuari të drejtën absolute për të thirrur dëshmitarë ose të drejtën për të detyruar gjykatat vendase që të dëgjojnë një dëshmitar të caktuar. E drejta kombëtare mund të parashtrojë kushtet për pranimin e dëshmitarëve dhe autoritetet kompetente mund të refuzojnë që një dëshmitar të lejohet të thërret në gjyq nëse duket se provat që do të japë nuk kanë lidhje me çështjen. Kështu kërkuuesi duhet të përcaktojë se dështimi për të dëgjuar një dëshmitar të caktuar mund të ketë paragjykuar çështjen e tij/saj . Megjithatë, procedura e thirrjes në gjyq dhe e dëgjimit të dëshmitarit duhet të jetë e njëjtë si për akuzën ashtu edhe për mbrojtjen dhe këtu kërkohet zbatimi i parimit të barazisë në mjete(Mole , Harby, 2003).

Në parim, të gjitha provat ku mbështetet akuza duhet të prezantohen në prani të të akuzuarit në një seancë të hapur duke pasur parasysh argumentimin e anasjelltë. Kështu do të lindin probleme nëse akuza paraqet deklarata me shkrim nga një person që nuk shfaqet si dëshmitar, për shembull sepse ai/ajo ka frikë nga hakmarrja e të akuzuarit ose të afërmeve të tij/saj.

Vetëm rrethanat përjashtuese do të lejojnë akuzën që të mbështetet në prova nga një dëshmitar, të cilin i akuzuari nuk ka mundur ta shqyrtojë. Marrja e vendimit nga ana

e një gjyqtari të akuzës penale duke u mbështetur në dosjen e akuzës, por pa prezencën e paditësit për t'iu përgjigjur ndonjë kundërshtimi nga ana e të akuzuarit ka të ngjarë që të t'i japë shkas rrezikut të shkeljes së kësaj dispozitë. Gjyqtari sigurisht që nuk mund të mbrojë çështjen e paditësit nëmungesë të tij pa rënë dakord për paanshmërinë e tij.

Shumë prej Shteteve të Konventës kanë rregulla që përjashtojnë disa dëshmitar si anëtarët e familjes për të dhënë prova. Gjykata deklaroi në çështjen e *Unterpertinger kundër Austrisë*, se klauzola të tilla janë qartësisht të pajtueshme me Nenin 6 (1) dhe 6 (3) d. Megjithatë, në atë rast, Gjykata vërejti se, gjykata vendase nuk trajtoi deklaratat nga ish-gruaja e kërkuesit dhe thjesht e tij, si pjesë informacioni, por si prova të së vërtetës së akuzave të ngjitura nga gruaja në atë kohë. Dënimi i kërkuesit ishte bazuar kryesisht në këtë provë dhe kështu të drejtat e palës mbrojtëse nuk ishin garantuar mjaftueshëm (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2004).

Probleme do të lindin gjithashtu nëse një dëshmitar sëmuret rëndë ose vdes. Gjykata është shprehur se kjo mund të justifikojë mbështetjes në provat gojore (thashetheme) për sa kohë që faktorët e kundërt mbrojnë të drejtat e palës mbrojtëse. Për sa i përket çështjes së shëndetit të dobët Gjykata do të konsiderojë mjaftueshëm ekzistencën e alternativave që do të shmangin rekursin në provat gojore (thashetheme) në çështjen e *Bricmont kundër Belgjikës*, Princi i Belgjikës kishte paraqitur padi kundër kërkuesve, por nuk kishte dhënë prova me baza mjekësore. Gjykata u shpreh se:

“Në rrethanat e çështjes, ushtrimi i të drejtave të palës mbrojtëse -një pjesë thelbësore e së drejtës për një proces të drejtë gjyqësor - kërkon në parim, që kërkuesit të kenë mundësinë për të kundërshtuar çilindo aspekt të rrëfimit të të ankimuarit gjatë konfrontimit ose shqyrtimit, si në publik, ose, nëse është e nevojshme, edhe në shtëpinë e tij”.

Një frikë normale ndaj hakmarrjes në disa rrethana mund të justifikojë

mbështetjen në provat në bazë të thashethemit. Megjithatë, duhet të këtë procedura konfrontuese për të respektuar të drejtën e palës mbrojtëse (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2004). Në çështjen e *Saidi kundër Frances* (1993), kërkuesi ishte dënuar për trafik droge, në bazë të provave, bazuar në thashethemin nga tre dëshmitar anonim. Gjykata u shpreh:

Gjykata është plotësisht në dijeni të faktit se ka vështirësi të pamohueshme në luftën kundër trafikut të drogës, në veçanti në lidhje me përfitim dhe dhënien e provave - dhe me indinjatën e shkaktuar shoqërisë nga problemi i drogës, por prova të tilla nuk mund të justifikojnë kufizimin në këtë masë të të drejtave të mbrojtjes të çdokujt që paditet me akuzë penale (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2004).

Gjykata konstatoi se ishte shkelur Neni 6 (3) d, sepse prova e identifikimit përbënte të vetmen bazë për dënimin e kërkuesit. Si rregull i përgjithshëm, frika nga hakmarrja ku gjykata u mbështet për të justifikuar rekursin në provat në bazë të thashethemeve nuk duhet të lidhet me ndonjë kërcënim specifik nga ana e të pandehurit. Gjykata u shpreh megjithëse dy dëshmitaret nuk ishin kërcënuar ndonjëherë nga kërkuesi, trafikantët e drogës shpesh kalonin në kërcënime ose dhune aktuale kundër personave që kishin dëshmuar kundër tyre (Mole, Harby, 2003).

Një problem tjetër me dëshmitaret anonim është që pala mbrojtëse nuk ka mundësi të kundërshtojë besueshmërinë e dëshmisë. Gjykata deklaroi në *Kotovski kundër Vendeve të Ulta*, se nëse pala mbrojtëse nuk është në dijeni të identitetit të personit që kërkon të pyesë, ajo mund të privohet nga të veçantat e heshtjet që do të mundësonin atë të provonte se ai ose ajo është paragjyqese, dyshuese dhe e pabesueshme. Dëshmia ose deklaratat e tjera që fajësojnë një të akuzuar mund të quhen me paramendim të pavërtetë ose thjesht të gabuara, dhe mbrojtja zor se do të jetë në gjendje të nxjerrë në dritë konkluzione të tilla, nëse i mungon informacioni që do ta lejojë atë të testojë besueshmërinë e autorit ose të hedhë dyshime mbi besueshmërinë e

tij. Rreziqet që përfshihen në një situatë të tillë janë të qarta. Procedurat e kundër balancimit duhet të sigurojnë një proces të drejtë gjyqësor që do të variojnë nga një çështje në tjetrën. Faktorët e rëndësishëm kanë të bëjnë kryesisht me faktin, nëse i akuzuari ose avokati i tij ishin të pranishëm kur u pyet dëshmitari, nëse ai/ajo mund të bënte pyetje dhe nëse gjyqtari ishte në dijeni të identitetit të dëshmitarit (Mole , Harby, 2003).

Së fundi, është e rëndësishme të vërehet se, edhe kur ekzistojnë procedura të mjaftueshme kundër balancuese, një dënim nuk duhet të bazohet as vetëm, e as nga prova e dhënë nga dëshmitari anonim për të marrë një vendim.

Rëndësia e provës me dëshmitarë, është e përcaktuar në mënyrë të qartë qoftë në procesin penal asht dhe në atë civil.

Në zgjidhjen e një mosmarrëveshje juridiko –penale apo juridiko - civile, nga pikëpamja ligjore, vlera e provës me dëshmitarë qëndron në të njëjtin raport me provat e tjera, me përjashtim kur ligji e ndalon përdorimin e një prove të tillë.

Megjithatë kjo provë, duke marrë parasysh elementët objektivë dhe subjektivë që mund të ndikojnë në vlerën provuese të saj duhet të vlerësohet me shumë kujdes nga gjykata, duke shqyrtuar në tërësi rrethanat e çështjes dhe duke e analizuar në raport me provat e tjera.

Shumëllojshmëria e marrëdhënieve juridike që krijohen si dhe tendenca për t'i formalizuar ato nuk i'a zbehin aspak rëndësinë provës me dëshmitarë. Ajo ka sërish një zbatim të gjerë në praktikë dhe jo rrallë është vendimtare në zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Shohim një trajtim të ndryshëm të provës me dëshmitarë gjatë procesit penal dhe atij civil.

Sipas Kodit të Procedurës Civile prova me dëshmitarë është subjekt i kufizimeve që shprehin akoma elementë të teorisë formaliste në procesin e vlerësimit të provave. Këto kufizime shprehin vazhdimsinë e një botëkuptimi të vjetër i cili pasqyrohej në mosbesimin nga njëra anë ndaj funksionit gjyqësor dhe nga ana tjetër në dyshimin që ekzistonte tek dëshmitarët si burim të dhënash mbi fakte dhe rrethana.

Ligji duhet t'i largohet konceptimeve të tilla dhe në çdo rast duhet të jetë gjyqtari ai i cili duhet të vlerësojë fuqinë provuese të çdo prove edhe pse në pamje të parë disa prej këtyre provave mund të krijojnë besueshmëri më të madhe për nga natyra e tyre. Edhe ekspertimi si mjet provues, në situata të caktuara mund të japë të dhëna më të sakta sesa prova me dëshmitarë për të njëjtin fakt, bazuar në burimin e tij shkencor, megjithatë Kodi i Procedurës Civile në asnjë dispozitë të tij nuk i ka dhënë një fuqi më të madhe provuese në raport me dëshminë.

Një problematikë tjetër që shfaqet në ligjin procedural ka të bëjë me identifikimin e shkaqeve absolute nga ato relative të ndalimit të pyetjes si dëshmitar. Nëse tek të parat personi ka një ndalim ligjor për t'u pyetur në cilësinë e dëshmitarit, në rastin e dytë është e drejta ekskluzive e tij për t'u përgjigjur ose jo në situatat në të cilat ai thirret si dëshmitar. Në këtë pikë duhet të theksohet se Shtojca e Dytë e Kodit të Procedurës Civile të vitit 1929 bënte një identifikim më të mirë të këtyre rasteve dhe mund të shërbejë si një model serioz për përmirësimet e nevojshme në legjislacion. Gjithashtu vlen të përmendet se Kodi hesht në lidhje me dëshminë për të dhënat e klasifikuara si sekret shtetëror ose edhe për ato të konsideruara sekret profesional. Ndërkohë Kodi i Procedurës Penale e ka zgjidhur mjaft mirë këtë situatë.

E paqartë në Kod mbetet edhe mënyra e pyetjes së atyre që emërtohen si ekspertët e palëve. Neni 227 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se ata do të pyeten

në cilësinë e dëshmitarit, mirëpo ata nuk pyeten për fakte që kanë perceptuar drejtpërdrejt por japin një mendim shkencor alternativ me atë të dhënë nga eksperti. Pyetja e tyre mund të bëhet në cilësinë e dëshmitarit, për fakte procedurale të kostatuara prej tyre e që lidheshin me veprimtarinë e ekspertit, vetëm nëse do të lejohej të ishin prezent gjatë kryerjes së ekspertimit, por një e dretë e tillë i njihet vetë palës dhe roli i specialistit të kësaj pale kufizohet në dhënien e mendimeve e vërejtjeve me shkrim. E vetmja mundësi në të cilën këta subjekte mund të pyeten është në rolin e oponentit shkencor.

Çështja e fundit në lidhje me pyetjen e dëshmitarëve, që meriton të përmendet, është ajo që ka të bëjë me pyetjen e të miturve. Ata për shkak të zhvillimit të tyre psikik dhe influencës që mund të pësojnë, nuk mund të merren në pyetje si dëshmitarët e tjerë por kërkohet që të kenë gjithmonë prezencën e një personi i cili të mund t'i eliminojë në maksimum ndikimet negative që mund të perceptohen nga i mituri si pasojë e ambientit në të cilin bëhet pyetja e tij.

2.3.7. E drejta për përkthim pa pagesë: Neni 6 (3) e

Neni 6 (3) e parashikon se i akuzuari ka të drejtën e asistencës ligjore pa pagesë të një përkthyesi, nëse ai/ajo nuk e kupton ose flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Gjykata u shpreh në, *Luedicke, Belkacem dhe Kog kundër Republikës Federale të Gjermanisë(1987)*, se dispozita ndalon në mënyrë absolute që një i akuzuar të urdhërohet të paguajë shpenzimet e një përkthyesi. Gjykata deklaroi më tej se ky parim mbulonte "*ato dokumente ose deklarata në procese gjyqësore që ngrihen kundër tij, të cilat janë të nevojshme për të kuptuar që të këtë përfitimin e një procesi të drejtë gjyqësor*".

Megjithatë, në *Kamasinski kundër Austrisë (1989)* ,Gjykata miratoi një mënyrë

më kufizuese dhe u shpreh se, megjithëse Neni 6 (3) e zbatohet për materialet dokumente të zbuluara përpara gjyqit, nuk kërkohej përkthim me shkrim i të gjitha dokumenteve të tilla. Gjykata vërejti se këshilltari ligjor i mbrojtjes ishte kompetent në gjuhën amtare të kërkuesit. Gjykata u shpreh se:

“Asistencaduhet të jetë e tillë që të mundësojë që i pandehuri të ketë njohuri të rastit kundër tij dhe për të mbrojtur veten, shprehimisht duke qënë në gjendje të parashtrojë në gjykatë versionin e tij të fakteve”.

Detyrimi i autoriteteve kompetente nuk është i kufizuar më, thjesht në caktimin e një përkthyesi, por gjithashtu mund të shtrihet në ushtrimin e një shkalle kontrolli mbi përshtatshmërinë e përkthimit, nëse është nevojshme për t'u bërë. E drejta për një përkthyes shtrihet edhe tek njerëzit që nuk dëgjojnë, ku metoda normale e komunikimit është për shembull me shenja (Mole , Harby, 2003).

KAPITULLI III: INSTRUMENTET LIGJORE PËR REALIZIMIN E NJË PROCESI TË RREGULLT LIGJOR

3.1. Parimet bazë të punës së gjykatës

a) Parimi i drejtësisë në dispozicion të të gjithëve; b) Parimi i barazisë dhe i ndershmërisë; c) Parimi i rritjes së besimit të publikut ndaj gjykatave.

a) Parimi i drejtësisë në dispozicion të të gjithëve

E drejta e qytetarëve për t'iu drejtuar gjykatave është një e drejtë, e cila duhet t'i njihet të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh dallimet e tyre. Këtë të drejtë e garantojnë aktet juridike të shumë vendeve demokratike të botës. Përjashtimisht, e drejta për të pasur akses në një gjykatë nuk është absolute. Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës mund të vendosin kufizime mbi të drejtën e këtij aksesit përderisa kufizimet e tilla nuk çënojnë esencën e vet të drejtës së garantuar. Këto kufizime mund të jenë të domosdoshme për t'ia kursyer gjykatës kohën dhe burimet e shpenzuara që shumë mirë mund të shpenzohen për çështje vërtet të merituar. Në vështrim të këtij parimi duhet të pasur parasysh njohja e elementeve thelbësore të procesit të drejtë, kryesisht në çështjet penale, duke përfshirë paralajmërimin, shkakun e mundshëm, dorëzimin, të drejtën për avokat, ballafaqimin, pyetjen nga palët kundërshtare, të drejtën e dëshmitarëve, mbrojtjen nga vetakuzimi, vendimmarrjen brenda afatit sa më të shkurtër, gjykimin në juri dhe rishqyrtimin në apel (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm). Ekzistojnë shumë parakushte që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në shkallën e efikasitetit, siç janë: organizimi jofunksional i gjykatës, modernizimi me teknologjinë të kompjuterizuar, arsimimi i vazhduar, rritja e komunikimit, motivimi për punë, rritja e

numrit të gjyqtarëve etj. Çdo aktivitet procedural duhet të kryhet në kohë sa më të shkurtër, me punë më të pakta konkrete dhe me harxhime sa më të vogla, ngase drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar. Vonesat e paarsyeshme krijojnë ankth dhe pasiguri tek palët, dhe mund të rezultojnë në humbje, në shkatërrim të provave materiale, apo edhe në parashkrim të lëndëve etj. Nisur nga kjo, duke u mbështetur në kursime dhe në shpejtësi, gjykata nuk guxon të veprojë në dëm të të drejtave procedurale të palëve, e sidomos në dëm të zbulimit të së vërtetës materiale, të saktësisë dhe ligjshmërisë së vendimit. Gjkata ka për detyrim që vetvetiu të zhvillojë procedurën shpejt dhe me pak harxhime, duke zgjedhur vetë metodën dhe metodologjinë e punës, duke respektuar afatet ligjore. Janë shumë faktorë të cilët duhet marrë në konsideratë kur shqyrtohen çështjet komplekse. Kompleksiteti mund të ndikojë në aftësinë e gjyqtarit dhe në koston e veprimeve. Efektiviteti i gjykatave nuk varet vetëm nga mënyra se si çështjet zgjidhen nga gjyqtarët në ambientet e gjykatave por, edhe nga bashkëpunimi dhe administrimi institucional që ekziston për ta mbështetur dhe lehtësuar veprimtarinë e Gjykatave.

b) Parimi i barazisë dhe i ndershmërisë

Çështja e barazisë së palëve në gjykatë është thelbësore dhe prerogativë e vazhdueshme që duhet t'i përcjell gjykatat çdo herë dhe në secilën situatë. Këto kanë për detyrë që, procedurat në cilindo stad t'i zhvillojnë me ndershmëri dhe pa neglizhencë. Barazia e palëve para gjykatës mbështetet në parimin e "barazisë së mjeteve", ideja e së cilës ka për qëllim që palët në një proces duhet të kenë mundësi të barabarta dhe se asnjëra nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh ndaj palës kundërshtare. Ky parim përfshin nocionin se palët në një proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës tjetër kundërshtare dhe, secila palë duhet të ketë mundësi të

barabartë për t'iu përgjigjur palës tjetër (pavarësisht se për cilën procedurë është gjatë zgjidhjes së çështjeve dhe ushtrimit të funksionit, gjykata ushtron detyrat e veta me paanësi, e mbështetur në fakte dhe ligj, pa ladizime dhe pa qenë objekt ndikimesh, nxitjesh, presionesh, kërcënimesh apo ndërhyrje nga ndonjë komponent tjetër. Nuk ka gjyqësi të pavarur pa shtet juridik dhe sundim të ligjit. Gjyqësi të pavarur mund të ketë vetëm në shtetin juridik i cili presupozon që çdo pushtet në të është i kufizuar dhe i kontrolluar mirë. Nuk ka shtet juridik pa gjyqësi të pavarur dhe, anasjelltas. Pavarësia, paanshmëria dhe përgjakshmëria janë parime që e obligojnë gjykatën dhe vet gjyqtarët.

c) Parimi i rritjes së besimit të publikut ndaj gjykatave

Besimi publik te gjykatat është i domosdoshëm dhe një tregues i qartë se sundimi i ligjit është duke funksionuar në nivelin më të lartë. Publiku pret dhe meriton vënien në vend të drejtësisë në mënyrë të përballueshme ekonomikisht. Gjykata është vendi ku filtrohen për herë të fundit kontradiktat e shoqërisë dhe të strukturave të tjera të shtetit, vendimet e së cilës do të mbahen mend gjatë dhe janë të obligueshme për palët që t'i respektojnë. Prandaj, gjykatat kanë nevojë për më tepër inkurajim dhe mbështetje nga ana e shtetit, duke bërë të mundur që këto të veprojnë të pavarura, të sigurojnë kushte normale të punës që do të ndikonte në profesionalizmin e gjyqtarëve, në respektimin e etikës, kulturës së punës dhe në punën efektive të gjyqtarëve, duke ndikuar kështu në rritjen besimit të qytetarëve ndaj gjykatave. Me fjalë të tjera, drejtësia, shpejtësia dhe procesi gjyqësor publik janë karakteristika thelbësore të cilat ndikojnë që gjykatat të veprojnë lirshëm dhe me kredibilitet në zbatimin e normave të përgjithshme juridike në rastet konkrete, në kuadër të funksionit gjyqësor që kanë. Funksioni gjyqësor nënkupton sigurimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe respektimin dhe

mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Funkzioni gjyqësor është plotësisht i pavarur dhe i barabartë me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv. Funkcionin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat e rregullta si organe të pushtetit shtetëror. Në tërësi, funksionimi gjyqësor zhvillohet brenda një kuadri institucional që u imponon palëve në konflikt detyrime mjaft shtrënguese. Ky funksion paraqet një ndër elementet qenësore të domosdoshme të sistemit juridik të një vendi. Ky funksion është formë dhe mënyrë e cila garantohet me kushtetutë, që ka për objekt mbrojtjen e barabartë dhe të paanshme të lirive dhe të drejtave të njeriut e të shtetasit, të pronës dhe të interesave shtetërore e shoqërore, formë dhe mënyrë e përcaktimit të përgjegjësisë të të gjithëve dhe të secilit. Është formë themelore e mbrojtjes juridike të rendit juridik dhe indikator themelor i forcimit të sundimit të ligjit. Funkcionin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat. Gjykatat si të tilla, janë thjesht instrumente të ligjit (Hayek, 1960, 15). Këto janë organe të pushtetit shtetëror, të cilat u shqiptojnë dënime dhe masa të tjera autorëve të veprave penale. Njëkohësisht, këto vendosin për çështjet rreth konteksteve civile, penale dhe për ligjshmërinë e akteve individuale të organeve shtetërore e të organizatave që ushtrojnë autorizime publike. Gjykatat vendosin për çështjet, pa qenë të ndikuara nga asgjë tjetër, përveç nga faktet dhe ligji. Parimet themelore, në të cilat mbështeten organizimi dhe metodat e punës së gjykatave, si dhe pozita dhe realizimi i funksionit të tyre, janë parime përgjithësisht të pranura në botën demokratike. Nga këto parime, rëndësi të veçantë kanë parimi i parimi i pavarësisë së gjykatave dhe të gjyqtarëve, puna publike e gjykatave, zgjedhja dhe pozita e gjyqtarëve të jurisë, parimi i gjykimit të jurisë, parimi i gjykimit në instancë dhe kolegjaliteti në çështjen e funksionimit të pavarur të gjyqësorit. Vëmendje parësore i kanë kushtuar edhe në Konferencën e Pekinit të vitit

1995, në të cilën morën pjesë 30 vende nga Azia dhe Paqësori. Kështu që, sipas nenit 10 të Parimeve të Pekinit, ndër të tjera parashikohet se funksionet e gjyqësorit janë:

- Të sigurojë që të gjithë personat të jenë në gjendje të jetojnë të sigurt në shtetin juridik;
- Të administrojë drejtësinë shtetasve dhe shtetit (Deklarata e Pekinit për Parimet e Pavarësisë së Gjyqësorit, 1995), në mënyrë të paanshme.

Funksioni gjyqësor, si formë e pushtetit, është veprimtari e plotë dhe e vetme e këtij lloji që si i tillë i takon vetëm e vetëm gjykatës. Gjykata është i vetmi organ i autorizuar në bazë të ligjit që të vendosë për zbatimin e dhunës ndaj të gjithë qytetarëve, e sidomos, nëse është në pyetje jeta, liritë, çënimi i personalitetit të njeriut, rendit shtetëror, pasurisë etj. Gjykata është institucioni i vetëm publik, i cili do të vlerësojë dhe do t'i peshojë gjërat, duke vendosur për themelësinë e çështjes me vendim gjyqësor të arsyetuar thellësisht, për të gjitha ato çështje që hyjnë në kuadër të kompetencës së saj. Një funksion me rëndësi, që e ushtrojnë gjykatat është përcjellja dhe studimi i marrëdhënieve dhe i dukurive shoqërore me interes për realizimin e funksioneve të veta. Këto mund të kenë ndikim në parandalimin e dukurive të rrezikshme për shoqërinë dhe janë kontribues dhe promotor të forcimit të shtetit ligjor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në krijimin e kushteve për mbrojtjen e barabartë dhe për të siguruar e përforcuar rendin social të vendit. Këto gëzojnë fuqinë institucionale juridike dhe janë garantuese për shtetin e së drejtës si dhe fuqinë zbatuese të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, duke pasur ndikim të fuqishëm në preventivën e mohimit apo të moszbatimit të drejtësisë. Në vështrim të kësaj, gjykatat duhet të kenë njerëz të ngritur profesionalisht, të kujdesshëm, të pasionuar për punë, të guximshëm dhe me etikë të lartë profesionale dhe morale. Këto institucione me rëndësi vitale për shtetin juridik dhe për qytetarin i

ushtrojnë funksionet e besuara ligjore efektivisht dhe në mënyrë kualitative, dhe do të jenë të përkushtuara që vendimet e saj të ekzekutohen në kohë dhe hapësirë.

Në funksion të ushtrimit të funksioneve të rregullta brenda kompetencave gjykatat vendosin:

- Për raportet themelore personale, për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve dhe për të drejtën dhe detyrat politiko-shoqërore;
- Shqiptojnë dënime, caktojnë masa kundrejt autorëve të veprave penale dhe veprave tjera të dënueshme të parapara me ligj;
- Vendosin për ligjshmërinë e akteve konkrete të organeve shtetërore dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike;
- Vendosin për raporte tjera, nëse kjo gjë e tillë është paraparë me ligj.

Funksioni gjyqësor ka juridiksion ekskluziv dhe përfundimtar mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e qytetarit të garantuara me Kushtetutë dhe me ligje të vendit përkatës. Gjykatat do ta garantojnë barazinë e qytetarëve para ligjit dhe mosdiskriminimin, të drejtën e jetës, lirinë e shprehjes, të drejtën e lirisë dhe mbrojtjen nga arresti arbitrar, mbrojtjen nga ndëshkimi, trajtimi poshtërues dhe degradues, të drejtën për proces të rregullt gjyqësor, dhe garantimin e një gjykimi të drejtë publik brenda një afati të arsyeshëm.

3.2. Aksesin në gjykatë

Personi që është autorizuar të kryejë veprime procedurale në procesin gjyqësor në emër të njëjës palë, veprime këto që sjellin efekt të drejtpërdrejtë për palën, quhet përfaqësues. Vetë përfaqësuesi, pra nuk është palë në proces. Ky përfaqësim quhet edhe i drejtpërdrejtë, për arsye se veprimet procedurale të përfaqësuesit konsiderohen si veprime të vet përfaqësuarit.

Kur përfaqësuesi kryen veprime procedurale në emër e për llogari të njërës palë, do të thotë se kur ai vepron brenda tagrave që i janë dhënë, veprimet e tij shkojnë në dobi ose në dëm të palës se përfaqësuar prej tij. Kur përfaqësuesi kryen veprime procedurale jashtë tagrave të autorizimeve që i janë dhënë nga i përfaqësuari, veprimet e tij, nuk sjellin asnjë pasojë ndaj personit të përfaqësuar (Agaj, 2012).

3.3. Llojet e përfaqësuesve

E drejta për të kryer veprime procedurale dhe veprime të tjera të ligjshme në procesin gjyqësor në emrin e një tjetri që është palë në proces, mbështetet në fakte të ndryshme juridike, me të cilat ligji lidh lindjen e tagrave të përfaqësuesit. Këto fakte përbejnë shkaqet e lindjes së të drejtave-tagrave të përfaqësuesit. Në bazë të llojit të këtyre shkaqeve, dallohen edhe përfaqësuesit: në përfaqësues ligjor dhe në përfaqësues vullnetar (Agaj, 2012).

3.3.1. *Përfaqësuesi Ligjor*

Për të shmangur keqkuptimin lidhur me dallimin ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe atij vullnetar duhet pasur parasysh se ky dallim në vetvete është më tepër konvencional, për arsye se të dy llojet mbështeten në ligj, të dyja njihen dhe ushtrohen në bazë të normave juridike të caktuara. Dallimi ndërmjet tyre qëndron kryesisht në ndryshimin e shkaqeve juridike – fakteve nga të cilat burojnë.

Autorizimet e përfaqësuesit ligjor janë të përcaktuara në aktin normativ, por duhet pasur parasysh se këto nuk lindin drejtpërdrejtë nga ky akt normativ, p.sh. ligji.

Ligji ose norma juridike përben bazën e lindjes së tagrave të përfaqësuesit dhe disa herë edhe vetë personit të përfaqësuesit, por vetë lindja e tyre shkaktohet nga fakte juridike konkrete. Nga këto fakte juridike konkrete përcaktohet si rregull edhe vet

personi i përfaqësuesit. Këto fakte mund të jenë akte administrative, vendime gjyqësore ose ngjarje juridike (Omari , 1993: 167-269).

Përfaqësuesi ligjor, tagrat e tij i fiton pavarësisht nga vullneti i të përfaqësuarit, prandaj dhe ndryshe quhet përfaqësues i detyrueshëm. Përfaqësues te tillë, janë prindërit ose kujdestari i të miturit nën 14 vjeç dhe kujdestari i personit të cilit i është hequr zotësia për të vepruar me vendim të gjykatës; prindërit ose kujdestari i të miturit mbi 14 vjeç deri në 18 vjeç dhe kujdestari i personit të cilit me vendim të gjykatës i është kufizuar zotësia për të vepruar. Këta kryejnë vetë veprimet procedurale, por si rregull me pëlqimin e prindit ose kujdestarit. Vetëm përjashtimisht këta mund të kryejnë veprimet procedurale në mënyrë krejt të pavarur, d.m.th. edhe pa pëlqimin e përfaqësuesit të tyre ligjor.

Personat juridik përfaqësohen në gjykatë nga organet e tyre të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut. Organi shpreh drejtpërdrejtë vullnetin e personit juridik në emrin e të cilit ai vepron qoftë ky publik apo privat. Lidhur me pozitën procedurale të organit të personit juridik ka dy qëndrime. Sipas njërës pikëpamje organi i personit juridik, qoftë ky dhe shteti Shqiptar si tërësi, është përfaqësues ligjor ose i detyrueshëm ndërsa sipas pikëpamjes tjetër, organi i personit juridik nuk është përfaqësues. Kur ai merr pjesë vet në gjyq p.sh. drejtori, ministri, kryetari quhet se ka marrë pjesë vet personi juridik (Çeço, 1986: 184).

Personi juridik vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij. Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik. (Kodi Civil, neni 31). Organi mund të caktojë vetë përfaqësimin me prokurë.

3.3.2. Përfaqësuesi me Prokurë(Vullnetar)

Pala e interesuar ka të drejtë të përfaqësohet në procesin gjyqësor nga një person tjetër. Në këto raste, përfaqësuesi i zgjedhur nga pala bazohet në vullnetin e shfaqur në aktin e përfaqësimit – prokurës, ku përcaktohen edhe tagrat e përfaqësuesit.

Përfaqësuesi në çdo rast duhet të pajiset me prokurë. Për sa i përket llojit të prokurës, e përgjithshme dhe e posaçme, si dhe formës së saj, Kodi Procedural i referohet dispozitave të Kodit Penal.

Termi “prokurë” ka disa kuptime; së pari prokura është veprim juridik i njëanshëm me anë të të cilit subjekti-palë ndërgjyqësore shfaq vullnetin e vet që një person tjetër i caktuar prej tij që quhet përfaqësues të kryejë në emër e për llogari të të përfaqësuarit veprime procedurale, të cilat krijojnë të drejta e detyrime drejtpërdrejtë për të përfaqësuarin. Së dyti, me prokurë kuptohen tagrat që i janë dhënë përfaqësuesit nga i përfaqësuari dhe së treti me prokurë kuptohet dhe forma shkresore e kërkuar nga ligji, me anë të së cilës shprehet vullneti i të përfaqësuarit.

Me prokurën gjyqësore i përfaqësuari mund t’i jap përfaqësuesit të tij më shumë ose më pak tagra. P.sh. Me një prokurë i jepen përfaqësuesit raste të kryej të gjitha veprimet procedurale në procesin gjyqësor që mund t’i kryente vetë i përfaqësuari, si paraqitja e padisë, heqja dorë nga gjykimi ose nga e drejta e padisë, zgjidhja e mosmarveshjes me pajtim, vënia e vendimit të gjykatës që ka marrë formë të prerë në ekzekutim.

3.4. Kuptimi i akteve procedurale në funksion të realizimit të procesit të rregullt ligjor

Akti juridik nxirret në pajtim me dispozita të caktuara. Vetëm akti fillestar të një rendi juridik, me të cilin ky rend fillon të krijohet, nxirret në mënyrë të pavarur nga çdo

lloj dispozitash të mëparshme. Ky rend juridik është kushtetuta-akti themeltar, p.sh. Ligji "Për dispozitat kryesore kushtetuese" i vitit 1991 është nxjerrë pa marrë aspak në konsideratë Kushtetutën e vitit 1976 apo normat e tjera në fuqi. Në bazë të Kushtetutës nxirren aktet e tjera juridike si ligjet, dekretet, vendimet etj., duke formuar kështu hierarkinë juridike me dispozita përcaktohet si procesi i nxjerrjes së aktit, që përben formën ashtu edhe përmbajtja e tij. Forma e aktit juridik përbehet nga këta elemente kryesore:kompetenca e subjektit për nxjerrjen e aktit, procedura e nxjerrjes dhe mënyra e materializimit të aktit, që do të thotë mënyra e vënies në përdorim. Përmbajtja e aktit përbëhet nga dy elemente, ku njeri është kryesor dhe tjetri dytësor, që përcaktojnë së cilit lloj akti juridik i përket një akt. Elementit dytësor i përkasin zakonisht të thënat se kush e ka nxjerrë aktin, kur dhe ku, disa herë tregohet edhe qëllimi (Omari, 1993: 167-269).

Elementi kryesor i përmbajtjes është i dyanshëm, prandaj dhe aktet juridike për nga përmbajtja dallohen në dy lloje kryesore: në akte juridike me të cilat krijohen norma juridike dhe në akte me të cilat shfaqet vullneti i parashikuar në norma juridike si fakte juridike (p.sh. kryerja e një veprimi juridik si testamenti, shitja etj.). Akte juridike me të cilat krijohen norma juridike ndahen në dy lloje dhe kjo ndarje është më e rëndësishmja. Llojin e parë dhe më të rëndësishmin e përbejnë aktet me të cilat krijohen norma të përgjithshme. Këto lloj aktesh quhen ndryshe akte normative, akte të përgjithshme ose burime të së drejtës. Llojin e dytë të akteve juridike e përbejnë aktet me të cilat konkretizohen dhe individualizohen elementet e normës së përgjithshme. Këto quhen akte individuale. Këto përsëri dallohen në akte individuale të plota në të cilët përfshihen të dy elementet e normës juridike, dispozita dhe sanksioni, dhe në akte juridike individuale jo të plota, në të cilët përfshihet vetëm njeri element i normës juridike,

dispozita ose sanksioni.

Për aktet procedurale, bëhet dallimi midis atyre për të cilat ligji nuk kërkon një formë të caktuar dhe atyre për të cilat kërkohet një formë e caktuar. Në të dyja këto përfshihen vendimet e gjykatës, procesverbalet, padia, kundërpadia, ankimi, letërthirrja dhe dokumentet e tjera, të cilat parashikohen në dispozita të Kodit të Procedurës Penale dhe që përmbajnë rrethana që kanë lidhje me çështjen, që zgjidhin çështje të ndryshme gjatë procesit gjyqësor ose që realizojnë të drejtat dhe detyrat e gjykatës dhe subjekteve të tjerë të procesit. Akte procedurale hartohen në gjuhën shqipe dhe çdo dokument i hartuar në gjuhë të huaj përkthehet nga përkthyesi (Agaj, 2012).

Me disa akte procedurale synohet arritja e një qëllimi të caktuar, këto ndeshen në fillim të gjyimit ose në fund të tij, në shkallë të parë e të dytë, si padia, kundërpadia, kërkimet përfundimtar, ankimi. Disa akte procedurale, pasqyrojnë rrethanat e ndryshme lidhur me çështjen në gjykim, si procesverbali gjyqësor, që pasqyron të gjitha fazat dhe elementet e gjyimit, procesverbali i këqyrjes së vendit, procesverbali i sigurimit të provës, fletëthirrjet e njoftimet e ndryshme etj. Me disa akte procedurale zgjidhen çështje të ndryshme që lindin gjatë gjyimit, si vendimet e gjyqtarit të vetëm për caktimin e datës dhe orës së gjyimit, për marrjen e masës së sigurimit të padisë, vendimet e ndërmjetme të gjykatës për paraqitjen dhe marrjen e provave etj. Së fundi, në akte të caktuara procedurale, zgjidhet çështja në themel, që janë vendimet përfundimtarë të gjykatës (Agaj, 2012).

Aktet procedurale në rregullin e tyre japin një tablo të përgjithshme të veprimeve procedurale të subjekteve pjesëmarrës, si dhe veprimet e subjekteve të tjerë si dëshmitarëve, ekspertëve, përkthyesve etj. Sa më i mirë dhe i saktë të jetë ky pasqyrim i veprimeve të kryera gjatë gjyimit, aq më mirë sigurohet zgjidhja e çështjes. Kështu

kërkesëpadia dhe kundërpadia duhet të përmbajnë detyrësisht të dhëna të caktuara si për gjykatën që i drejtohet, për palët, për personat e tretë kur është rasti, për objektin e padisë, për bazën ligjore të tyre, konkluzionet, datën e aktit dhe nënshkrimin e palës ose përfaqësuesit që e ka hartuar aktin. Në procesverbalin e procesit gjyqësor duhet të pasqyrohen personat që marrin pjesë dhe veprimet që ata kryejnë, faktet e paraqitura si dhe deklaratat e bëra (Agaj, 2012). Në procesverbal pasqyrohet edhe përmbajtja e shiritave të regjistruarit zanor, diapozitivave, filmimeve që iu bashkohën akteve të çështjes (neni 118). Procesverbali nënshkruhet nga sekretari dhe gjyqtari. Por procesverbali i mbajtur duhet t’i lexohet subjekteve që marrin pjesë në gjykim dhe këto mund të shprehin gjykimin e tyre me shkrim (Zaganjori, Anastasi, Eralda Çani, 2011).

3.5. Kuptimi i juridiksionit

Në parashikimet procedurale, referuar kodeve, nuk është dhënë përkufizimi i juridiksionit. Teoria ka dhënë përkufizimin e këtij instituti juridik procedural penal. Megjithatë nga përmbajtja e normave juridike për juridiksionin del kuptimi i tij.

- “E drejta e organeve shtetërore për të zgjedhur çështjet që përfshihen në funksionet e tyre, duke zbatuar ligjin, quhet juridiksion (*ins dicere*)” (Agaj, 2012)
- “Juridiksioni është e drejta e një organi për të ushtruar një veprimtari të caktuar në përputhje me ligjin, d.m.th. rrethi i çështjeve që i takon të zgjidhë në bazë të ligjit njeri ose tjetri organ”. Përkufizimi më i thjeshtë është ky: “Rrethi i çështjes që i takon të zgjidhë në bazë të ligjit, njëri ose tjetri organ shtetëror quhet juridiksion”

- Të tjerë e kanë përkufizuar juridiksionin si kompetencë absolute, që është kompetencë e gjykatave të një vendi e ndarë nga kompetenca e organeve të tjera të vendit ose të huaja, që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre për çështje të caktuara (Zaganjori , Anastasi, Eralda Çani, 2011).

Fjala juridiksion rrjedh nga latinishtja “*ins dicere*”, zbatimi i ligjit. Lidhur me këtë, për gjykatat dhe organet e tjera të ngarkuara me zbatimin e ligjit ekziston deviza: “*Ins dicere et non ins dare*”- dhe të zbatosh ligjin, jo të krijosh ligjin. Mirëpo termi *juridiksion* siç u përmend edhe më sipër ka marrë kuptim më të gjerë. Krahas detyrës së organeve shtetërore për të zbatuar ligjin, me këtë nocion juridik përfshihet edhe ndarja ndërmjet organeve e kompetencave me ligj për të shqyrtuar çështje të caktuara. Pikërisht kjo ndarje përbën edhe thelbin e juridiksionit. P.sh. kur një çështje do të shqyrtohet nga gjykata, çështja e parë që shtrohet para saj është nëse i përket gjykatës ta shqyrtojë apo i përket ndonjë organi tjetër shtetëror. Në legjislacionin tonë kjo ndarje është quajtur juridiksion. Në disa legjislacione të huaja nuk është pranuar juridiksioni si term i veçantë, por është përfshirë në kompetencën (Zaganjori , Anastasi, Eralda Çani, 2011).

Në varësi të llojeve të organeve shtetërore që janë ngarkuar me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, dallohet edhe juridiksioni në juridiksion gjyqësor dhe në juridiksion administrativ. Kemi juridiksion gjyqësor kur me ligj janë ngarkuar gjykatat për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve. Kemi juridiksion administrativ kur me ligj janë ngarkuar organet e administratës shtetërore për zgjidhjen e çështjeve të caktuara. (E drejta Procedurale Civile në RSH, Leksione).

3.6. E drejta për t'u mbrojtur

Me herët, e drejta për t'u mbrojtur, është njohur në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (Neni 6/3/c), në të cilën thuhet shprehimisht se *“Çdo i akuzuar ka të drejtë të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer një mbrojtës, të mund të ndihmohet falas nga një avokat i caktuar zyrtarisht, kur e kërkojnë interesat e drejtësisë”* dhe me pas në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (Neni 31), duke sanksionuar se *“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij;... si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme. Ndërsa për personat që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të shpërblyer një mbrojtës, organet e procedimit (prokuroria ose policia gjyqësore) dhe gjykata i sigurojnë mbrojtje falas, nëpërmjet një mbrojtësi të caktuar zyrtarisht, kjo në zbatim të parimit “interesat e drejtësisë”, që në masë të madhe përkon me respektimin e barazisë së mjeteve për t'u mbrojtur. Mbrojtësi i caktuar kryesisht ka detyrimin kushtetues e ligjor, që të sigurojë pjesëmarrjen e tij në veprimet procedurale dhe në seanca gjyqësore, si dhe të kryejë efektivisht dhe me profesionalizëm veprimet, kërkesat, ankesat, etj., në interes të së mbrojturit prej tij. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nëpërmjet jurisprudencës së saj (Balliu kundër Shqipërisë etj), shprehet se e drejta për të dhënë ndihmë ligjore pa pagesë kur e kërkojnë interesat e drejtësisë nuk është një alternativë ndaj të drejtës për t'u mbrojtur vetë, por një e drejtë e pavarur në të cilën zbatohen standarde objektive. Kjo e drejtë e garantuar bëhet më efektive dhe e efektshme, kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar, merr të gjitha masat që varen nga vullneti dhe kontrolli i tij për të mos munguar në kryerjen e veprimeve dhe në seanca gjyqësore për mbrojtjen e interesave të klientit të tij (Portali Drejtësia Shqiptare, 2007,*

<http://drejtësiashqiptare.com>). Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.07 datë 14.10.2011, kanë arritur në përfundimin unifikues se:

“...mungesa e mbrojtësit është e justifikuar vetëm nëse ka pengesa apo gjendet në pamundësi për të realizuar mbrojtjen e klientit të tij, për shkaqe të pavarura prej tij, të tilla që e bëjnë objektivisht të pamundur të përmbushë detyrën e mbrojtësit, sikurse janë rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme dhe fatkeqësive natyrore, ngjarje aksidentale mbi personin e tij apo familjarë të tij, raste fatkeqësie në rrethin më të afërt familjar, gjendja shëndetësore personale e tillë, që pamundëson kryerjen e detyrës apo gjendja shëndetësore e rëndë e familjarëve të tij nëse evidentohet domosdoshmëria e pranisë së tij tek i sëmuri...”

Po kjo gjykatë nëpërmjet vendimit të mësipërm, me të drejtë shprehet se:

“....nuk përbën justifikim të pranueshëm ligjërish pretendimi i mospjesëmarrjes në kryerjen e veprimit procedural apo në seancë gjyqësore, kur mbrojtësi njofton se ndodhet në kryerjen e një veprimi procedural për një klient tjetër në një çështje tjetër, ose në një gjykim tjetër, ndodhet jashtë qendrës së autoritetit procedues apo jashtë shtetit për motive profesionale apo çlodhëse e zbavitëse, etj”

Pra, nuk ka logjikë juridike për të justifikuar mungesën e mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar me arsyetimin se gjendet në një proces tjetër. Përfshirja e avokatit në mbrojtjen e klientëve në procedime të ndryshme dhe ngarkesa e tij me punë janë zgjedhja e tij, sikurse është edhe vijimi i realizimit të mbrojtjes apo heqja dorë nga mbrojtja. Pranimi i ushtrimit të detyrës dhe heqja dorë prej saj nga mbrojtësi janë akte të vullnetit të tij dhe plotësisht të kontrollueshme prej tij. Nuk është mbrojtësi ai që “zgjedh” se cila gjykatë duhet të vijojë me praninë e tij dhe cila të shtyjë gjykimin, as edhe përcakton ai se cili prej gjykimeve është më i rëndësishëm se tjetri.

Mbrojtësi ka detyrimin që të marrë të gjitha masat organizative për të bashkëpunuar me kolegë të tjerë, apo për të mbajtur aq ngarkesë pune sa mund të garantojë klientët dhe autoritetet gjyqësore se është në gjendje të përmbushë detyrën e tij. Pretendimi i mbrojtjes në “Çështjen Kumbaro” se ka njoftuar gjykatën për

pjesëmarrje në një gjykim tjetër nuk është i mbështetur në ligj. Gjykata në këtë rast, ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues dhe ligjor, duke i caktuar të pandehurit një mbrojtës tjetër kryesisht, duke i dhënë atij, kohën e nevojshme për t'u përgatitur dhe duke e zhvilluar seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e mbrojtësit të caktuar kryesisht.

Përveç caktimit të mbrojtësit, organet e hetimit (prokuroria dhe policia gjyqësore) dhe organet e gjyimit (gjykata), kanë detyrimin kushtetues dhe ligjor, për të njohur te pandehurin dhe mbrojtësin e zgjedhur ose caktuar, me provat që ndodhen në fashikullin e prokurorit ose dosjen e gjyimit. Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr. 4/2001 theksoi se: ... i pandehuri, nuk është njohur me të gjitha materialet në ngarkim të tij, nga prokurori para se çështja të kalonte për gjykim..., këto prova janë paraqitur vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë pas disa seancave, me kërkesë të gjykatës.

Në këtë vështrim, është shkelur e drejta e mbrojtjes të të gjykuarit. Duke lexuar vendimin e mësipërm, natyrshëm lind një pyetje, A duhet të vendosë prokurori në dispozicion të personit nën hetim, të pandehurit ose mbrojtësit të gjitha provat që e akuzojnë atë? Praktika ka treguar se prokurori vë në dijeni personin nën hetim, të pandehurin dhe mbrojtësin që e përfaqëson, vetëm mbi thelbin e provave, për të mos dëmtuar procesin e ndjekjes penale në përhapjen e sekreteve hetimore.

E drejta për t'u mbrojtur lidhet ngushtë edhe me parimin e *“barazisë armëve ose mjeteve”*, i cili përfshin në vetvete nocionin se të dy palët në një proces kanë të drejtë të kenë mundësi të barabarta për të paraqitur argumentet ligjore, në çështjen që përfaqësojnë.

Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr. 5/2003, shprehet se: *“ky parim kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëjloj si ato të prokurorit”*.

Ky parim presupozon që secilës palë, duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për

të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër.

Nëpërmjet arsytimit të mësipërm, arrijmë në përfundimin se e drejta për t'u mbrojtur, përveç se është një element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, garantimi i saj nga organet e pushtetit publik, paraqet një rendësi themelore për karakterin dhe funksionimin demokratik të shtetit të së drejtës.

3.7. Barazia e armëve në proces

Mbrojtja që i afrohet individit nga klauzola e procesit të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në të drejtat që përfshihen në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e njohura nga ligji. Formulimi kushtetues i jep shtrirje të gjerë procesit të rregullt ligjor, për çdo shkelje ligjore. Ai e identifikon procesin e rregullt ligjor si garantues jo vetëm ndaj veprimeve arbitrare, që mund të kryejnë autoritetet shtetërore mbi lirinë, pronën dhe të drejtat kushtetuese dhe ligjore të individit, por edhe të procedurave të drejta e të ndershme gjyqësore. Nga përmbajtja e nenit 42 të Kushtetutës rezulton, se mbrojtja kushtetuese do të jetë e pranishme dhe e domosdoshme, në çdo ndërhyrje, në rast se realizohen dy kushte bazë, që lidhen me cënimin e të drejtave; e para, kërkohet që liria, prona, dhe të drejtat kushtetuese apo ligjore të jenë shkelur dhe, e dyta, se ky cënim i të drejtave të jetë kryer pa i afruar një gjykim të rregullt dhe të drejtë ligjor.

Individi gëzon disa të drejta dhe liri të pandashme, të pakundërshtueshme dhe të parashikuara konkretisht në ligj. Procesi i rregullt ligjor në vetvete nënkupton tërësinë e atyre parimeve të sanksionuara konkretisht në ligj, mbi bazën e të cilave, zhvillohet veprimtaria procesuale kundrejt tij. Vënia e individit në raport me një proces realizohet, duke u udhëhequr nga rregullsia si kriter, rregullsi kjo që duhet të jetë e bazuar plotësisht në parashikimet ligjore. Procesi i rregullt ligjor është një e drejtë kushtetuese,

e sanksionuar konkretisht, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, në kreun ku flitet për liritë dhe të drejtat vetjake. Parashikimi tjetër, si garanci e fuqishme në lidhje me procesin e rregullt ligjor, është në nenin 6 të KEDNJ-së, në të cilën, është sanksionuar e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor.

Në nenin 131/f dhe 134/g, të Kushtetutës së RSH-së, është përcaktuar që individët janë subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur pretendojnë se ndaj tyre nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor, por pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike të parashikuara me ligj për mbrojtjen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pra si një shkallë gjykuese përfundimtare. Në këtë mënyrë, kërkesa individuale nuk mund të paraqitet para Gjykatës Kushtetuese, për mbrojtjen e të drejtave të tjera themelore, sepse ato individi i mbron drejtpërdrejtë në gjykatë.

Gjykata Kushtetuese nuk i hyn fare gjykimit të një çështjeje, por shqyrton nëse procesi i gjykimit i është përmbajtur një procesi të rregullt gjyqësor. Për të gjitha të drejtat kushtetuese individi mund të kërkojë mbrojtje nga gjykatat në vend, të cilat duhet t'i sigurojnë atij një proces të rregullt gjyqësor. Kjo do të thotë që individi në Republikën e Shqipërisë nuk mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave apo lirive të tjera themelore të tij, përveçse për mbrojtjen e njërës prej tyre, asaj për një proces të rregullt ligjor.

Për këtë arsye, ankimi individual kushtetues do konsiderohet si efektiv dhe vet gjykata kushtetuese si e tillë, konsiderohet si gjykatë e të drejtave të njeriut, përse i përket mundësisë për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Ankimi individual kushtetues paraqet rëndësi, pasi në vetvete ka dy funksione: Së pari, nëpërmjet ankimit individual, bëhet i mundur konkretizimi dhe efektiviteti i të drejtave themelore dhe, së dyti, kontrolli që ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese në këto raste, ka efekt të

menjëhershëm dhe direkt tek individët, që e vënë atë në lëvizje. Kërkesa individuale ka kështu karakter subsidiar.

Ajo paraqitet në Gjykatën Kushtetuese, pasi shterohen të gjitha rrugët e tjera të ankimit gjyqësor dhe administrativ. Madje, pretendimi për shkelje të së drejtës, për një proces të rregullt duhet të jetë konkret dhe jo i supozuar dhe kërkesa të plotësojë edhe elementët e tjerë të kërkuar për paraqitje të kërkesave në GJK, si p.sh.: ajo të paraqitet jo më vonë se dy vjet nga konstatimi i shkeljes apo data e njoftimit të vendimit të organit përkatës, të jetë në gjuhën shqipe, e qartë dhe e kuptueshme. Statistikat flasin për një shtim të numrit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si rrjedhojë e kërkesave individuale.

Procesi i rregullt ligjor është një ndër parimet themelore të së drejtës dhe një ndër të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas Kushtetutës. Ka gjithmonë një analizë që qas “të drejtën për një proces të rregullt ligjor”, të parashikuar në Kushtetutën e RSH, me “të drejtën për një proces të drejtë”parashikuar nga Neni 6, i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, edhe pse, duhet thënë, që e drejta për një proces të rregullt ligjor është më e gjerë se ajo për një proces të drejtë, i cili lidhet me organe kryesisht gjyqësore, por edhe *quassi*-gjyqësore.

Kjo qasje është me rëndësi për vetë faktin, se të kuptuarit drejtë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, do të ketë referim të gjerë tek interpretimet që ka bërë GJEDNJ-ja, mbi të drejtën për një proces të drejtë, por nuk mund të kufizohet vetëm në të.

Edhe pse përmendet në Kushtetutë, përcaktim i qartë i kësaj të drejte nuk bëhet në të, edhe pse nuk duhet harruar kuptimi që ka për të drejtat themelore të RSH, çdo e drejtë e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe interpretim që i bëhet asaj, e

drejta për një proces të drejtë, përfshirë. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet jurisprudencës së saj ka konsoliduar kuptimin, jo vetëm në interpretim e drejtpërdrejtë të Kushtetutës, por edhe në referim të nenit 6 të KEDNJ-së, apo praktikës së GJEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese nuk ka tentuar të zëvendësojë gjyqësorin, por të japë kuptimin e së drejtës për një proces të rregullt, si e drejtë kushtetuese. Kështu, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka lidhur ngushtë garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe elementët përbërës të saj, me konceptin e shtetit të së drejtës duke e konsideruar të parën element thelbësor të shtetit të së drejtës.

Duke pasur imperativ, nxjerrjen e gjendjes sa më të qëndrueshme dhe realiste, kemi marrë në analizë të dhëna të nxjerra nga gjykimet në shkallë të parë.

Gjykatat e interesit në këtë proces kanë qenë, ato të Tiranës, Shkodër, Elbasan, si dhe Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë kjo në lidhje me monitorimin e procesit të rregullt gjyqësor.

Duke pasur parasysh këtu, që monitorimin e kam bërë vetëm në vërtetësinë e të dhënave të ofruara, si dhe anketimet me qytetarët mbi këtë pikë, mund të thuhet se procesi është ndërtuar i tillë, që ka ngërthyer në vete, analizimin statistikor të të dhënave nga burime sekondare, duke i monitoruar ato nga afër, meqë në këtë rast, ato marrin konotacionin e të dhënave primare, duke i shtuar edhe anketimin, rezultatet na bëhen të jenë më të qëndrueshme dhe të besueshme.

Duke njohur rëndësinë e procesit të rregullt ligjor, imperativi parësor i tij, na del të jetë ‘paanshmëria e gjyqtarit’. Duke parë rëndësinë, që paraqet sjellja e paanshme e gjyqtarit për forcimin e pushtetit gjyqësor dhe rritjen e besimit të publikut ndaj tij, vëmendja jonë u përqendrua në monitorimin e sjelljes së jashtme të gjyqtarëve, gjatë


seancave gjyqësore (Monitorimi është kryer personalisht nga unë me ndihmesën disa studentëve).

Perceptimi i tyre është i pasqyruar përmes plotësimit të pyetësorëve.

Për të konkluduar në lidhje me sa më sipër, janë marrë në konsideratë këto interesime, të cilat synonin të nxirrnin në pah, nëse krijonin veprimet e gjyqtarit perceptimin për njëanshmëri në proces, apo jo? P.sh., u shtrua pyetja përgjithësuese: *sa respektohej parimi i të qënies i paanshëm të gjyqtarit dhe a janë të paanshëm ata?*


Përfundimet e ofruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezultojnë në *Po*, për 52/% të seancave, *Jo* për 45% të tyre. Ndërkohë, në pjesën tjetër të seancave, nuk është dhënë përgjigje, për shkak të shtyrjes së seancave.

Grafiku. 1 A ishte gjyqtari i paanshëm në vendime, deklarata, qëndrime dhe veprime? - GJRRGJ Tiranë



Burimi: *Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në Gjykata të ndryshme.*

Grafiku. 2 A ishte gjyqtari i paanshëm në vendime, deklarata, qëndrime dhe veprime? - GJRGJ Shkodër




Burimi: *Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në gjykata.*

Për të përcaktuar paanshmërinë në këtë proces merren në vlerësim sa vijon:

1. Kishte një shpjegim të detajuar të të drejtave për të dyja palët në proces, nga ana e gjykatës.
2. Kishte vëmendje të treguar në mënyrë të barabartë, si ndaj palës paditëse, edhe ndaj palës së paditur .
3. Nuk kishte favorizime të ndonjë pale në raport me palën tjetër.
4. Gjykata ofroi kushte të barabarta për të gjitha palët.
5. Gjykata ishte e drejtë dhe objektive në lidhje me të dyja palët.
6. Gjykata nuk përdori ton fyes në seancë ndaj asnjërës palë.
7. Gjykata i trajtoi avokatët përfaqësues të palëve me respekt dhe komunikoi me ta me gjuhë profesionale.
8. Gjykata ofroi barazi për çdo palë në parashtrimin e çështjes së saj.

Sjellja e gjykatës ndaj avokatëve përfaqësues të palëve, krijon perceptime të ndryshme, shpesh edhe për njëanshmëri. Kështu p.sh., pyetjes: *A i trajtoi Gjyqtari avokatët me respekt dhe si profesionistë?* Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në 30% të rasteve përgjigja ishte Po dhe vetëm në 60% e tyre u përgjigjën Jo.

Grafiku 3. A ishte gjyqtari i paanshëm në vendime, deklarata, qëndrime dhe veprime? - GJRGJ Shkodër



Burimi: *Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.*

Përgjigja jo, vjen si rezultat i shpjegimeve të mëposhtëme:

- Gjyqtarja/i nuk e lejoi avokatin të fliste;
- Nuk e pranoi, i kërkoi autorizim nga Qendra ku ishte i punësuar si avokat;
- Gjyqtarja nuk i kushtoi vëmendje avokatit dhe palës paditëse;
- Jo, nuk e lejoi avokatin të fliste;
- Gjyqtarja ishte pak e ashpër në komunikim me avokatin;
- Gjyqtarja e ofendoj avokaten e palës paditëse;
- Kur po parashtronte pala tjetër, Gjyqtarja iu drejtua avokates me fjalët “dëgjo mirë”.

Teorikisht, këto komente mund të lënë shkas që të perceptosh, se në disa raste, sjellja e gjykatës nuk është në përputhje me parimin e paanshmërisë së saj, në dukjen e tij, duke bërë më të lehtë aludimin e një procesi jo të rregullt ligjor.

Sikurse e theksuam, toni i ashpër ose fyes ndaj palëve, mosvëmendja dhe fjalët fyese ndaj tyre, si dhe toni ashpër ndaj avokatëve, krijojnë dyshime që ulin besueshmërinë ndaj gjykatës. Kjo edhe për faktin, se krijojnë një frenim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim dhe nuk i lejojnë ato të shprehen lirisht. Gjithashtu, ato e cenojnë pozicionin që duhet të mbajë gjyqtari si *super partes*.

Efektiviteti i procesit gjyqësor; Efektivitetit i procesit gjyqësor është një fenomen kompleks që përbëhet nga disa elementë e faktorë të rëndësishëm. Ai shihet i lidhur ngushtë me kohëzgjatjen e gjykimeve, zbatimin e afateve procedurale dhe shfrytëzimin efektiv i kohës. Kjo kohëzgjatje është e ndryshme për konflikte të ndryshme. Në këtë mënyrë kohëzgjatja në një proces penal, është e ndryshme nga ajo në një proces civil si dhe e ndryshme nga ajo në një proces administrativ.

- Kohëzgjatja e gjykimeve në çështjet penale në Gjykatën e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë janë monitoruar gjithsej 6 çështje gjyqësore, ku të akuzuarit ndodheshin përballë gjykatës për kryerjen e veprave penale të ndryshme, kompetencë e kësaj gjykate.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet kohëzgjatja e seancave gjyqësore për çështjet e mësipërme.

Tabela nr. 1 : Kohëzgjatja dhe numri i seancave gjyqësore për disa çështje.

Data e regjistrimit	Seanca gjithsej	Data e vendimit	Kohëzgjatja
27.06.2014	30 seanca	15.06.2015	11 muaj e 22 dite
23.09.2014	12 seanca	16.02.2015	4 muaj e 23 dite
18.03.2015	5 seanca	11.05.2015	2 muaj 23 dite
28.12.2013	45 seanca	14.04.2014	4 muaj e 16 dite
18.04.2011	38 seanca	12.04.2012	11 muaj e 24 dite
08.03.2012	6 seanca	07.06.2012	3 muaj
11.05.2012	3 seanca	13.11.2012	6 muaj e 2 ditë
21.06.2012	4 seanca	29.04.2013	10 muaj e 8 ditë
11.09.2012	3 seanca	05.11.2012	1 muaj e 26 ditë
12.09.2012	6 seanca	10.04.2013	7 muaj
08.11.2012	8 seanca	07.05.2013	6 muaj
09.11.2012	5 seanca	26.04.2013	5 muaj e 17 ditë
04.12.2012	4 seanca	11.04.2013	4 muaj e 7 ditë
10.12.2012	4 seanca	02.05.2013	4 muaj e 22 ditë
18.01.2013	2 seanca	29.04.2013	3 muaj e 11 ditë
07.02.2013	6 seanca	01.04.2013	1 muaj e 24 ditë

Burimi: *Vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.*

Nga të dhënat e tabelës më sipër rezulton, se kohëzgjatja më e mirë e çështjeve gjyqësore penale është nga 1 deri në 12 muaj, kurse kohëzgjatja mesatare është nga 4 deri në 60 muaj.

Nga shqyrtimi i rasteve të mësipërme rezultojnë të pasqyruara dhe shkaqet që lidhen me kohëzgjatjen e e shqyrtimit të çështjeve dhe shtyrjen e seancave.

Shkaqet e evidentuara janë përmbledhur në tabelën që vijon:


Tabela nr. 2: Shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore			
Gjyqtari nuk është prezent	Përgatitja e raportit nga eksperti	U la kohë për saktësimin e adresave të palëve	U la kohë për paraqitjen e provave
4 seanca	11 seanca	1 seancë	4 seanca

Burimi: Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë.

Nga tabela e mësipërme konstatohet, se numri më i madh i seancave të shtyra është bërë për t'i lënë kohë paraqitjes së dëshmitarëve.

Kohëzgjatja në çështjet me objekt UM dhe UMM; Në gjykimin e çështjeve për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë zbaton afatet procedurale të veçanta që janë parashikuar në Ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Në periudhën shkurt 2012- maj 2013, raste të tilla në gjykatën në fjalë, ka pasur, gjithsej, 31 seanca gjyqësore, sipas objektit që vijon:

Grafiku nr. 4. Numri i seancave gjyqësore me objekt UMM-UM



Burimi: Aurela Anastasi, *Studim Çështje të Rritjes së Efektivitetit, Transparencës dhe të Besimit të Publikut në Gjyqësor, Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave*

dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013, Tiranë, 2013.

- Si zbatohen afatet e gjykimit në UM/UMM?

Për të evidentuar të dhënat që do të vijojnë, është analizuar edhe *database* i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është evidentuar fillimi dhe përfundimi i çështjes, si dhe numri i seancave gjyqësore.

Në gjykimin e UM dhe UMM, afati i parashikuar në ligj, përkatësisht, për to, është zbatuar për fillimin e gjykimit, por jo për përfundimin e tij.

a) Në rastin e lëshimit të UMM, Gjykata duhet të zbatojë afatin e parashikuar në ligj, brenda 48 orëve për viktimat madhore dhe 24 orëve për të miturit, që përballen me dhunë në marrëdhëniet familjare.

Por, ka raste që këto afate nuk zbatohen. Konkreisht, nga 11 raste të monitoruara me këtë objekt, në gjashtë raste nuk është zbatuar ky afat, nga të cilat në katër raste Gjykata ka përfunduar gjykimin tej afatit 48 orë, në kundërshtim me afatin e caktuar nga LDHF. Madje, në dy raste, gjykimi ka filluar mbas mbarimit të afatit 48 orë.

b) Nga 8 çështje në fazën e vërtetimit të UMM ka rezultuar se në 4 raste Gjykata ka caktuar datën e verifikimit të UMM, tej afatit 20 ditor të caktuar nga neni 19 i LDHF.

c) Nga 11 çështje të monitoruara me objekt lëshimin e UM, për shqyrtimin e të cilit ligji ka parashikuar një afat 15-ditor, ka rezultuar se në 8 raste, Gjykata, nuk ka filluar shqyrtimin e kërkesës, edhe pse kanë kaluar 15 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës.

Në këtë mënyrë, mund të shohim saktësisht, se si zbatohen nga Gjykata afatet ligjore për zbatimin e tyre, sipas tabelave në vijim.

Tabela nr.3-Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore për çështjet me objekt lëshimin e UM (gjithsej 11 seanca të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme).		
Regjistrimi i çështjes në Gjykatë	Data e vendimit të UM	Kohëzgjatja
20.10.2011	20.02.2012	120 ditë
23.4.2012	8.5.2012	15 ditë
25.5.2012	4.7.2012	41 ditë
18.12.2012	1.2.2013	46 ditë
18.12.2012	1.2.2013	46 ditë
11.1.2013	11.2.2013	30 ditë
11.1.2013	11.2.2013	30 ditë
28.1.2013	1.3.2013	35 ditë
31.1.2013	22.4.2013	82 ditë
15.3.2013	2.5.2013	49 ditë
15.3.2013	2.5.2013	49 ditë

Burimi: *Aurela Anastasi, Studim Çështje të Rritjes së Efektivitetit, Transparencës dhe të Besimit të Publikut në Gjyqësor, Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013, Tiranë, 2013.*


Solemniteti dhe sjellja e gjyqtarit gjatë seancave gjyqësore; Solemniteti dhe sjellja korrekte e gjyqtarit, gjatë seancave gjyqësore, janë aspekte shumë të rëndësishme të etikës së gjyqësorit. *Gjyqtarët duhet të jenë, në çdo rast, të kthjellët dhe të qartë, për të përmbushur detyrën e tyre në respekt, edhe të reputacionit të Gjykatës*(GJEDNJ, Res, 2013, pr. 3). Ata duhet të tregojnë aftësitë e tyre për të dëgjuar, komunikuar dhe drejtuar seancën. Të lidhura edhe me aspektet e tjera të etikës gjyqësore, ata ndihmojnë në rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj gjyqësorit, përmes rritjes së nivelit të integritetit të

gjqtarit. Prandaj, solemniteti dhe korrektësia e sjelljes së gjyqtarit gjatë seancave gjyqësore, si dhe solemniteti i gjykatës në përgjithësi, u bënë objekt i posaçëm monitorimi.

- Ambienti ku zhvillohet gjykimi;

Nga pikëpamja e solemnitetit, përpos elementëve të tjerë, ka një rëndësi të posaçme edhe **ambienti ku do të zhvillohet gjykimi**. Madje, në vendimin nr. 238, datë 24.12.2008, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) vendoset se, përse është e mundur, të gjitha seancat gjyqësore duhet të zhvillohen në salla gjykimi të përshtatshme për natyrën e çështjes konkrete. Por, në fakt, nga monitorimi i seancave gjyqësore objekt i këtij studimi, ka rezultuar se në pjesën më të madhe të rasteve gjykimi zhvillohet në zyrat e gjyqtarit dhe jo në sallë. Kështu, nga 100 seanca, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë zhvilluar në zyrën e gjyqtarit 97seanca gjyqësore dhe vetëm 3 seanca gjyqësore janë zhvilluar në sallat e gjyqit. E njëjta situatë ravijëzohet edhe në procesin penal. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga 69 seanca gjithsej, në 2 raste seanca gjyqësore është zhvilluar në sallë dhe në 67 raste, seanca gjyqësore është zhvilluar në zyrë. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga 142 seanca, ka rezultuar se në 100% të rasteve, seancat janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga 5 seanca në procesin penal, 4 prej tyre janë zhvilluar në zyrën e gjyqtarit, dhe vetëm një seancë është zhvilluar në sallë.


Grafiku Nr.5 Solemniteti në paraqitjen e jashtme të Gjyqtarit/ës në seancat gjyqësore



Burimi: Aurela Anastasi, *Studim Çështje të Rritjes së Efektivitetit, Transparencës dhe të Besimit të Publikut në Gjyqësor, Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013, Tiranë, 2013.*

Ndërkohë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në asnjërën prej seancave gjyqësore të monitoruara në Gjykatën e Shkallës së parë, nuk ka pasur avokat të veshur me uniformën përkatëse. Për më tepër, avokatët nuk kanë një ambient të veçantë për të qëndruar në pritje të seancave gjyqësore.

Grafiku nr. 6. A u kushtoi Gjyqtari vëmendje të gjitha palëve?



Burimi: Aurela Anastasi, *Studim Çështje të Rritjes së Efektivitetit, Transparencës dhe të Besimit të Publikut në Gjyqësor, Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013, Tiranë, 2013.*


- A i trajtoi gjyqtari palët me mirësjellje dhe respekt?

Për këtë pyetje, 63.8% e u përgjigjën Po, kurse 5.71% u përgjigjën Jo. Në këtë rast, një pjesë e madhe nuk janë përgjigjur dhe nuk kanë komentuar (30.47% e tyre).

Drejtimi i procesit gjyqësor; Për të kuptuar këtë aspekt, duhet marrë në konsideratë doktrina, si dhe kriteret e vlerësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të drejtuar një proces të rregullt gjyqësor, pra mbi bazën e procedurave përkatëse (1) për të drejtuar dhe orientuar drejt debatin gjyqësor (2) duke u shprehur qartë dhe me lehtësi, (3) në përputhje me rregullat që parashikon ligji dhe etika gjyqësore.

Të dhënat e përgjigjeve të monitoruesve, për pyetjen: **“A arrin gjyqtari të mban nën kontroll sallën e gjyqit?”**, janë përmbledhur në Grafikon në vijim.


Grafiku nr. 7 - A arrin gjyqtari të mbaj nën kontroll sallën e gjyqit ? - GJRGJ Tiranë



Burimi: Aurela Anastasi, *Studim Çështje të Rritjes së Efektivitetit, Transparencës dhe të Besimit të Publikut në Gjyqësor, Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013, Tiranë, 2013*


Pyetja tjetër e lidhur me këtë aspekt: **A kishte në sallën e gjyqit qetësi dhe rregull?** Përgjigjet sipas të dhënave konsistojnë të jenë identike me ato të pyetjes: **A arrin gjyqtari të mban nën kontroll sallën e gjyqit?** Si në grafikun e më sipërm 7.

Grafiku nr. 8 -A u bëri Gjyqtari shpjegime pjesëmarrësve?




Burimi: Aurela Anastasi, *Studim Çështje të Rritjes së Efektivitetit, Transparencës dhe të Besimit të Publikut në Gjyqësor, Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013, Tiranë, 2013.*

Grafiku. 9. -A e përdori Gjyqtari së tepërmi gjuhën teknike ligjore?




Grafiku. 10 -A ishte toni dhe veprimet e Gjyqtarit, profesionale?



Burimi: Aurela Anastasi, *Studim Çështje të Rritjes së Efektivitetit, Transparencës dhe të Besimit të Publikut në Gjyqësor, Rezultate të nxjerra nga monitorimi i seancave dhe studimi i jurisprudencës gjyqësore, në lidhje me mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në rrethet gjyqësore Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë. Periudha e monitorimit: Shkurt 2012 - Tetor 2013, Tiranë, 2013.*


Anketimi qytetar; Në pyetjen drejtuar qytetarëve nga Tirana, prej të cilëve, 18 ishin femra dhe 27 meshkuj, me profesione: shkollim universitar 44, shkollim pas universitar 13 dhe pa shkollim universitar 8, të cilët jetonin të gjithë në Tiranë, rezulton, se ata, në masë të konsiderueshme, besojnë se në vendin e tyre ofrohen kushte dhe ambient i përshtatshëm për procese të rregullta ligjore.

Grafiku. 11 –A keni pasur raste të paraqitjes gjyqësore qoftë si i akuzuar apo si dëshmitar apo edhe si paditës?




Burimi: *Anketa me qytetarë – Autori, Tiranë, 2013.*

Grafiku. 12 –A besoni se në Tiranë, konkretisht në gjykatat në Tiranë zhvillohen procese të rregullta ligjore?




Burimi: Anketa me qytetarë – Autori, Tiranë, 2013.

Grafiku. 13 –Nga përvoja juaj me gjykata a jeni të kënaqur me trajtimin dhe procesin ligjor?



Burimi: Anketa me qytetarë – Autori, Tiranë, 2013.

Grafiku. 14 – A jeni në njohur të mundësisë së drejtimit edhe në gjykatën kushtetuese për adresime private?



Burimi: *Anketa me qytetarë – Autori, Tiranë, 2013.*

KAPITULLI IV: POZITA E TË PANDEHURIT NË KUADRIN E NJË PROCESI TË RREGULLT LIGJOR

4.1. Parimet themelore dhe të drejtat e të pandehurit

Për shekuj me radhë e drejta penale është konsideruar “dora e hekurt” e shtetit dhe është karakterizuar nga një ashpërsi dhe mungesë ndjeshmërie e vetë sistemit sanksionues. Kjo i detyrohet faktit që në qendër të kësaj fushe të rendit juridik nuk ishte vendosur figura e individit, por vetëm dhe ekskluzivisht Shteti, në funksion të mbajtjes së autoritetit të vetë sovran dhe të rendit publik. Gjatë periudhës historike të përkufizuar si *Regjimi Arkaik*, mungesa e çfarëdolloj parametri për kontrollin e veprimtarisë së ekzekutivit (sovrani dhe organet e tij) dhe të aparatit gjyqësor (Del 1766), favorizoi zbatimin e ligjit penal me mjaft abuzime, pabarazi dhe pasiguri si në planin procesor, ashtu edhe në atë thelbësor, duke iu referuar këtu sasisë së normave dhe sanksioneve përkatëse, shpesh të konsideruara në disproporcion dhe të tepruara.

E gjithë kjo pati si rrjedhojë natyrore daljen në përfundime të shpeshta arbitrare dhe me çmimin e thyerjeve të rënda të atyre që sot, sipas nomenklaturës moderne juridike, aktualisht e ndërfutur në perspektivën kombëtare dhe ndërkombëtare, e përkufizojmë si “të drejta themelore të njeriut”.

Norma penale ashtu si çfarëdo dukurie juridike, është e zhytur në kontekstin dhe në vlerat politike, shoqërore, kulturore, ekonomike, që një shoqëri shprehet në një çast historik të zhvillimit të saj.

Përpunimi i një sistemi kufizimesh - thelbësore substanciale dhe procedurale - për pushtetin ndëshkues të Shtetit, si reagim ndaj praktikave arbitrare të mësipërme, karakteristika të *regjimit arkaik*, është një fitore, fryt i mendimit iluminist siç e kemi

përkthyer edhe në historikun e këtij punimi, që më pas mori trajtë në Kushtetutat dhe kodimet evropiane duke filluar nga fundi i shek.XVIII një kontribut për këtë fitore u ofrua edhe nga ligji natyror, edhe pse iu desh të shquhej midis një rryme me prejardhje të drejtpërdrejtë iluministe.

4.1.1. Ligjshmëria e heqjes së lirisë së Personit

Parimi i ligjshmërisë ka një rëndësi të veçantë në vendosjen e masave të sigurimit, por edhe në heqjen e lirisë së personit, duke qenë se liria është një e drejtë e mbrojtur në kushtetutë por edhe në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), kështu që heqja e lirisë, por edhe vendosja e masave të sigurimit duhet të bëhet me ligj dhe në rastet e parashikuara.

Liria e personit është një e drejtë e garantuar nga kushtetuta. Për shkak të rëndësisë që ka kjo e drejtë, rastet e kufizimit të saj janë parashikuar në mënyre taksative në ligj. Edhe Kodi i Procedurës Penale kërkon që kufizimi i lirisë së shtetasve nëpërmjet aplikimit të masave të sigurimit, të realizohet vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara në ligj. Kushtetuta parashikon rastet e kufizimit të lirisë së personit, këto raste janë:

1. Kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente.
2. Për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj.
3. Kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj.
4. Për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent.

5. Kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse ,i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë.
6. Për hyrje të paligjshme në kufirin shtetërorë, si edhe rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

Pothuajse të njëjtin rregullim ligjor i bën edhe Konventa Evropiane çështjes së kufizimit të lirisë së personit. Kufizimi i lirisë është i lidhur ngushtësisht me përmbushjen e një sërë detyrash nga ana e organeve kompetente. Këto organe duhet të njoftojnë menjëherë personin të cilit i hiqet liria në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase si dhe për akuzën që i bëhet. Megjithatë, ka edhe autor të ndryshëm, të cilët mendojnë se nëse i arrestuari do të dërgohet parang një gjykate menjëherë në këtë rast nuk është e detyrueshme që ai të njoftohet për të gjitha akuzat. Ai duhet të informohet mbi të drejtën për mos të bërë asnjë deklaratë dhe t'i jepet mundësia për të komunikuar menjëherë me një avokat për realizimin e të drejtave të tij. Informacioni nuk është i detyrueshëm të merret në një formë të veçantë.

Personi i arrestuar thjesht, duhet të informohet në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të, mbi bazën faktike si dhe juridike të vendimit. Kjo ka të bëjë me mundësinë e shqyrtimit, pranë një gjykate, të pajtueshmërisë së tij me ligjin. Personit të cilit i hiqet liria si rezultat i aplikimit të një mase sigurimi, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit për të vlerësuar ligjshmërinë e burgimit, i cili duhet të vendos paraburgimin ose lirimin e tij, nëse paraburgimi është i paligjshëm, dhe jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit në lidhje me masën e paraburgimit. “Çdo person, viktimë e një arrestimi ose e një burgimi në kushte të kundërta me ato të parashikuara në

ligj, ka të drejtë për dëshmipërbliim”. Personat që procedohen në kundërshtim me ligjin ose dënohen pa të drejtë u kthehen të drejtat dhe shpërblehen për dëmin e pësuar”.

E drejta për t'u prezumuar i pafajshëm përdoret ndaj të dyshuarve përpara se të paraqiten akuzat penale përpara gjykimit dhe mbahet në përdorim derisa të konfirmohet gjetja me faj të akuzuarit, pas apelit përfundimtar. Prezumimi i pafajësisë është i lidhur ngushtë nga ana tjetër me të drejtën për të mos u detyruar të dëshmosh kundër vetes dhe të drejtën e heshtjes (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 27), si të drejta mosrespektimi i të cilave, cënon rëndë parimin kushtetues të garantimit të procesit të rregullt ligjor.

E drejta për t'u prezumuar i pafajshëm, kërkon që gjyqtarët të mos paragjykojnë asnjë çështje, ndërkohë që autoritetet publike (Kodi i procedurës Penale, neni 4), në veçanti prokurorët e policia, nuk duhet të bëjnë deklarata rreth fajësisë apo pafajësisë të një të akuzuari përpara përfundimit të gjykimit. Ajo do të thotë gjithashtu, që autoritetet kanë për detyrë të pengojnë mediat ose grupe të tjera të fuqishme shoqërore, që të mos ndikojnë në rezultatin e një çështjeje, duke u shprehur rreth saj.

Sipas këtij prezumimi, në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me shfaqje të figurës së portretit të individëve të ndryshëm, të ndaluar nga policia e shtetit, si të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale, mund të cilësohet apriori fajësia e tyre. Edhe në kushtet e vlerësimit të gjendjes së flagrancës, problemi është përsëri shumë i diskutueshëm, pasi kjo gjendje duhet të vlerësohet rast pas rasti dhe me detaje, të cilat shpesh hedhin poshtë pretendimet për kapje në flagrancë të personave të ndryshëm të ndaluar.

Masat e sigurimit janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal (Kodi i Procedurës Penale të Republikës

se Shqipërisë, neni 229/Kushtetuta e Republikës se Shqipërisë, neni 30 /Kodi i Procedurës Penale, neni 4/Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 31 /Kushtetuta e Republikës se Shqipërisë, neni 29/1/ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 29/2). Ato kanë si qëllim të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer një vepër, të pengojë shmangien e tij nga pendimi, përpjekjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si edhe të garantojnë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale.

Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Kufizimi i lirisë së personit nëpërmjet vendosjes së masave të sigurimit bëhet me ligj, duke u bazuar në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendosjen e këtyre masave. Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe pacënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale. Masat e sigurimit personal vendosen:

- a) Kur ekzistojnë shkaqe pacënueshmërie që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;
- b) Kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;
- c) Kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet. (Kodi i Procedurës Penale, neni 228).

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka ndryshuar ose prishur vendimet e gjykatave lidhur me vlerësimin e dyshimit të arsyeshëm. Në vendimin nr.122, datë 6.9.2001, Kolegji është shprehur:

“Gjykata, haptazi, në kundërshtim me të dhënat, dokumentet e administruara pranon në vendim se nuk ekzistojnë kushtet ligjore të parashikuara në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale se nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova... Në ngarkim të të gjithë të pandehurve ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ata kanë kryer veprën penale të trafikimit të mjeteve motorike dhe se ndaj tyre duhet të caktohet masa e sigurimit arrest në burg, e kërkuar nga prokurori.”

Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret, çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja si edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara në Kodin Penal.

Në vendimin me Nr 14 të datës 30.03.2015 Gjykata e Lartë arsyeton:

Në lidhje me caktimin e masës së sigurimit ligjvënësi ka parashikuar se, masat e sigurimit personal që kufizojnë të drejtat dhe liritë e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal, mund të caktohen vetëm kur ekzistojnë dhe provohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj. Këto kushte dhe kriteret, të shpallur që në nenin 5 të KEDNJ, janë materializuar edhe në nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kështu, në nenin 27 të Kushtetutës, një ndër rastet se kur liria e personit mund të kufizohet, parashikohet edhe rasti kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose, për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj, të materializuara edhe në ligjin procedural penal, konkretisht në nenin 228 dhe 229 të K.Pr.Penale për masat e sigurimit në përgjithësi dhe në veçanti, në nenin 230/1 për masën e sigurimit personal “Arrest në burg”.

Kështu në pikën 1 dhe 2 të nenit 228 të K.Pr.Penale, sanksionohen kushtet e përgjithshme që duhet të mbajë parasysh gjykata në caktimin e masës së sigurimit dhe të cilat janë:

Së pari: Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, ose elementi provues (fumus commisi delicti). Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova është kushti më i rëndësishëm që vlerësohet pasi, askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurimit personal nëqoftëse, në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova.

Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova sipas pikës 1 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, nënkupton që, bëhet fjalë për ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që, i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që jo vetëm se vepra penale është kryer, por dhe në drejtim të mundësisë se kjo vepër penale është kryer nga personi ndaj të cilit do të vendoset masa e sigurimit, që do të thotë se, kërkohet detyrimisht përgjegjësia e personit që akuzohet. Pra, Gjykata thekson se, dyshimi konsiderohet i arsyeshëm nëse, bazohet në fakte dhe në informacione të cilat, krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën ai akuzohet (Shiko Vendimin nr.72, date 18.05.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.).

Dyshimi i arsyeshëm në aplikimin e një mase siguri duhet të mbështetet në ato prova, të cilat duhet të jenë të tilla që, në atë gjendje në të cilat ato ndodhen, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie, për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, porse kjo shkallë dyshimi nuk duhet të jetë ezauruese. Në fazën e caktimit të masës së sigurimit natyrisht që, nuk mund të pretendohet se ka prova të plota që të mund të vërtetojnë akuzën, por

duhet të ketë aq prova sa, të krijojnë bazën e nevojshmërisë për caktimin e masës së sigurimit.

Së dyti: Ekzistenca e veprës penale. Përveç dyshimit të arsyeshëm, gjykata duhet të konstatojë nëse ekzistojnë dhe dy kushtet e tjera të përgjithshme. Kushti i dytë është ekzistenca e veprës penale, ku kërkohet që, fakti të jetë parashikuar nga ligji si vepër penale, apo vepra penale të mos jetë shuar për shkak parashkrimi të ndjekjes penale, ose për shkak të shfuqizimit të dispozitave penale, apo të mos jetë amnistuar.

Së treti: Ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas së drejtës penale. Kushti i tretë i përgjithshëm është ekzistenca e shkaqeve të dënueshmërisë së personit ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit. Nuk mund të caktohet masë sigurimi ndaj një personi që nuk mund të merret si i pandehur, ose nuk mund të dënohet si p.sh. personi që nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, apo personi që është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore, kur jemi para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, apo kur veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme. Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë, gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit.

4.1.2. Garancitë e Parimeve të së Drejtës Penale

Në rikujtim të faktit se pushteti ekzekutiv është shprehje vetëm e maxhorancës parlamentare, kurse pushteti gjyqësor është tërësisht i privuar nga çfarëdolloj dhënie kompetencë nga ana e qytetarëve. Legjitimimi politiko-institucional i Parlamentit në fushën penale bëhet edhe më lehtësisht i prekshëm me futjen e votimit universal. Parimet ligjore në fushën penale vërtiten rreth kushtit paraprak që në një demokraci të

së drejtës vetëm Parlamenti si i vetmi organ kushtetues që përfaqëson vullnetin e popullit ka fuqi ligjvënëse.

Nga e gjithë kjo rrjedh rezerva e ligjit në fushën penale: struktura e krimeve dhe tipologjia/sasia (të paktën në limitet e saj) e ndëshkimeve përkatëse duhet të përcaktohen nga ligji. Është e qartë se në një organizim juridiko-institucional të strukturuar në mënyrë të tillë nuk rezulton të ketë asnjë hapësirë për zakonin se parimi produktiv ose integrues i normave penale. Është e mundur të ekzaminohen nën parimet e tjera që, kundrejt parimit të përgjithshëm të ligjshmërisë penale përbëjnë rrjedhojat.

Nënparimi i saktësisë së normës penale: respektimi i parimit të saktësisë është i domosdoshëm edhe për të siguruar një seri nevojash të vetë sistemit penal, në një perspektivë parandalimi të përgjithshëm, në funksion të kërcënimit kundrejt autorëve të mundshëm të krimit: me qëllim që norma penale të mund të orientojë sjelljen e atyre të cilëve u drejtohet, është e nevojshme që të jetë e formuluar saktësisht, në mënyrë që t'i lejojë qytetarit të dijë nëse sjellja e tij do të ketë si pasojë ose jo një ndëshkim. Ai nënparim specifikon detyrimin për legjislatorin të disiplinojë me saktësi krimin dhe sanksionet penale, si dhe të evitojë që gjykatësi të marrë një rol krijues: për më tepër kufijtë midis të ligjshmes dhe të paligjshmes duhet të vendosen në vija të përgjithshme dhe abstrakte nga ligjvënësi. Dhe gjykatësit i takon vetëm zbatimi i ligjit (Lemmel,1970).

Kjo rrjedhojë, përveçse shprehje e ndarjes së pushteteve, është një garanci për lirinë dhe sigurinë e qytetarit, i cili mund të jetë i ndërgjegjshëm se çfarë është e ligjshme dhe çfarë jo vetëm nëpërmjet një formulimi të qartë të normës penale. Janë të ndryshme teknikat, në bazë të të cilave shkalla e saktësisë në formulimin e normave penale mund të jetë pak a shumë e lartë.

Një teknike tjetër e përdorshme në mënyrë abstrakte është ajo që u referohet klauzolave të përgjithshme: formula sintetike të kuptueshme për një numër të madh rastesh, Parimi i përcaktimit: Është pak e perceptueshme këtu nevoja, e paraqitur edhe prej iluministëve, që normat penale të përshkruajnë fakte që mund të jenë të vërtetuara dhe të provuara gjatë procesit, si një garanci e mëtejshme kundër arbitrave të mundshëm të gjykatësit. Pra nuk mjafton që norma penale të ketë një përmbajtje të qartë, por duhet që të pasqyrojë një fenomenologji empirike të vërtetueshme gjatë procesit, në bazë të parimeve të eksperiencës ose ligjeve shkencore.

Ligjvënësi nuk dëshiron të numërojë e të saktësojë. Përdorimi i kësaj praktike në rendet që frymëzohen prej parimit të ligjshmërisë, është i ligjshëm vetëm kur termat sintetike të përdorura prej ligjvënësit lejojnë që të dallohen mënyra mjaft e sigurta, hipotezat që të çojnë nën normën inkriminuese.

Nënparimi i dëmtimit: Në nënparimin konkret kërkohet: që sjellja e subjektit të jetë efektivisht e aftë të dëmtojë apo dhe të vë në rrezik një të mirë juridike të mbrojtur nga rendi juridik. Bëhet fjalë për një tjetër parim cilësues në aspektin liberal, përderisa si pasojë kemi një subjekt që nuk mund të dënohet për sjellje që edhe duke i kryer ndaj vetvetes, nuk paraqesin një nivel të mjaftueshëm dëmtues kundrejt të mirave juridike, rëndësia e të cilave të justifikojë ndërhyrjen ndëshkuese të Shtetit e kufizimin/privimin e lirisë personale të individit. rendi penal gjerman mund të përkufizohet “i orientuar nga etika”, sepse i jep një rëndësi të madhe (sjellje e brendshme e subjektit), si pasojë e së cilës një rol qendror në lidhje me përgjegjësinë penale merret nga veprimi i subjektit veprues në vetvete, duke mos marrë parasysh dëmtimin efektiv prej tij të një të mirë juridike.

Për këtë arsye flitet për “të drejtë penale të autorit” (në kundërvënien me “të drejtën penale të faktit”), pasi qëllimi është të dënosh autorin e vetëm që përfaqëson një kategori shoqërore të papranuar nga perspektiva që synojnë etikën (Pella, 1946). Është shprehje e qartë e asaj që përkufizohet “e drejtë penale e faktit” në kundërvënien me “të drejtën penale të autorit”. Duhet pasur parasysh që ky parim rrjedhë nuk rezulton të mbështetet nga të gjitha rendet.

Nuk lëmë në fund pa përmendur parimin e ndalimit të fuqisë prapavepruese të normës penale nevojshmërisht i pranishëm në çdo rend penal me theks liberal dhe demokratik, ashtu sikurse është parashikuar në kodin penal të Republikës së Shqipërisë të vitit 1995 i azhonuar (Elezi, Kacupi, Haxhia, 2007). Bazuar në parimin e ligjshmërisë: nëse Shteti do të mund të inkriminonte fakte të caktuara të kryera para hyrjes në fuqi të normës së re, do të ishte më e vogël mundësia e qytetarit që të kryejë në mënyrë të vetëdijshme sjellje në përputhje me ligjin dhe Shteti do të mund ta privonte nga liria personale në mënyrë tërësisht arbitrare. Në fakt, sidomos në skenën ndërkombëtare, ky parim ka qenë objekt shkeljesh të dukshme, siç do e shohim edhe në vijim.

Megjithatë mbetet i padiskutuar fakti që ndalimi i prapaveprimit të normave penale përbën një pikë lidhjeje me rëndësi thelbësore si në ngarkim të pushtetit gjyqësor, ashtu edhe në ngarkim të vetë ligjvënësit (përderisa as edhe vetë ligji nuk mund të parashikojë zbatimin prapaveprues të parimeve të tij): kjo lidhje, në veçanti ajo në ngarkim të vetë Parlamentit, specializon parimin e ligjshmërisë si parim i vendosur në ruajtje të sovranitetit popullor: Parlamenti si organ përfaqësues i popullit nuk mund të veprojë në mënyrë arbitrare kundër lirisë së vetë atij, pasi kjo do të ishte një situatë abuzimi për të ligjëruar veprimet arbitrare të shtetit kundër popullit që ai përfaqëson.

4.2. Pozita procedurale e të pandehurit

I pandehuri është subjekt qendror ndaj të cilit është drejtuar kërkesa procedurale, dhe ndaj të cilit fillohet dhe zhvillohet procedura penale, në rastet kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se ka kryer vepër penale. Cilësinë e të pandehurit në procedurë penale mund ta fitojë çdo person fizik i cili posedon aftësinë për të vepruar, gjegjësisht personi që ka moshën e caktuar dhe që është i përgjegjshëm, për tu konsideruar një person si i pandehur sipas të drejtës penale duhet që të ketë mbushur moshën 14 vjeçare. Personat nën moshën 14 vjeçare konsiderohen penalisht të papërgjegjshëm dhe si të tillë gjenden jashtë sferës së të drejtës penale. Kjo Kategori e personave nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pa marrë parasysh se çfarë veprë penale kanë kryer (Portali zyrtar Drejtësia Shqiptare, 2007).

Cilësinë e të pandehurit e fiton personi në momentin kur ndaj tij është ngritur ndonjë akt akuzues dhe këtë cilësi ai e ruan deri në përfundimin e procedurës penale.

I pandehuri i ka disa të drejta dhe detyrime. Detyrimi themelor i tij është t'i përgjigjet thirrjes së organit të procedurës. Në qoftë se nuk i përgjigjet thirrjes, atëherë procedohet me shoqërimin e detyrueshëm të tij.

Është e nevojshme të theksohet se i pandehuri, si rregull, nuk merret në pyetje me qëllim që të fitohet pohimi i tij se është autorë i veprës penale, por me qëllim që të njoftohet mbi bazat e akuzës dhe t'i mundësohet mbrojtja. Megjithatë, i pandehuri nuk është idetyruar që të japi deklarime pa prezencën e mbrojtësit, pasi ai ka të drejtë edhe të heshtë. Ligjvënësi ka përcaktuar se gjatë marrjes në pyetje duhet të respektohet plotësisht dinjiteti i të pandehurit. Në këtë drejtim, gjatë çdo marrje në pyetje të tij Kodi i Procedurës Penale ndalon keqtrajtimin, shkaktimin e lodhjes, ndërhyrjet fizike,

përdorimin e drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit, kanosjen, dhunën, premtimet në kundërshtim me ligjin dhe veprimet që dëmtojnë kujtesën e tij.

Krahasuar me periudhat e mëhershme kohore pozita e të pandehurit vazhdimisht ka ardhur duke u përmirësuar në dallim nga kohërat më të hershme ku i pandehuri gëzonte disa të drejta simbolike në procedurë të cilat nuk i garantonin një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, i pandehuri i nënshtrohej shpeshherë torturave, mundimeve, dhunës për ta pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën dyshohej dhe shpeshherë ndodhte që personat e pafajshëm të dënoheshin ndërsa fajtorët të liroheshin nga akuzat.

Sot, Kod i Procedurës Penale parashikon dhe ofron shumë të drejta, privilegje dhe garanci për të pandehurin, të drejta këto që garantojnë se ndaj tij do të zhvillohet një proces penal i drejtë, i paanshëm, i shpejtë dhe se vetëm personat përgjegjës do të shpallen fajtor dhe do të dënohen sipas ligjit, pra sot pothuajse nuk ka shtet në botë që nuk i parashikon dhe garanton këto të drejta për të pandehurin.

4.2.1. E drejta për t'u dëgjuar drejtësisht

Në thelb kjo nënkupton të drejtën e një personi për të paraqitur çështjen dhe provat në gjykatë, në kushte të tilla që nuk e vendosin atë në disavantazh në krahasim me palën tjetër. Kjo e drejtë nënkupton gjithashtu njohjen me materialet që posedon pala tjetër, mundësinë për të pyetur dëshmitarët në kushte të barabarta me palën tjetër, dëgjimin në prezencë të të akuzuarit, të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, kjo e drejtë quhet ndryshe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës ose aksesit në gjykatë. Çdo person ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës, siç e ka ilustruar çështja Golder (Çështja Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, 21 Shkurt 1975, Seria A nr. 18) kundër Mbretërisë së Bashkuar. Në këtë çështje është marrë pari vendim në parim në këtë

aspekt, Golder ishte një i burgosur në një burg anglez, që mendonte të ngrinte padi kundër një gardiani burgu për shpifje në adresë të tij. Sipas rregullores së burgut, ai i kishte kërkuar ministrit të brendshëm autorizim për t'u konsultuar menjë avokat por ministri e kishte refuzuar. Pra lindi pyetja nëse neni 6 i KEDNJ-së siguron thjeshtë të drejtën për një proces të rregullt ligjor në një procedurë tashmë të filluar, apo në mënyrë më të gjerë, ai i ofron gjithashtu çdo personi që ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave dhe detyrimeve, mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës? Është e vërtetë se KEDNJ nuk e përmend shprehimisht këtë të drejtë, por GJEDNJ e ka nxjerrë atë duke u bazuar në objektin dhe qëllimin e konventës, e cila duhet të rikujtojmë që synon mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kështu në çështjen Golder, gjyqtarët e Strasburgut evidentojnë se nuk ka se si të kuptohet që neni 6.1 i KEDNJ-së, mund të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u njihen palëve në proces, pa mbrojtur fillimisht të vetmen gjë që faktikisht bën të mundur të përfitohet prej tyre, aksesin tek gjykata. Ligjshmëria, publikimi dhe shpejtësia e procesit nuk do të kishin aspak interes nëse nuk do të kishte proces.

4.2.2. E drejta për një gjykim publik

Është një element thelbësor i kësaj të drejtë pa të cilën nuk mund të ketë një proces të rregullt ligjor. Ky element është një garanci për palët në gjykim sepse prania e publikut e kufizon në maksimum mundësinë e gjykatës për t'iu shmangur kërkesave të një procesi të rregullt ligjor dhe rrjedhimisht vendimi përfundimtar do të jetë më i drejtë. Ky parim lidhet me natyrën publike të zhvillimit të seancës gjyqësore dhe shpalljes së vendimit. Publiciteti i gjykimit është një nga mjetet me anë të të cilit garantohet transparenca e zhvillimit të tij, si dhe rritet besimi në veprimtarinë e gjykatës. Kërkesa për publikim vlen sigurisht për të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve,

por ajo është domosdoshme në fushën penale. Gjithsesi jo e gjithë procedura duhet të jetë publike, sipas GJEDNJ “ zhvillimi me dyer të mbyllura i seancave në gjykatën e lartë nuk përbën shkelje të nenit 6/1 (Çështja Sutter kundër Zvicrës 22 Shkurt 1984, Seria A nr.74. 404, Çështja Menet kundër Francës 14 Qershor 2005), kjo për faktin se gjykimi në gjykatën e lartë i kushtohet ekskluzivisht të drejtës dhe i intereson shumë pak publikut, aq më tepër kur kjo bëhet evidente për faktin që hetimi dhe informacionet lidhur me të duhet të mbeten sekrete”. Gjykata nuk është kundër kësaj ideje përderisa thekson se modalitetet e aplikimit të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ varen nga veçantitë e gjykimit sipas rastit (Çështja Sutter kundër Zvicrës 22 Shkurt 1984, Seria A nr.74). Kjo e drejtë nuk është absolute, ka raste kur gjykimi mund të jetë jo publik siç thotë dhe vetë neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së, kjo ndodh kur bëhet fjalë për moralin, rendin publik, sigurinë kombëtare, interesin e të miturve, mbrojtjen e jetës private. Përveç kësaj në të drejtat e brendshme ka shpesh dispozita që sanksionojnë këto kufizime të publicitetit. GJEDNJ pranon gjithashtu se në rastin e procedurës italiane të gjykimit të shkurtuar, gjyqtari gjatë hetimit paraprak që gjykon në themel me kërkesë të të pandehurit dhe me dyer të mbyllura, nuk ka shkelje të nenit 6 të KEDNJ sepse sistemi shpejton procedurën (Çështja Herini kundër Italisë, 18 Tetor 2006). Një shembull nga jurisprudenca e GJEDNJ është çështja Le Compete, Vanleuven dhe De Meyere kundër Belgjikës e datës 23 Qershor 1981, ku gjykata jo vetëm afirmon parimin e procesit publik, por thekson gjithashtu se publiciteti duhet të sigurohet në çdo fazë të gjykimit dhe se kufizimi pa shkak për një pjesë të tij nuk mund të mbulohet nga pjesët e tjera të zhvilluara rregullisht. Megjithatë kufizimet e këtij parimi, të cilat bëhen vetëm në ato raste kur është e nevojshme mbrojtja e të drejtave të mësipërme, në çdo rast vendimi që jep gjykata në përfundimin e procesit duhet të bëhet publik.

“Një drejtësi e vonuar është një drejtësi e mohuar” është tashmë një shprehje popullore. Kërkesa për një afat të arsyeshëm kohor nuk mbështetet në kritere objektive por në kritere subjektive. GJEDNJ thekson qëllimin e kësaj kërkeje e cila është mbrojtja e të gjithë palëve në proces kundër vonesave të tepërta procedurale, për të mos cënuar efektivitetin dhe besueshmërinë e vendimit gjyqësor. Ngadalësia edhe relative bën që procedura të mos jetë e rregullt dhe ligjore dhe që institucioni të humbasë besueshmëri dhe efikasitet. Në çështjen *Hozee kundër Vendeve të Ulëta e datës 22 Maj 1988*, GJEDNJ është shprehur se afati i arsyeshëm fillon nga momenti që akuzohet personi, në rastin konkret, ditën kur ankuesi ishte marrë në pyetje për herë të parë në cilësinë e të dyshuarit nga shërbimi i informacionit dhe investigimeve për çështjet fiskale. Dita e fundit është fundi i gjithë procedurës, përfshirë edhe fazat e rekurseve, pra është data e vendimit gjyqësor që vendos përfundimisht për ligjshmërinë e akuzës. GJEDNJ – ja thekson se : karakteri i arsyeshëm i kohëzgjatjes së procedurës që varet nga neni 6 i KEDNJ paragrafi 1 duhet të vlerësohet sipas rrethanave të çështjes (Çështja Konig kundër Spanjës 28 Qershor 1978). Në çështjen *Scordino kundër Italisë e datës 29 Mars 2006*, Italia i kishte kërkuar GJEDNJ-së që t’i jeptenjë tabelë reference që tregonte për çdo figurë penale numrin e viteve që kohëzgjatja e procedurës për gjykimin e saj, do të ishte normale. Kjo kërkesë u refuzua nga gjykata, e cila për argumentim ju referua çështjes së mësipërme. Pra vlerësimi bëhet konkret si rrjedhim nuk bëhet fjalë për ta cilësuar *in abstrakto* afatin e arsyeshëm ose të paarsyeshëm. Megjithatë pavarësisht se është një kriter që varion në varësi të veçorive që paraqet çdo çështje konkrete ka kritere për të vlerësuar nëse ky standard është respektuar, por gjithsesi ato mbeten kritere subjektive të çmuara nga gjykata. Në praktikë GJEDNJ pranon në parim disa kritere kryesore që shtetet duhet të marrin në konsideratë në lidhje me afatin e arsyeshëm dhe

që ato të mos dënohen:

1. Fillimisht është kompleksiteti i çështjes që përfshin të gjitha të dhënat faktike si ndërthurja dhe fshehja e veprimeve kriminale dhe të gjitha të dhënat ligjore si numri i palëve në proces (persona të akuzuar, dëshmitarë ose ndërhyrje e personave të tretë), elementët ndërkombëtar, bashkim çështjesh dhe moria e hetimeve që duhen kryer.
2. Pastaj është sjellja e ankuesit, edhe pse nuk është i detyruar të bashkëpunojë aktivisht me autoritetet gjyqësore, dhe ka mundësi t'i përdorë plotësisht të gjitha rrugët e rekursit (Çështja Corigliano kundër Italisë, 10 Dhjetor 1982, Seria A nr.57), ai nuk do të mund ta bllokojë sistematikisht veprimtarinë e drejtësisë, për shembull duke ndryshuar pa pushim avokatët, duke u arratisur (Çështja Vayic kundër Turqisë, 20 Qershor 2006) ose duke e vonuar me qëllim komunikimin e dokumenteve të nevojshme apo të emrave të dëshmitarëve që duhen dëgjuar. Shteti do ta evitojë dënimin nëse qëndrimi i palëve do të jetë abuziv dhe vonues (Çështja Vermillo kundër Francës, 20 Shkurt 1991, Seria A nr. 198 dhe Çështja Dobbartin kundër Francës, 25 Shkurt 1993, Seria A nr 256-D).
3. Së fundi është qëndrimi i autoriteteve gjyqësore. GJEDNJ thekson se shtetet janë të detyruara ta organizojnë sistemin e tyre në mënyrë të tillë që juridiksionet të veprojnë me shpejtësi normale (Çështja Martins Moreira kundër Portugalisë, 26 Tetor 1988, Seria A nr. 143). Shtetet kanë detyrimin për të arritur sa më shpejt në një rezultat, përveç rastit kur vonesa është e tolerueshme ose jo shumë e rëndë.
4. Shfaqet edhe një kriter i katërt të paktën në disa vendime, i cili ka të bëjë me

përfitimet për ankuesin (Çështja Philis kundër Greqisë, 27 Qershor 1997, Seria A nr.12 dhe çështja Portington kundër Greqisë, 23 Shtator 1998) në fushën penale. Lind pyetja cili është dënimi për tejkalim të afatit të arsyeshëm? Krahas dëmshpërblimit klasik, GJEDNJ pranon që gjyqtari kombëtar të zbusë dënimin, një masë e tillë mund të përbëjë një rregullim të përshtatshëm që i heq ankuesit çdo arsye për t'iu drejtuar Gjykatës së Strasburgut. Por duhet që gjyqtari të ketë dhënë një ulje dënimi, reale dhe të matshme dhe që këtë ulje ta ketë bërë haptazi për shkak të kohëzgjatjes së madhe të procedurës (Çështja Eckle kundër Spanjës, 15 Korrik 1982, Seria A nr. 51).

4.2.3. E drejta për gjykatë të përshtatshme

Sipas nenit 6 paragrafi 1 KEDNJ-së çdo person ka të drejtën për gjykatë “të pavarur, të paanshme, të krijuar me ligj”. Në të vërtetë kjo kërkesë e trefishtë reduktohet në një kërkesë të dyfishtë pasi problem paraqesin vetëm pavarësia dhe sidomos paanshmëria. Të dyja këto kërkesa janë të lidhura ngushtë dhe në unitet me njëra-tjetrën dhe duhen interpretuar bashkë.

Kur flitet për pavarësi të gjykatës kemi parasysh një pavarësi nga ndërhyrjet e institucioneve të tjera, nga gjykatat më të larta, nga palët, por jo pavarësi nga ligji. Një gjykatë mund të konsiderohet e pavarur duke analizuar një sërë elementësh. Së pari: pavarësia duhet të ekzistojë njëkohësisht kundrejt ekzekutivit dhe kundrejt palëve në proces. Për të parë nëse gjykata është e pavarur nga ekzekutivi duhet mbajtur kryesisht parasysh mënyra e emërimit dhe kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të saj, ekzistenca e mbrojtjes nga presionet e jashtme si dhe faktin nëse duket apo jo e pavarur. Fakti që gjyqtarët emërohen me vendim ose rekomandim të pushtetit ekzekutiv ose të

parlamentit nuk nënkupton mungesë pavarësie. Prania madje në shumicë e nëpunësve ose përfaqësuesve të shtresave të ndryshme sociale dhe profesionale nuk shkel garancinë për pavarësi (Çështja Piersack kundër Belgjikës, 1 Tetor 1982, Seria A nr. 53). Emërimi me kohëzgjatje të pakufizuar nuk është i nevojshëm pasi mjafton fakti që ata nuk mund të hiqen gjatë kohës së mandatit. Në përpjekje për të bërë një përkufizim të përgjithshëm të nocionit të pavarësisë së gjykatës do të evidentojmë se me këtë nocion kuptojmë qenien e lirë të gjyqtarit nga çdo lloj ndërhyrjeje, ndikimi ose presioni prej pushtetit ekzekutiv, legjislativ apo çdo subjekti tjetër në lidhje me mënyrën e vendimmarrjes së tij në çdo lloj çështjeje të veçantë. Për të vlerësuar mbi ekzistencën ose jo të pavarësisë së gjykatës, duhet të merren në konsideratë një sërë elementësh. Megjithatë ekziston një minimum kriteresh që duhen plotësuar për të pasur një gjykatë të pavarur, ato janë:

1. Garantimi i parimit të ndarjes së pushteteve. Në bazë të parimit të ndarjes së pushteteve, pushteti gjyqësor duhet të jetë i pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ. Marrëdhënia midis këtyre pushteteve duhet të konsistojë në njohjen reciproke dhe respektimin e kompetencave të secilit.
2. Përzgjedhja e gjyqtarëve në detyrë në bazë të aftësive të larta profesionale, integritetit moral si dhe paanshmërisë politike.
3. Sigurimi i kohës së qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve kjo nënkupton që largimi i gjyqtarit nga detyra të mos bëhet në bazë të kriterëve arbitrare por vetëm për shkaqe serioze që e bëjnë të pamundur vazhdimin e mëtejshëm të detyrës të parashikuara në legjislacion. Ndër këto shkaqe përmendim kryerjen e një krimi, paafësi mendore ose fizike, akte apo sjellje që diskretitojnë rëndë pozitën dhe detyrën e gjyqtarit etj.

4. Gëzimi i imunitetit, i cili është një element cilësor për të siguruar realisht pavarësinë e gjyqtarëve. Imuniteti nënkupton mos nënshtrimin e gjyqtarit ndaj një hetimi ose procesi gjyqësor për fjalët e thëna ose vendimet e dhëna gjatë ushtrimit të detyrës me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacion.
5. Pavarësia financiare duhet kuptuar si financim i gjykatave i cili duhet t'u mundësojë atyre ushtrimin normal të veprimtarive dhe funksioneve të ngarkuara nga ligji.

Paanshmëria e gjykatës është një tjetër kërkesë e procesit ligjor, e cila është vazhdim i idesë së pavarësisë por në qoftëse me pavarësi të gjykatës kuptojmë pavarësi institucionale me paanësi kuptojmë pavarësi personale të gjyqtarit. Gjyqtari duhet ta konsiderojë çështjen në mënyrë objektive, duke shmangur paragjykimet personale. Paanshmëria e gjykatës shfaqet e diskutueshme në të paktën tre raste: së pari kur një gjyqtar ose në përgjithësinjë person që e njeh çështjen, përpara vendimit jep pikëpamjen e vet në mënyrë mohuese për sistemin e mbrojtjes së të akuzuarit, së dyti kur ka rrezik për presion ndaj një organi gjykimi, dhe së treti kur i njëjti gjyqtar ka njëherësh në të njëjtën çështje më shumë se një funksion. Sqarimi i nocionit gjykatë e paanshme është bërë nëpërmjet jurisprudencës së GJEDNJ, ajo ka shpallur se “ekzistenca e paanshmërisë sipas qëllimeve të nenit 6, duhet të përcaktohet sipas një testimi subjektiv, domethënë në bazë të bindjes vetjake të një gjykatësi në një çështje të dhënë, si dhe në bazë të një testimi objektiv, që vërteton nëse ky gjykatës ofroi garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të përligjur në këtë drejtim” (Çështja Saraiva de Carvalho kundër Portugalisë, 22 Prill 1994, Seria A nr. 286 - B). Respektimi i kësaj kërkeje lidhet në një masë të konsiderueshme me perceptimin publik. Gjykata është shprehur

gjithashtu se në gjykimet penale, këndvështrimi i të akuzuarit edhe pse konsiderohet i rëndësishëm nuk është vendimtar për të arritur në përfundimin që gjykata nuk ka qenë e paanshme. Në fakt vendimtar është dyshimi i të akuzuarit, se një gjyqtar është i paanshëm, i cili mund të ketë baza për t'u justifikuar objektivisht (Çështja, Fey kundër Austrisë, 24 Shkurt 1993). Pra duhet që perceptimet mbi mungesën e paanshmërisë të mos ekzistojnë vetëm tek personi i lidhur drejtpërdrejt me çështjen në gjykim por të shfaqen në mënyrë të arsyeshme edhe tek vëzhguesi i jashtëm. Parim udhëheqës është që kur ekzistojnë fakte të sigurta të cilat e bëjnë vëzhguesin e jashtëm dhe objektiv, të kuptojë se gjyqtari nuk mund ta shqyrtojë çështjen me një mendje tërësisht të hapur, atëherë mund të parashtrohet çështja e paanshmërisë së tij, edhe nëse gjendja subjektive e tij nuk është e tillë që të ngrejë dyshime.

Nëse do t'i referohemi jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të drejtave të njeriut, gjykatë do të quhet vetëm organi kompetent për të dhënë vendime ligjërish të detyrueshme, të cilat nuk mund t'i anulojë asnjë institucion jogjyqësor (Noëicki, 2003: 182). Sistemi gjyqësor gëzon një pozitë autonom specifik duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe është i pavarur nga ndërhyje e pushteteve të tjera.

4.2.4. E drejta për një gjykim të arsyeshëm

Neni 6 kërkon që gjykatat vendase të japin arsye mbi vendimet e tyre si një ndjekjet penale. Gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo pyetje, por nëse një kërkesë është thelbësore për rezultatet e çështjes, gjykata atëherë duhet që specifikisht t'a trajtojë atë në gjykimin e saj. Në *Hiro Balani kundër Spanjës*, kërkuesi kishte bërë një kërkesë në gjykatë që kërkontejë përgjigje specifike e të shpejtë. Gjykata nuk i dha dot përgjigjen duke krijuar dyshime për faktin nëse ajo

thjesht e kishte neglizhuar trajtimin e asaj çështjeje apo e bëri me qëllim hedhjen poshtë të saj dhe nëse po, cilat ishin arsyet për një refuzim të tillë. Kjo u konstatua se përbënte shkelje të Nenit 6(1) (Agaj, 2012).

Një çështje që është marrë në shqyrtim nga Gjykata është mungesa e dhënies së vendimeve me arsye bindëse nga juritë në çështjet penale. Komisioni u shpreh në një çështje kundër Austrisë se nuk konstatoi shkelje pasi jurisë i ishin bërë pyetje të detajuara për t'u përgjigjur dhe këshilltari ligjor mund të aplikonte për të bërë ndryshime dhe kjo gjë specifike krijoi mungesë të arsyeve. Gjithashtu, kërkuesi mund dhe aktualisht gjeti motive të pavlefshmërisë në bazë të keq drejtimit të jurisë nga gjyqtari përse i përket se drejtës (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2004).

4.2.5. E drejta për një proces të rregullt ligjor si një nga standardet e të drejtave dhe lirive themelore në çështjet penale

Në shoqëritë bashkëkohore demokratike të drejtat e njeriut konsiderohen parime bazë, pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjitet dhe shoqëria nuk mund të njohë progres. Pikërisht, duke u nisur nga roli i padiskutueshëm që ato luajnë në zhvillimin e individit dhe shoqërisë, një vend të rëndësishëm zë trajtimi i çështjeve që lidhen me garantimin që i rezervohet të drejtave të njeriut, pjesë e pandashme e të cilave është dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor. Me proces të rregullt ligjor duhet kuptuar ai proces i rregulluar në mënyrë që të nxisë apo favorizojë në respekt të garancive procedurale, ndjekjen e një vendimi të saktë e të drejtë, bazuar nënjë rindërtim "të vërtetë, të arsyeshëm dhe të kontrollueshëm të rastit konkret ose më mirë, të pretendimeve faktike që e përbëjnë atë." (Diritto e ragione, 2000: 8)

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përmban një listë

të gjatë të të drejtave procedurale që u njihen të gjithë personave që janë palë në një proces në kuptim të gjerë: e drejta për proces publik, që procesi të përfundojë në një afat të arsyeshëm dhe të drejtohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e drejta e prezumimit të pafajësisë. Që në fillim neni 6 afirmon se “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet rregullisht. Kjo shprehje e përgjithshme mbulon të gjitha të drejtat e veçanta që paraqiten në këtë nen, por edhe këtu nuk ka asnjë përkufizim. Duke lexuar nenin 6 të KEDNJ ligjshmëria mund të përkufizohet në dy mënyra: në kuptimin e ngushtë ligjshmëri do të thotë se secila prej palëve në proces mund të mbrojë çështjen e vet në kushte përgjithësisht të barabarta në raport me palën kundërshtare (Salvia, 1995: 265). Në kuptim të gjerë ligjshmëri është sinonim i drejtësisë dhe përfshin disa të drejta të veçanta si e drejta për t’u gjykuar nga gjykata në afat të arsyeshëm etj. Këtu duhet të shtojmë prezumimin e pafajësisë pa të cilin nuk ka proces të vërtetë, pra proces të rregullt ligjor. Madje nëpërmjet disa vendimeve Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e miraton këtë konceptim të gjerë, sidomos kur thotë se paragrafi i parë i nenit 6 është norma bazë, paragrafit 2 dhe 3 janë zbatime të veçanta të tij (Çështja Lutz kundër Spanjës 25 Gusht 1987, Seria A nr. 123 - B), ose kur thekson se kërkesat e paragrafit të 3 analizohen si aspekte të veçanta të së drejtës përnjë proces të rregullt ligjor që garantohet nga paragrafi 1 (Çështja Isgro kundër Italisë 19 Shkurt 1991, Seria A nr. 34 – B). GJEDNJ ka pranuar konceptimin e gjerë të fushës penale sepse nëse shtetet kontraktuese do ta cilësonin një shkelje më shumë disiplinore se sa penale përdorimi i klauzolave themelore të nenit 6 do të varej nga vullneti i tyre sovran një liri kaq e madhe rrezikon të çojë në rezultate të papajtueshme me qëllimin dhe objektin e konventës (Çështja Engel dhe të tjerët kundër Hollandës 8 Qershor 1976, Seria A nr. 22 – B. Është vendimi në parim ku si pasojë e thyerjes së disiplinës ushtarake, një ushtarak

i forcave holandeze ishte dënuar me burgim. Por, GJEDNJ nuk e pranoi të drejtën e Holandës që e rendiste procedurën ndëshkimore në të drejtën disiplinore e jo në të drejtën penale). Gjithsesi çdo dënim jo penal *stricto sensu* nuk është automatikisht penal në kuptimin e konventës. Sipas GJEDNJ ai është i tillë vetëm sipas tri kritereve, që lidhen me treguesit e të drejtës kombëtare, me natyrën e veprës ose të sjelljes, me qëllimin dhe ashpërsinë e dënimit, këto të fundit mbahen parasysh për të përcaktuar ekzistencën e një akuze në fushën penale. Shtrirja e nenit 6 varet edhe nga akuza dhe GJEDNJ nuk mbështetet në përkufizimet kombëtare të akuzës, por miraton një përkufizim autonom. Për gjyqtarët e Strasburgut akuza rezulton nga njoftimi zyrtar i akuzës për kryerjen e një vepre penale që bën autoriteti kombëtar kompetent. Në disa raste ai mund të marrë edhe formën e masave të tjera që e nënkuptojnë një akuzë të tillë dhe që çojnë në pasoja të rëndësishme për situatën e të dyshuarit (Çështja Deêr kundër Belgjikes, 27 Shkurt 1980, Seria A nr. 35 – B). Gjyqtarët e Strasburgut pranojnë një konceptim material dhe jo formal të akuzës, hedhin poshtë aparencat procedurale duke ju përmbajtur realiteteve. Aplikimi i nenit 6 i KEDNJ fillon me akuzën, duke bërë që ai jo vetëm të mos kufizohet në fazën e gjykimit por përfshin edhe pjesë të mirë të fazës përgatitore si dhe ekzekutimin e vendimeve të drejtësisë, i tillë është rasti i vendimit Hornsby kundër Greqisë (Çështja Hornsby kundër Greqisë, 19 Mars 1997, Seria A nr. 229 – B), në të cilin gjykata afirmon se “duke mos marrë përgjatë pesë viteve masat e nevojshme në përputhje me vendimin gjyqësor përfundimtar dhe të ekzekutueshëm, autoritetet kombëtare i kanë privuar dispozitat e nenit 6.1 të KEDNJ nga çdo efekt i dobishëm”. Ky rast nuk kishte të bënte me çështje penale, por vendimi përcakton se ekzekutimi i gjykimit ose vendimit, të cilitdo juridiksioni, duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e procesit në kuptimin e nenit 6 të KEDNJ-së. Gjithçka që vjen pas akuzës,

qoftë ky procedim penal apo ekzekutim i vendimit penal, varet nga neni 6 i KEDNJ-së. Rëndësia e së drejtës për një proces të rregullt ligjor shfaqet në dy këndvështrime: së pari, neni 6 i konventës u lë shteteve një liri shumë të reduktuar, pavarësisht se ajo ka një karakter të kushtëzuar në një farë mënyre relative, meqenëse konventa parashikon shmangien që konsiston në një moszbatim total, por të përkohshëm sipas nenit 15 paragrafi parë i KEDNJ-së që bazohet në ekzistencën e rasteve të gjendjes së jashtëzakonshme (në rast lufte, ose në rast të një rreziku tjetër publik që kërcënon jetën e kombit) duke shmangur parimin për proces të rregullt ligjor me përjashtim të aspektit që lidhet me publikimin e debateve (Çështja Laë less kundër Irlandës, 14 Nëntor 1960, Seria A, nr. 1). Megjithatë ndryshe nga dispozita të tjera si për shembull neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) neni 12 (e drejta për martesën) etj, neni 6 nuk lejon që të mbahen shumë parasysh të dhënat kombëtare. Së dyti, duket se koncepti i ligjshmërisë lidhet me të gjithë procedurën penale në kuptimin e gjerë, jo vetëm me bërthamën e saj që përbëhet nga rregullat e funksionimit të drejtësisë nga fillimi e deri në fund të procedurës, por edhe me strukturën e administratës gjyqësore. Pra studimi i nenit 6 duhet të parashikojë ligjshmëri në organizimin gjyqësor dhe në rregullat procedurale.

4.2.6. E drejta për të mos kontribuar në vetë-inkriminim

Gjykata është shprehur se:

“E drejta për seancë të drejtë gjyqësore në çështjet penale përfshin *“të drejtën e gjithsecilit të akuzuar për një kundërvajtje penale... të mos flasë dhe të mos kontribuojë në vetë-inkriminim e tij”* (Agaj, 2012).

Në çështjen e *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar* Gjykata deklaroi se:

“Gjykata kujton se megjithëse jo specifikisht është përmendur në nenin 6 të

Konventës, e drejta për të mos folur dhe e drejta për të mos u vetë-inkriminuar janë zakonisht standarde të njohura ndërkombëtare që qëndrojnë në thelbin e nocionit të një procedure të drejtë sipas nenit 6. Parimi i tyre bazë ndërmjet të tjerave qëndron në mbrojtjen e të akuzuarit kundrejt detyrimit të padrejtë nga autoritetet duke kontribuar në shmangien e gabimeve të drejtësisë dhe në përmbushjen e synimeve të Nenit 6. . . E drejta për të mos inkriminuar vetveten në veçanti presupozon që gjyqi në një çështje penale kërkon që të provojë akuzën kundër të pandehurit pa u mbështetur në provat e përftuara nëpërmjet metodave të detyrimit apo dominimit në mbrojtje të vullnetit të të akuzuarit. Në këtë sens e drejta është e lidhur ngushtë me prezumimin e pafajësisë në përmbajtje të Nenit 6 (2) të Konventës. E drejta për të mos kontribuar në vetë-inkriminim ka lidhje kryesisht me respektimin e vullnetit të një të akuzuari për të mos folur. Siç kuptohet përgjithësisht në sistemet ligjore të Palëve Kontraktuese të Konventës dhe në vende të tjera, kjo e drejtë nuk shtrihet në përdorim në proceset gjyqësore të materialeve që mund të përftohen nga i akuzuari nëpërmjet përdorimit të kompetencave detyruese, por që kanë një ekzistencë të pavarur nga vullneti i të dyshuarit si për shembull, midis të tjerash, dokumente që janë marrë në bazë të një mandati”.

Kjo çështje kishte të bënte me një drejtor kompanie të cilit iu kërkuar me ligj që t’u përgjigjej pyetjeve të bëra nga autoritetet qeveritare në lidhje me dhënien e informacionit për veprimtaritë e biznesit të kompanisë që iu nënshtrua sanksioneve penale. Të dhënat e intervistës u pranuan me vonë si prova kundër tij në një gjyq ku ai u dënua. Gjykata e konsideroi këtë si shkelje të Nenit 6.

Gjykata ka zgjedhur një pikëpamje tjetër përse i përket rregullave që lejojnë tërheqjen e formave të ndërhyrjeve të kundërta nga heshtja e një të akuzuari gjatë marrjes në pyetje ose gjykimit. Gjykata u shpreh në çështjen e *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* "e drejta për të qëndruar në heshtje" nuk është një e drejtë absolute. Megjithatë është në kundërshtim me këtë imunitet për të bazuar një dënim vetëm ose kryesisht nga heshtja e të akuzuarit ose nga refuzimi i tij për t’iu përgjigjur

pyetjeve, është e qartë se ky privilegj nuk parandalon që të merret parasysh heshtja e të akuzuarit që është e qartë se ka nevojë për të dhënë shpjegime. Gjykata konstatoi në këtë çështje se legjislacioni i zbatuar nuk shkelte nenin 6. Kërkuesi nuk i ishte nënshtruar detyrimit të drejtpërdrejtë, ku as nuk ishte gjobitur, as paralajmëruar me burgim. Gjykata me tej konstatoi se përdorimi i ndërhyrjeve ishte një shprehje e implikimit që nënkuptohet kur një i akuzuar dështon që të jap një shpjegim pafajësie për veprimet ose sjelljen e tij. Kishte mjaft garanci që përputheshin me gjykimin e drejtë dhe barra e përgjithshme e provës i mbetej prokurorit, i cili duhej të përcaktonte çështjen *prima facie* përpara se të merrej parasysh ndërhyrja (Agaj, 2012).

Gjykata megjithatë u shpreh në çështjen e *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar* se juria duhej të drejtohej në mënyrën e duhur nga gjyqtari i gjyqit kur merr vendime nëse duhet apo jo të nënkuptohet si pohim heshtja e të akuzuarit me qëllim që të mos përbejë shkelje të Nenit 6 (Agaj, 2012).

4.2.7. Barazia në mjete dhe e drejta për t'u vënë në dijeni për faktet e argumentet e palës kundërshtare dhe anasjelltas

Kjo nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabartëqë të paraqesë çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit. Duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis palëve (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2004).

E drejta përnjë seance të drejtë përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dy palët nënjë proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë për palët nënjë seance penale që të kenë njohuri edhe mbi komentet mbi provat e nxjerra ose hetime të arkivuara. Në çështjet penale ato mbivendosen me disa garanci të veçanta të Nenit 6 (3) por nuk kufizohen me

ato aspekte të procedimeve. Për shembull, Gjykata u shpreh nëçështjen e *Bonisch kundër Austrisë*, se kur një eksperti për dëshmitaret i caktuar nga mbrojtja nuk i jepet lehtësia enjëjtë si atij të caktuar nga prokurori i gjykatës, atëherë kemi shkelje të Nenit 6 (1).

Me pas Komisioni u shpreh në *Jespers kundër Belgjikës*, se parimi i barazisë në mjete i interpretuar së bashku me Nenin 6 (3) imponon një detyrim mbi autoritetet gjyqësore e hetuese për të nxjerrë ndonjë material që është në zotërim të tyre, ose për të cilat ata mund të marrin akses, që mund të asistojnë të akuzuarin për të dhënë prova pafajësie ose për të marrë reduktimin e dënimit. Ky parim shtrihet për materiale që mund të dëmtojnë besueshmërinë e një dëshmitari gjyqi. Në *Foucher kundër Francës*, Gjykata u shpreh se kur të pandehurit që dëshiron të përfaqësohej iu mohua akses nga prokurori i çështjes dhe nuk iu lejuan kopje të dokumenteve që përmban çështja, e si rrjedhim nuk ishte në gjendje të përgatiste mbrojtje të duhur, kjo rezultoi në shkelje të parimit të barazisë në mjete, të interpretuar së bashku me Nenin 6. Çështja e *Roe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në lidhje me gjyqin e dy kërkuesve dhenjë të tretë, të cilët ishin akuzuar me vrasje e sulme që kishin rezultuar në dëmtime trupore, e me tre akuza për vjedhje. Gjyqi u mbështet konsiderueshëm në provën e dhënë nga një grup i vogël njerëzish që jetonin me kërkuesit dhe atë të së dashurës së njërit prej kërkuesve. Të tre burrat u dënuan për akuzat ndaj tyre dhe Gjykata e Apelit e mbështeti dënimin e tyre (Mole, Harby, 2003).

Gjatë gjyqit ndaj tyre në nivelin e shkallës së parë gjyqësorë u mor vendimi pa njoftuar gjyqtarin duke u bazuar në disa prova me motivin e interesit publik. Në fillimin e apelit të kërkuesve prokuroria vuri në dijeni mbrojtjen se informacione të caktuara ishin refuzuar të jepeshin pa zbuluar natyrën e këtij materiali. Më tej në dy raste Gjykata

e Apelit rishikoi provat e pazbuluara në seanca të ndara me propozimet e akuzës por nëmungesë të mbrojtjes. Gjykata vendosi në favor të mos-zbulimit të provave (Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2004).

Gjykata Evropiane vuri në dukje se e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute dhe se mund të ekzistojnë interesa konkurruese si për shembull mbrojtja e dëshmitareve ose mbajtja sekrete e metodave të policisë së hetimit të krimit. Megjithatë, masat e vetme që kufizojnë të drejtat e mbrojtjes që janë të lejueshme sipas Nenit 6 janë ato që janë rreptësisht të nevojshme. Gjykata u shpreh se vlerësimi i akuzës për rendësin e informacionit të pazbuluar nuk përputhej me parimet e vënies në dijeni për faktet dhe argumentet e palëve respektivisht dhe të barazisë nëmjetë. Procedura përpara Gjykatës se Apelit nuk ishte e mjaftueshme për të ndrequr padrejtësinë që ishte shkaktuar. Kjo për shkak se gjyqtarët bazoheshin në materialet e marra nga gjyqi i parë dhe në çështjet e parashtruara atyre vetëm nga akuza për të kuptuar vërtetësinë e mundshme të materialit të pazbuluar (Mole, Harby, 2003).

4.3. Parashikimet ligjore

Aktet ndërkombëtare të miratuara, në luftën kundër veprimtarive të rrezikshme kriminale, janë të larmishme dhe të konsiderueshme, të cilat me kalimin e kohës, janë plotësuar dhe përmirësuar; edhe konventa e OKB-së të vitit 1988, “Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe lëndëve Psikotrope. Kjo konventë parashikon konfiskimin e fitimeve që rrjedhin nga këto vepra penale, por meqenëse më vonë këto vepra penale u përfshin në konventën e OKB-së, për efekt studimi po ndalemi tek kjo e fundit. Ky studim duke mos qenë shterues, do të fokusohet në luftën kundër veprimtarive të rrezikshme kriminale, nëpërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprave penale dhe në qendër të studimit do të ketë disa nga konventat

më të rëndësishme ndërkombëtare, por më së shumti do të fokusohet në Konventën e OKB-së, kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (tani edhe në vazhdim do të quhet Konventa e OKB-së kundër KON-së) dhe në Konventën e Varshavës ose të Këshillit të Evropës për Depistimin, Kërkimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Veprave Penale (këtu e në vazhdim Konventa e Varshavës). Këto konventa parashikojnë një sërë masash në luftën kundër këtyre fenomeneve, por për efekt studimi ne do të trajtojmë vetëm sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprave penale, si instrument i vjetër për të luftuar fenomene të reja, të cilat sjellin privimin nga pasuria, produkt i veprimtarisë kriminale të këtyre personave.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së, kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Ligji nr.8920, dt.11.07.2002, për ratifikimin e “Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe 2 protokolleve shtesë së saj”. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenet 5, 116 dhe 122 (Neni 116-1, Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: b-marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara), kjo konventë është pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe e detyrueshme për t’u zbatuar nga shteti shqiptar. Konventa, e cila përmban norma me karakter material dhe procedural, shpall si qëllim të saj luftën kundër KON-së, duke parashikuar edhe mjetët konkrete në luftën kundër këtij fenomeni kaq shqetësues për mbarë popujt. Në këtë konventë midis shumë masave të tjera, parashikohet, si masë kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar edhe sekuestrimi, ngrirja, pezullimi dhe konfiskimi i produkteve të këtyre aktiviteteve kriminale (Për më shumë shiko, nenin 12 të Konventës së OKB-së kundër KO-së) . Por përpara se të ndalemi tek masat kundër pasurisë që rrjedh nga aktivitetet kriminale, siç janë sekuestrimi dhe/ose konfiskimi i produkteve të krimit, mendojmë se është e nevojshme

të ndalemi tek përkufizimet që japin konventat mbi disa nocione të rëndësishme në paragrafin e mëposhtëm.

4.4. Roli i Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese

Në Komisionin për Hartimin e Kushtetutës ka pasur diskutime të shumta e të gjata në lidhje me të drejtat e liritë themelore. Diskutimet i referohen si tërësisë së të drejtave që do të përfshiheshin dhe koncepteve themelore që lidheshin me të drejtat e liritë themelore, ashtu edhe për mekanizme që do të garantonin sa më shumë ato.

Kushtetuta garanton të drejtat e liritë themelore me anë të parimeve themelore që ajo sanksionon. Parime të tilla të rëndësishme si ai i demokracisë të drejtpërdrejtë apo të përfaqësuar, kjo e fundit përmes një procesi votimi i cili ligjërisht garantohej, apo parimi i ndarjes së pushteteve, i kontrollit e balancimit të tyre, ai i barazisë para ligjit, ai i mosdiskriminimit, i decentralizimit.

Po ashtu parashikohet që për to nuk do të ketë kufizime apo shënime përveçse me ligj (rezerva ligjore), për interesa të publikut ose të të drejtave të tjera themelore (balancimi i të drejtave), jo duke prekur thelbin e së drejtës (jo zhdukje e së drejtës) dhe në respektim të kufizimeve të KEDNJ-së (garancia ndërkombëtare). Madje, Kushtetuta nuk ka lejuar që të kufizohen një kategori e gjerë e të drejtave edhe në rastet e masave të jashtëzakonshme (Neni 175 i Kushtetutës) duke garantuar kështu të drejtat e liritë edhe në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo gjendje të fatkeqësive natyrore. Gjithashtu, edhe vetë mundësia e ndryshimit të Kushtetutës me rregullat e parashikuara është një mekanizëm garantimi për to. Vlen të përmenden një sërë mekanizmesh, të cilat Kushtetuta i ngre për të garantuar të drejtat e liritë themelore. Kështu, për herë të parë në këtë Kushtetutë parashikohet një institucion si ai i Avokatit të Popullit, detyra e posaçme e të cilit është të mbrojë të drejtat e liritë themelore nga veprimtaria e

administratës publike. Vetë garantimi i mbrojtës së tyre në gjykatë (jo për objektivat sociale), madje duke dalë përtej kufijve gjeografikë të vendit tonë, duke pasur mundësinë e mbrojtjes edhe në mekanizma ndërkombëtarë, ndër të cilët më i rëndësishmi është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, është një institut madhor i garantimit.

Gjykata Kushtetuese shqiptare e ka interpretuar në mënyrë të gjerë dhe krijuese Kushtetutën, sidomos në rastet e mbrojtjes së të drejtave individuale. Në vendimet e saj, jo vetëm janë detajuar garancitë e përmendura në Kushtetutë, por edhe janë afirmuar elemente të reja garantuese. P.sh., përmes interpretimit janë vendosur parime të pathëna shprehimisht në Kushtetutë, të cilat vlerësohen si parime-garanci mjaft të rëndësishme për të siguruar zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore. I tillë është parimi i sigurisë juridike, parimi i qartësisë dhe saktësisë së normave, parimi i të drejtave të fituara, parimi i barazisë së armëve etj. Në këto raste mund të flasim jo vetëm thjesht për një interpretim të Kushtetutës, por edhe për një ndryshim të saj, përderisa Gjykata ka zgjeruar me fjalë të tjera thelbin e përmbajtjes dhe frymën e Kushtetutës. Në fakt, e gjitha kjo që ndodh është një hapësirë e krijuar dhe e lejuar nga vetë Kushtetuta, e cila e ka thirrur drejtpërdrejt Konventën Evropiane për të drejtat e Njeriut për të garantuar shkallën e kufizimeve të drejtave kushtetuese, i ka vendosur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me fuqi mbiligjore, si dhe i ka dedikuar Gjykatës sonë Kushtetuese të drejtën për të kontrolluar pajtueshmërinë e ligjeve të brendshme me konventat ndërkombëtare. E vetmja gjë që ka shtuar Gjykata Kushtetuese në këtë pikë, është fakti se kur kontrollon pajtueshmërinë e ligjeve me konventën ndërkombëtare, ajo mban në vëmendje jo vetëm tekstin e konventës si të tillë, por edhe interpretimet që Gjykata Evropiane, i ka bërë dispozitave të saj. Në zgjidhjen e çështjes, ajo u referohet

shpesh, vendimeve të Gjykatës Evropiane të të drejtave të Njeriut, por edhe vendimeve të gjykatave të vendeve të tjera demokratike, si dhe doktrinae më të reja kushtetuese.

Gjykata jonë Kushtetuese, ka interpretuar gjithashtu, edhe rezervën ligjore, si një nga garancitë thelbësore kushtetuese që konsiston në kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore vetëm me ligj (Neni 17 i Kushtetutës). Në këtë rast, interpretimi është zhvilluar brenda fjalëve të Kushtetutës.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka parashikuar, në vijim të listimit të të drejtave e lirive themelore një sërë garancish proceduriale për to, të tilla si kriteret e kufizimit të tyre, qoftë edhe në kohë masash emergjence në vend;
- Sistemi i drejtimit të shtetit i parashikuar në Kushtetutë në vetvete me parimet themelore të tij, të tilla ishte ndarja e pushteteve, kontrolli e balancimi, barazia e mos diskriminimi, etj., është një garanci e lartë për të drejtat e liritë themelore;
- Vendi që Kushtetuta jonë i ka lënë në sistemin e së drejtës, të drejtës ndërkombëtare përbën ekzistencën e garancive të shumta të jashtme, apo ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut;
- Ekzistenca e mekanizmave të shumtë, të cilët funksionojnë si kontrollues e vendimmarrës në raste cenimesh të të drejtave e lirive dhe ankimi në lidhje me to është një tjetër garanci e qenësishme për çështjen në fjalë;
- Janë krijuar mekanizma, të cilët përpiqen të ndikojnë në krijimin e një kulture respektimi të drejtash e lirish (rasti i Avokatit të Popullit), moment ky mjaft i rëndësishëm për të pasur një garantim real të të drejtave e lirive;
- Veprimtaria normative, ligjore, ajo administrative/ekzekutive si dhe ajo gjyqësore, ka treguar aktivizim me një bilanc pozitiv në mbrojtje e garantim të të drejtave e lirive;

- Hallkat e gjyqësorit janë përdorur, madje deri edhe GJENDJ - gjykatë jashtë sistemit vendas të së drejtës, dhe vendimmarrjet e tyre gjithnjë e më shumë janë në vëmendje dhe në zbatim;
- Jurisprudenca, kryesisht e Gjykatës Kushtetuese, interpretueses përfundimtare të Kushtetutës, është aktive në garantimin e të drejtave/lirive themelore të njeriut.

4.4.1. E drejta për një proces të rregullt ligjor - Neni 42 i Kushtetutës së Shqipërisë

E drejta për një proces të rregullt ligjor, është një e drejtë-garanci kushtetuese. E parashikuar nga dy paragrafët e nenit 42:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor;

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj (Vorpsi, 2011).

Ajo garanton të drejtën e çdo personi që, për mbrojtjen e interesave të tij të ligjshme, t'i drejtohet gjykatës apo, organeve kompetente shtetërore. Gjykimi i drejtë është një koncept kompleks, që sidoqoftë, reduktohet në një gjykim që zhvillohet nga një gjykatë kompetente në bazë të ligjeve përkatëse. Është një e drejtë që përfshin qartë për njohjen e kësaj të drejtë për të gjithë qytetarët. Nuk mund të ketë asnjë arsye të ligjshme që të privojë ndonjë person apo ndonjë kategori personash nga kjo e drejtë e rëndësishme. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor përbëhet nga dy pjesë, të cilat cenohen nëse do të cenohet kjo e drejtë kushtetuese. Në radhë të parë, cenohen liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe, në radhë të dytë, ky cenim ka ardhur pa një proces të rregullt gjyqësor. Nuk është fjala për një proces të rregullt gjyqësor

vetëm në kuptimin procedural të tij, por në një kuptim më të gjere, apo në kuptimin thelbësor të tij. P. sh. të drejtat e njeriut garantojnë drejtpërdrejtë nga Kushtetuta dhe ligjet. Jo gjithmonë lind nevoja për ekzistencën e një procesi gjyqësor. Nëse individ i ushtron lirinë e shprehjes të afirmuar në nenin 22 të Kushtetutës dhe bën publike opinionet e tij në media, ai nuk mund t'i nënshtrohet asnjë lloj procesi gjyqësor, qoftë edhe të rregullt. Kështu, nuk do të ketë fare proces gjyqësor pasi drejta e tij për të shprehur lirisht opinionet, garantohet nga Kushtetuta.

4.4.2. Çfarë nënkupton neni 42 i Kushtetutës me proces të rregullt gjyqësor?

Ky është një problem që meriton vëmendje të veçantë, sidomos në përvojën shqiptare. Ai lidhet në mënyrë të posaçme me të drejtën e individëve, pasi ata mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm në lidhje me shkeljen e të drejtave të tyre për një proces të rregullt ligjor. Sipas nenit 42 rezulton se procesi i rregullt ligjor është atëherë kur arrihet:

1. gjykimi i drejtë dhe publik
2. gjykimi brenda afatit të arsyeshëm
3. gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj
4. gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme

E rëndësishme është që çështja të shqyrtohet publikisht. Kjo i përgjigjet faktit se, interesat e ligjshme nuk i përkasin vetëm palës në gjykim, por edhe publikut, me qëllim që të sigurohet besimi në administrimin e drejtësisë. Kështu, publiciteti i seancave gjyqësore përbën garanci për palën. Gjykimi publik është një parim i përgjithshëm. Megjithatë, ndodh që të ketë edhe përjashtime. Këto përjashtime janë sanksionuar shprehimisht nga ligji (Kodi i Procedurës Penale etj.). Zhvillimi i gjykimit me dyer të mbyllura bazohet në interesa të tilla si morali, rendi publik, siguria kombëtare, interesat

e të miturve ose mbrojtjes së jetës private të palëve. Zhvillimi i gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm, është një element tjetër thelbësor për një proces të rregullt ligjor. Ky kusht bëhet shumë i ndjeshëm sidomos në çështjet penale. Afati kohor ndryshon nga fakti nëse kemi të bëjmë me një çështje penale. Këtu merret parasysh kompleksiteti i çështjes, interesi i palëve etj. Gjykata që gjykon çështjen duhet të jetë e ligjshme. Kjo do të thotë se gjykimi do të zhvillohet në të gjitha shkallët nga gjykata kompetente. Ndërtimi i sistemit gjyqësor është i parashikuar në Kushtetutë. Kushtetuta e ndalon shprehimisht krijimin e gjykatave të jashtëzakonshme. Gjithashtu, Kushtetuta përmend një varg elementesh për të pasur një gjykatë të pavarur e të paanshme. Pavarësia e organit gjyqësor që gjykon çështjen, varet nga disa faktorë. Sidoqoftë, ndarja e pushteteve, është garancia më e madhe e saj. Edhe për paanshmërinë, elementet janë të shumtë, por jepen mundësi të barabarta për të paraqitur çështjen. Asnjëra prej tyre nuk mund të gëzojë privilegje në krahasim me palën tjetër dhe anasjelltas asnjëra prej tyre nuk mund të diskriminohet. Përveç sa më sipër, një sërë nenesh të tjera të Kushtetutës që garantojnë të drejtat e qytetarit në përgjithësi, si dhe të drejtat e individit në procesin penal, lidhen drejtpërdrejt me të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor (e drejta për tu mbrojtur vet ose me anën e një mbrojtësi ligjor, e drejta për të pasur kohën dhe lehtësinë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e vet). Kështu ato mund të bëhen padyshim objekt gjykimi nga Gjykata jonë Kushtetuese, kur kjo e fundit merr në shqyrtim kërkesat e individëve për një proces të rregullt ligjor.

Procesi substancial ka rëndësi sa i takon gjyqimit lidhur me masat ndërhyrëse të shtetit në fushën e lirisë (*fairness of rules and rule making*). Krahas këndvështrimit evolutiv të të drejtave themelore dhe rëndësisë që merr thelbi i procesit të rregullt në tërësi, paraqitet jo më pak tërheqës edhe aspekti procedural i tij. Në aspektin procedural

të procesit të rregullt rëndësi të veçantë marrin kriteret sipas të cilave zbatohen në praktikë rregullimet e organeve shtetërore (*fairness of adjudication*) (Rubin, 1984). Në aspektin procedural, GJL konstaton nëse ndodhet para ndonjë ndërhyrje në jetën, lirinë ose pronën dhe më pas kufizohet tek kontrolli i aktit që ka shkaktuar cenimin e së drejtës, pra nëse ai ka qenë apo jo në përputhje me kërkesat e procesit të rregullt. Kushtetuta amerikanë ka marrë një rëndësi të madhe pikërisht nga interpretimi dhe mënyra e zbatimit të dispozitave lidhur me garancitë procedurale. Nga 23 të drejta që përmban Bill of Rights 12 prej tyre janë garanci procedurale. Megjithëse në to trajtohen hollësisht dhe specifikisht garanci që lidhen me përmbajtjen e nenit 5 të Kushtetutës, GJL i ka interpretuar këto norma jo vetëm specifikisht duke i lidhur me personin dhe çështjen konkrete, por në një masë të madhe edhe nga pikëpamja strukturore duke i lidhur ato me mënyrën se si duhet të zhvillohet një proces penal në gjykatat amerikanë.

Nëse do të gjykonim mbi qëndrimin e GJL në dekada mund të thuhet se ajo ka qenë e larmishme. Kështu, gjatë viteve '60-të ajo ka mbajtur një qëndrim aktiv, i cili është komentuar edhe si konstitucionalizmi i procesit penal. Në vitet '70-të dhe '80-të zgjerimi i garancive procedurale pësoi një ngadalësim, pati vetëm kozmetikë të kujdesshme të tyre ose interpretim të moderuar. Ky ndryshim në literaturë i dedikohet edhe përbërjes së GJL, e cila u dha më shumë pas ndarjes institucionale midis gjyqësorit dhe aktivizimit politik. Gjithashtu, ajo pati dhe një prirje për të interpretuar gjerësisht parimin e federalizmit, duke theksuar se e drejta penale dhe procedurale penale është çështje e shteteve anëtarë të federatës dhe ajo nuk mund të ndërhyjë në mënyrën se si gjykatat e shteteve i interpretojnë normat përkatëse.

KAPITULLI V: ZHVILLIMI I PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE SIPAS PRAKTIKËS TË GJYKATAVE TË HUAJA

5.1. Ndryshimi në vite i kuptimit dhe zbatimit të procesit të rregullt ligjor

Përpara se të ndalemi hollësisht në kuptimin në tërësi dhe elementët e veçantë të procesit të rregullt ligjor sipas praktikës së GJK shqiptare, vlen t'i kushtojmë vëmendje edhe zhvillimit historik të ankimit kushtetues individual në Shqipëri për të pasur një përjasje më të plotë sa i takon vendimmarrjes së kësaj Gjykate në vite.

Për këtë arsye, më poshtë do të paraqesim dy faza të rëndësishme të zhvillimit të ankimit kushtetues shqiptar:

Faza e parë është ajo e viteve 1992-1998, gjatë së cilës gjeti zbatim ankimi kushtetues real sipas modelit gjerman, pra individ kishte të drejtë t'i drejtohej GJK për kundërshtimin e akteve të pushtetit publik (qeveri, parlament, gjykatë), nëse i cenoheshin të drejtat e tij të parashikuara në paketën kushtetuese.

Faza e dytë i referohet viteve pas miratimit të Kushtetutës në fuqi, pra pas 1998 e në vazhdim. Kjo fazë njihet si faza e ankimit kushtetues të kufizuar, pasi ankimet individuale mund të drejtohen kryesisht kundër vendime gjyqësore dhe në raste mjaft specifike edhe ndaj akteve të tjera të pushtetit publik, kur pretendohet se cenohet e drejta për proces të rregullt ligjor dhe individ nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj aktit (Zaganjori, Anastasi, Eralda Çani, 2011: 88).

Pas ndryshimeve demokratike të fillimit të viteve '90-të, si në të gjitha vendet e Evropës Lindore, edhe në Shqipëri lindi nevoja për të përshtatur kuadrin kushtetues dhe ligjor me marrëdhëniet e reja shoqërore të krijuara. Duke qenë se Kushtetuta e deri atëherëshme nuk mund të gjente më zbatim në regjimin e ri pluralist të vendosur me zgjedhjet e para demokratike të vitit 1992, vendin e ligjit themelor e zuri përkohësisht

Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese (DKK) (Ligji nr.7491, dt.29.04.1991 dhe Ligji nr.7561, dt.29.04.1992 Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, dt.29.04.1991), një nga të rejat që solli kjo paketë kushtetuese ishte dhe krijimi i një institucioni të ri për rendin juridike shqiptar, Gjykatën kushtetuese, funksionimi i të cilit do të kishte ndikim të rëndësishëm për shtetin e brishtë demokratik që po ngrihej në fillimet e viteve '90-të (Vorpsi (Palushi), 2001: 36). Ky organ i panjohur më parë në Shqipëri, por me mjaft përvojë në vendet e Evropës perëndimore, u konceptua në bazë të shembullit të gjykatave kushtetuese të vendeve gjermanofolëse, ku edhe lindi e ideja të krijimit të këtij institucioni (Ideja e krijimit të një organi që të mbikëqyrë respektimin e Kushtetutës nga të gjitha organet e administratës publike është hedhur për herë të parë nga konstitucionalisti austriak Hans Kelsen në 1868), ide e cila gjeti zbatim të plotë në Austri në 1920. Kelsen ka qenë nënkryetar i kësaj gjykate deri në vitin 1939, kohë në të cilën ai dha dorëheqjen, pas vendosjes së Anschluss-it mes Gjermanisë dhe Austrisë nga regjimi nacionalsocialist. Në këtë periudhë ai emigroi në SHBA, ku dha kontributin e tij në fushën e së drejtës kushtetuese dhe të së drejtës ndërkombëtare deri në fund të jetës së tij, kështu, GJK gëzonte të njëjtat kompetenca të gjera si ajo gjermane duke filluar që nga interpretimi i dispozitave kushtetuese e deri në kontrollin e akteve normative mbi bazën e ankimit individual. Vitet e para të funksionimit të GJK kanë qenë më të vështira përse i takon ushtrimit të kompetencave të saj, sidomos ato lidhur me shqyrtimin e ankimeve individuale. Pavarësisht se institucioni i GJK ishte i ri, ai gjeti një mbështetje tek shtetasit, duke qenë se kishin kaluar një përvojë negative nga periudha e regjimit komunist. Ky regjim, pavarësisht nga parashikimet kushtetuese dhe propagandës, nuk respektonte në realitet liritë dhe të drejtat e qytetarëve, ato kishin karakter thjesht deklarativ.

Për këtë arsye, qytetarët shqiptarë që në fillimet e punës së GJK panë tek ajo një mbrojtëse reale të të drejtave të tyre edhe kur ato shkeleshin nga organet më të larta të pushtetit shtetëror. Që në fillim të bën përshtypje përpjekja e këtij organi për t'u shprehur lidhur me parimet kushtetuese themelore, si parimi i ndarjes së pushteteve (Vendime të GJK nr.5/1992; nr.6/1992; nr.11/1992; nr.4/1994; nr.8/1994; nr.9/1995), i papajftueshmërisë së funksioneve (Vendime të GJK nr.3/1992; nr.5/1992), i pavarësisë së gjyqësorit, lirisë së shtypit, (Vendim i GJK nr.2/1992) të drejtës për informim (Vendime të GJK nr.10/1992; nr.4/1993), etj.

Në 28 Nëntor 1998 u dekretua Kushtetuta e re e Republikës së Shqipërisë, e konsideruar edhe si e para Kushtetutë realisht demokratike pas Luftës së Dytë Botërore. Ndryshimet dhe të rejat që solli ky dokument u pasqyruan edhe në sferën e kompetencave të GJK. Më të ndjeshme këto ndryshime ishin lidhur me të drejtën e individit për të vënë në lëvizje GJK dhe kompetencën e kësaj të fundit për të shqyrtuar brenda një hapsire më të kufizuar ankimin individual (Debati Kushtetues, 2006: .26-35). Kështu, sipas kuadrit kushtetues në fuqi, GJK, veç të tjerave, është kompetente të shqyrtojë ankimet kushtetuese individuale, të cilat mbështeten në pretendimet për shkelje të të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në mënyrë të natyrshme, kjo është bërë një nga kompetencat më të rëndësishme të këtij institucioni. Për këtë fakt flasin edhe statistikat e botuara nga vetë GJK. Megjithëse numri i ankimeve kushtetuese individuale ka zënë dhe zë që prej krijimit të Gjykatës pjesën më të madhe të kërkesave në total, përqindja e kërkesave të kaluara në seancë gjyqësore dhe i atyre të pranuar me vendim përfundimtar është i vogël varion nga 5%-15%. Vetë këto shifra flasin për të kundërtën e asaj që pretendohet se GJK po kthehet në shkallë të katërt të gjykimit. Ky nuk është aspak qëllim i kësaj Gjykate, por ajo vetë si organ kushtetues, garant dhe

interpretuese përfundimtare e ligjit themelor të shtetit, jo vetëm ka për detyrë të veprojë brenda kuadrit kushtetues që i ka caktuar ligjvënësi por edhe të mbikëqyrë organet e tjera kushtetuese në këtë aspekt. Vlen të theksohet se ushtrimi i kësaj kompetence nga GJK ka sjellë në disa raste vënien në vend të së drejtës së shkelur të individit nga organet e administratës publike duke realizuar kështu qëllimin e ligjvënësit për respektimin e të drejtave të individit. Konstatimi i shkeljeve nëpërmjet akteve të pushtetit shtetëror nuk mund të kalohet në heshtje nga organi që ka për detyrë t'i kontrollojë ato, me pretendimin se sistemi gjyqësor shqiptar njih vetëm tri shkallë gjykimi. Kushtetuta dhe ligji për GJK përcakton qartë rastet, kur kjo Gjykatë është kompetente të marrë në shqyrtim ankimet kushtetuese individuale. GJK është përpjekur që pas miratimit të Kushtetutës së re të përkufizojë hap pas hapi këtë kompetencë duke vijëzuar kështu gjatë praktikës caqet e interpretimit dhe të kontrollit të saj.

Qëndrimet e mbajtura në praktikën e kësaj Gjykate kanë çuar në një kuptim më të drejtë dhe më përfshirës të nocionit kushtetues të procesit të rregullt ligjor (Sadushi, 2004, 182). Në tërësi, sot mund të themi se hapësira e kontrollit të GJK për shqyrtimin e ankimeve kushtetuese individuale ka ardhur duke u zgjeruar.

5.1.1. Kuptimi i procesit të rregullt sipas GJEDNJ

Në këtë nënçështje do të fokusohemi më shumë në drejtim të hapësirës që parashikon KEDNJ, e konkretizuar nga praktika e GJEDNJ, lidhur me procesin e rregullt pa u ndalur në të drejta të veçanta për shkak të përfshirjes në masë të madhe të praktikës së GJEDNJ në jurisprudencën e GJK shqiptare, e cila do të vijë e elaboruar sipas tematikës më poshtë.

Hartuesit e Konventës Europiane, kur kanë parashikuar të drejtat themelore, kanë pasur si qëllim që interpretimi i termave dhe koncepteve të përfshira në të të jetë

autonom nga përkufizimi që mund t'i jepet atyre nga legjislacionet ose organet kompetente të shteteve anëtare (Froëin, Peukert, 1996: 5). Nëse çdo shtet palë në Konventë do t'i interpretonte në mënyrë autonome konceptet e papërcaktuara në mënyrë të shprehur ose shteruese të Konventës, atëherë çdo shtet do të përcaktonte vetë shkallën e detyrimit që i lind atij nga zbatimi i saj. Kjo do të çonte një praktikë të ndryshme dhe të paparashikueshme si nga shtetet ashtu edhe nga GJEDNJ, çka do të sillte mospasjen e një standardi (minimal ose maksimal) të mbrojtjes ose të kufizimeve të të drejtave të garantuara nga Konventa. Kjo do të ndikonte në efektin real që do të kishte Konventa dhe vetë jurisprudenca e GJEDNJ. Në këtë kuadër duhet parë edhe standardi i procesit të rregullt, garantuar kryesisht nga neni 6 i KEDNJ. Organet e krijuara nga KEDNJ janë përpjekur mjaft të japin një përkufizim uniform ose evropian të hapësirës mbrojtëse të nenit 6, i cili përputhet (pjesërisht) në formulim me përmbajtjen e nenit 42 të Kushtetutës sonë. Megjithatë, GJEDNJ nuk ka arritur të japë një definicion përfundimtar dhe gjithëpërfshirës të hapësirës së kontrollit të nenit 6. Ajo e filloi përpjekjen me çështjen Ringeisen (Çështja Ringeisen kundër Austrisë, 22 qershor 1972) dhe deri sot, megjithatë zinxhirin e gjatë të vendimeve të saj, ajo i ka përfshirë garancitë e kësaj dispozite rast pas rasti duke i dhënë një mbrojtje të konsiderueshme individit nga veprimet e administratës publike. Në çështjen Ringeisen, Gjykata theksoi se për të vendimmarrja në një çështje nuk varet nga fakti se cila degë e gjyqësorit ka vendosur mbi një çështje/mosmarrëveshje, por varet nga karakteri i të drejtës që cenohet. Vlen të ndalemi pak më gjatë në këtë çështje për të kuptuar drejt interpretimin e GJEDNJ sa i takon kompetencës së saj për të përfshirë në hapësirën e nenit 6/1 të KEDNJ çështje të natyrave të ndryshme.

Neni 6 i KEDNJ zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo Konventë. Ndërsa neni 6/2 dhe 6/3 përmban dispozita specifike që vendosin minimumin e të drejtave që duhen respektuar gjatë procesit penal. Neni 6 është dispozita më e përdorur nga kërkuesit që i drejtohen GJEDNJ. Megjithatë mjaft elementë përbërës të kësaj dispozite janë konceptuar si autonome dhe si të tilla kanë shtruar nevojën e interpretimit të gjerë nga GJEDNJ.

Vlen të theksohet se, pavarësisht vendimit që ajo jep, Gjykata nuk ka kompetencë të urdhërojë rihapjen e proceseve gjyqësore për shkak të shkeljeve që ajo mund të konstatojë se janë bërë gjatë procesit.

Detyra e Gjykatës duke u mbështetur në kërkesat e nenit 6 është të ekzaminojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i drejtë dhe i pajtueshëm me garancitë specifike të mbrojtura nga Konventa. Ndryshe nga një gjykatë apeli kombëtare, Gjykatës nuk i interesojnë çështjet lidhur me faktin nëse dënimi ka qenë i drejtë apo vendimi ishte i përshtatshëm, dëmshpërblimi i dhënë nga gjykatat kombëtare ka qenë në përputhje me ligjin e brendshëm etj. Gjithashtu, vendimi i GJEDNJ për mospërmbylljen e standardeve të nenit 6 nga gjykatat vendase nuk sjell shfuqizimin e vendimeve të këtyre të fundit, pra nuk bën të pavlefshëm vendimin e fajësisë ose ndryshimin e vendimit.

GJEDNJ e quan këtë si respektim të parimit të mosqenies “shkallë e katërt” duke theksuar se ajo nuk duhet parë si instancë e tretë ose e katërt ankimi ndaj gjykatave kombëtare, por thjesht si një riparuese e të drejtave të cenuara me mjetët që ofrojnë vetë legjislacionet kombëtare duke u rekomanduar atyre zgjidhjen më të mirë në rastin konkret (Ovey, Ëhite, 2006: 159). Pajtueshmëria e vendimeve gjyqësore me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ nuk do të thotë se kjo dispozitë mund të zbatohet e vetme dhe pa u kombinuar me të drejta të tjera të Konventës. Madje disa prej standardeve të procesit të

drejtë janë vendosur nga praktika e gjerë e GJEDNJ, pavarësisht se nuk janë parashikuar shprehimisht në dispozitat e Konventës. Praktika e organeve të Konventës (Gjykata dhe Komisioni, për aq kohë sa ky i fundit funksionoi) kanë ndjekur linjën e një zgjerimi të vazhdueshëm të hapësirës së veprimit të nenit 6 të KEDNJ.

Lidhur me pretendimet për proces të parregullt ligjor para institucioneve kombëtare, GJEDNJ mund t'i drejtohen shtetet palë, persona fizikë dhe juridikë. Sipas GJEDNJ, individë konsiderohen personat fizikë dhe juridikë. Ata mund t'i drejtohen GJEDNJ vetëm nëse dëshmojnë se kanë qenë drejtpërdrejt dhe personalisht të dëmtuar nga veprimi ose mosveprimi i administratës publike të shtetit konkret. Ankimi popullor nuk pranohet. Koncepti i të dëmtuarit në Konventë ka një kuptim autonom që i nënshtrohet një interpretimi të pavarur nga dispozitat e brendshme që lidhen me interesin juridik ose me zotësinë juridike për të vepruar. Sipas Konventës, i dëmtuar do të konsiderohet ai person që është realisht i cenuar nga veprimi ose mosveprimi që përbën shkelje sipas vetë Konventës (*actual victim*) (Çështja Andronicou dhe Constantinou kundër Qipros, 5 korrik 1995).

Megjithatë i dëmtuar quhet edhe personi, i cili ka shkaqe serioze dhe të arsyeshme të besojë se në çdo rast mund të bëhet viktimë e shkeljes së Konventës (*potential victim*). Kjo ndodh kur, në rrethana të caktuara, ai gjendet në rrezën e veprimeve që janë në kundërshtim me Konventën ose të praktikave të ngjashme të organeve qeveritare. Mbi këtë bazë p.sh një grua ka mundësi t'i kundërshtojë dispozitat ligjore që ndalojnë abortin, nëse mendon se kjo përbën ndërhyrje në jetën e saj private ose familjare që nuk pajtohet me Konventën.

I dëmtuar në këtë aspekt për shkak të legjislacionit kundër abortit mund të jetë edhe bashkëshorti ose partneri i gruas. Në çështjen H K. Norvegjisë, Komisioni cilësoi se babai i ardhshëm është kaq i rrezikuar nga mundësitë ligjore të ndërprerjes së shtatzënisë nga ana e gruas, saqë mund të konsiderohet si i dëmtuar.

5.1.2. Kuptimi i procesit të rregullt ligjor sipas Gjykatës së Lartë Amerikane

Procesi amerikan kur kemi të bëjmë me çështje penale, paraqet në një masë të madhe, karakteristikat e të ashtuquajturit proces akuzues (*adversary*). Sikurse në procesin anglez, ekziston një ndarje e qartë ndërmjet fazës paraprake dhe asaj procesuale, domethënë debatit. Procesi penal i ngjason dhe i përshtatet modelit akuzator. Në procesin penal, pozita e prokurorit është mjaft e fortë, për shkak të mundësisë së tij për të kontrolluar burime të ndryshme strategjike, e veçanërisht ato të natyrës gjurmuese. Fakti, që vetëm një pjesë e vogël e çështjeve arrin në debat, i detyrohet praktikës, tashmë të zyrtarizuar të ujdisë (plea bargaining), që do të thotë se rreth 90% të rasteve, akuza dhe mbrojtja arrijnë në një marrëveshje, sipas së cilës i akuzuari pranon përgjegjësinë e tij dhe mbrojtja arrin një marrëveshje, sipas së cilës i akuzuari pranon përgjegjësinë e tij dhe menjë dënim të ulur ose shpallet fajtor për një faj më të vogël. Është me rëndësi që kjo procedurë, faktikisht, kontrollohet nga prokurori.

Gjykatësi ndërhyt vetëm më pas, për të verifikuar nëse janë respektuar të drejtat e të akuzuarit, edhe pse shpeshherë duket se kufizohet me ratifikimin e marrëveshjes së arritur nga palët, pa hyrë në thelb. Mirëpo, nuk duhet harruar faktin se kufizimi i lirisë personale përpara vendimit, kërkon vendimin e një gjykatësi, që është kompetent, e në disa raste vendimin e rrëzon juria e posaçme. Nëse nuk mund të arrihet marrëveshja me

të akuzuarin, prokurori është i detyruar t'i normalizojë pikat e akuzës përpara një gjykatësi, i cili do të vendosë ta dërgojë apo mos ta dërgojë çështjen në gjykim. Në SHBA ekziston prirja që roli i jurisë të zvogëlohet. Procesi zhvillohet sipas një procedure që i afrohet modelit akuzues, dhe gjykatësi dhe juria janë aktorë pasiv në krahasim me palët në çështje. Palët e mbajnë gjithmonë kontrollin e procedurës, duke shtruar pyetje dhe duke i kundër pyetur dëshmitarët.

Në këtë pjesë do të ndalemi shkurt tek specifikat kryesore që paraqet ankimi individual në sistemin anglosakson, konkretisht sipas Kushtetutësë SHBA-ve si vendi më tipik përfaqësues i këtij sistemi. Amendamenti i 5-të i Kushtetutësë SHBA-së parashikon se *“askujt nuk mund t'i kufizohet e drejta e jetës, liria ose prona pa një proces të drejtë (rregullt) ligjor...”* (Për qëllimet e këtij botimi do të përdoret termi “proces i rregullt” edhe për ankimin individual amerikan, megjithëse në botime të ndryshme të gjuhës shqipe gjen përshtatje të tilla si “proces i drejtë”). Kushtetuta amerikane nuk përmban në fakt asnjë përkufizim të termit “proces i rregullt”, megjithatë praktika e pasur e gjykatave amerikanë, sidomos e Gjykatës së Lartë (më poshtë: GJL), ka bërë që të ketë një formulim të përgjithshëm të tij. Është tashmë praktikë e vendosur e kësaj Gjykate që klauzola e procesit të rregullt i referohet një sistemi të të drejtave bazuar:

“në parime morale që i kanë rrënjët aq thellë në traditat dhe ndjenjat e popullit amerikanë saqë mund të konsiderohen vërtetë themelore për një shoqëri të civilizuar siç është ajo amerikanë, e krijuar gjatë gjithë historisë së këtij populli. Procesi i rregullt është ai që nuk bie ndesh dhe zhvillohet sipas të gjitha elementëve përbërës të asaj që konsiderohet si e drejtë (fair, right and just)” (Çështja Solesbee kundër Balkcom, 339 U.S. 9 (1950)).

Procesi i rregullt amerikan nuk kufizohet vetëm në respektimin e rregullave procedurale. GJL Amerikane i ka dhënë këtij koncepti një kuptim mjaft të gjerë. Ajo ka

theksuar se tek procesi i rregullt duhen gjetur dy anë të mbrojtjes së tij: ajo *substantiale* dhe *procedurale*. Procesi i rregullt *substancial* shtrihet ndaj akteve të ekzekutivit që ndërhyjnë/cenojnë të drejta të tilla si: prona, liria ose jeta. Ndërsa aspekti *procedural* i procesit të rregullt ka të bëjë me procedurat që ndjek qeveria sa herë që kufizon të drejta të tilla si jeta, prona dhe liria.

Sa herë që GJL Amerikane shprehet për të drejta të tilla si: jeta, liria ose prona, ajo bën trajtim substancial të procesit të rregullt. Ky interpretim i shërben asaj për ngritur në nivel kushtetues edhe ato elementë që nuk parashikohen direkt nga teksti i Kushtetutës . Gjithashtu, interpretimi i nevojitet GJL për të bërë të ashtuquajturin *strict scrutiny test* të ndërhyrjes shtetërore në të drejtat themelore. GJL tregohet e kujdesshme dhe e përmbajtur në praktikën e saj lidhur me shqyrtimin substancial të procesit të rregullt. Elementë të rëndësishëm ku mbështetet Gjykata gjatë gjykimit të saj janë kryesisht: (1) koncepti i garantimit implicit të së drejtës; (2) roli i traditës; (3) rëndësia e precedentëve kushtetues; (4) zgjerimi i konceptit kushtetues të lirisë në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Përballë këtyre katër elementëve kuptimi modern i procesit të rregullt ka evoluar, duke u fokusuar më së shumti në karakterin thelbësor që kanë interesat individuale. Kështu, në një çështje ku bëhej fjalë për ndalimin e mësimit të gjuhës së huaj në disa shkolla të caktuara, ajo ka argumentuar se “...pa dyshim që liria nuk përfshin lirinë e individit vetëm në aspektin trupor të tij; liria përfshin edhe të drejtën e individit të veprojë lirisht, të angazhohet në aktivitete që ai dëshiron me qëllim përfitimin e dijeve të nevojshme, lirinë për t’u martuar, për të ngritur familje dhe për të rritur fëmijë, lirinë për të nderuar Zotin, sipas urdhërimeve të tij dhe ndërgjegjes së individit, dhe në përgjithësi të gëzojë ato privilegje që në sistemin e së drejtës zakonore (*common law*) prej kohësh konsiderohen si të domosdoshme për gëzimin e një jete prej

njeriu të lirë” (Vendimi i Gjykatës së Lartë të SHBA, Mayer kundër Nebraskas, 262 U.S 390, 399 (1923)).

Me pak fjalë, kontrolli do të konsiderohet substancial kur, GJL, për të arritur në përfundimin nëse ka shkelje të një të drejtë themelore, kontrollon të gjithë procesin e vendimmarrjes përfshi edhe atë politik. Kriteret e kontrollit për GJL janë të drejtat themelore të garantuara nga Kushtetua e SHBA-së, por gjithashtu edhe të drejta të tjera që në praktikën e asaj Gjykate janë konsideruar si pjesë e jetës, lirisë dhe pronës (Brugger, 1997: 44). Rëndësi të veçantë sa i takon termit “liri” garantuar nga neni 5 dhe 14 i Kushtetutës së SHBA-së ka interpretimi substancial i procesit të rregullt (substantive due procesi). Ai përfshin shpalosjen private, ekonomike, politike, kulturore dhe fetare të personalitetit të njeriut. Në një kuptim tjetër të aspektit substancial të procesit të rregullt mund të thuhet se, ka dhe një trajtim që lidhet me vlerat kushtetuese, të cilat kanë prioritet sa i takon të drejtave themelore që lidhen me demokracinë.

Duke qenë se interpretimi i lirisë, barazisë, drejtësisë si vlera kushtetuese janë të diskutueshme dhe nuk mund të vlerësohen gjithmonë objektivisht, atëherë edhe interpretimi i Kushtetutës duhet të shkojë drejt konkretizimit të këtyre vlerave. Kontrolli kushtetues, i parë në këtë këndvështrim, ka për detyrë të mbrojë procesin demokratik dhe jo të kontrollojë përmbajtjen e rezultateve të këtij procesi. Termi “substancial” mund të shtrihet ndaj peshës së interesit publik, balancës midis qëllimit dhe mjetit si dhe në përgjithësi ndaj aspektit të rëndësisë, nevojës dhe përshtatshmërisë së ndërhyrjes. GJL ka aplikuar dy metoda të ndryshme lidhur me interpretimin modern të procesit të rregullt: e para është konservative/e përmbajtur, e dyta është aktiviste/ liberale (Brugger,2010: 143).

Mënyra e trajtimit të aspektit substancial të procesit të rregullt është kritikuar mjaft sa i takon faktit se GJL mbron të drejta që nuk janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë ose nuk përputhen me vullnetin e hartuesve të saj. Kritika janë drejtuar edhe sa i takon mënyrës së arsyetimit të GJL lidhur me procesin e rregullt. Në historinë moderne të GJL amerikanë ka pasur dy linja kryesore të procesit substancial. Më herët, në vitet '30-të, Gjykata e përdori këtë aspekt për të mbrojtur liritë ekonomike sidomos lirinë kontraktuale si një të drejtë themelore. Në çështjen *Lochner kundër New York*, GJL deklaroi si antikushtetues ligjin që parashikonte se sa orë duhej të punonte një bukëpjekës, duke mos dhënë ndonjë shpjegim se përse kjo kishte lidhje me nenin 5 të Kushtetutës (Vendim i Gjykatës së Lartë *Lochner kundër New York*, 198 U.S. 45 (1905)).

Në periudhën më të vonshme procesi substancial është përdorur për të mbrojtur të drejtën e privatësisë dhe autonominë personale. Çështja *Roe kundër Wade*, e cila u bë shkak për legalizimin e abortit, është një nga më të famshmet e kohës dhe një nga çështjet më të rëndësishme të procesit substancial, pasi vendimi në këtë çështje u mbështet mbi autonominë vendimmarrëse të nënës lidhur me abortin (Vendim i Gjykatës së Lartë, *Roe kundër Wades*, 410 U.S. 113 (1973)).

Nga ana tjetër, mbrojtësit e aspektit substancial të procesit të rregullt i referohen nevojës për mbrojtje që ka individit nga aktet e ligjvënësit. Në këtë linjë edhe vetë GJL Amerikane, më shumë se një shekull më parë, ka deklaruar se procesi i rregullt “është një kufizim për ligjvënësin, për ekzekutivin dhe gjyqësorin dhe nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që t’i krijojë mundësinë Kongresit të miratojë akte sipas vullnetit dhe dëshirës së tij” (Vendim i Gjykatës së Lartë, *Murray’s Lessee kundër Hoboken Land & Improv.Co.* 59 U.S. 272 (1856)).

Klauzola e procesit të rregullt ligjor përfshin dispozita të Bill of Rights që konsiderohen themelore si dhe elementë të tjerë që nevojiten për t'i garantuar të drejtat e parashikuara në këtë katalog. Ky është procesi substancial: pra, përdorimi i të drejtave procedurale për të mbrojtur të drejta material (Chemmerinsky, 2006: 548).

Procesi i rregullt është një koncept i së drejtës kushtetuese që përfshin dy rrafshë: GJL Amerikane i referohet kuptimit përmbajtjesor, material, të procesit të rregullt me qëllim që të drejtat që nuk janë parashikuar specifikisht në Kushtetutë t'i përfshijë në thelbin e lirisë, e cila nuk mund të kufizohet pa iu nënshtruar procesit të rregullt (Vorpsi, 2011).

Jurisprudenca e GJL Amerikane është zhvilluar kryesisht në dy drejtime:

Së pari, GJL ka pasur tendencë ta shtrijë interpretimin e procesit të rregullt të garantuar nga neni 14 i Kushtetutës edhe ndaj shteteve federale, gjë e cila, nuk solli ndonjë unifikim të praktikës gjyqësore prej tyre.

Së dyti, GJL ka bërë një interpretim të zgjeruar të garancive procedurale gjë që ka çuar në një ndryshim rrënjësor të procedurës penale.

Kështu, si elementë të procesit të rregullt nga këndvështrimi i praktikës së GJL mund të përmendim: (1) njoftimi i menjëhershëm i shtetasit për masat që kufizojnë jetën, pronën ose lirinë e tij; (2) përcaktimi i organit kompetent për shqyrtimin e ankesave; (3) zhvillimi i seancës dëgjimore ose parashikimi i mundësisë për t'u shprehur me shkrim; (4) zgjedhja e një mbrojtësi; (5) mundësia për të thirrur dëshmitarë dhe për të paraqitur prova ose për të pyetur dëshmitarët e thirrur nga pala kundërshtare; (6) dhënia e një vendimi të arsyetuar bazuar në aktet e paraqitura në seancë; (7) e drejta e mbrojtjes; (Çështja Powell k. Alabamës, 287 U.S 45 (1932), cilësohet si një nga

vendimet ku GJL është përballur me nevojën për të interpretuar të drejtën e mbrojtjes në të gjitha proceset penale; Johnson kundër Zerst, 304 U.S 458 (1938); Scott k. Illinois, 440 U.S> 367 (1979)) (8) e drejta për të mos dëshmuar kundër vetes; (Çështja Bram kundër United States, 168 U.S. 532 (1987).) (9) ndalimi i dënimeve çnjerëzore dhe të pazakonta; (10) e drejta për t'u gjykuar nga një juri/gjykatë; (11) e drejta për të mos u dënuar dy herë për të njëjtën vepër (Hames, Ekern, 2005: 256).

Pra, në përgjithësi garancitë procedurale që garantohen nga neni 5 dhe 14 i Kushtetutës amerikane, janë të ngjashme me garancitë e nenit 6 të KEDNJ dhe nenin 42 të Kushtetutës shqiptare, e elaboruar në praktikë të vazhdueshme nga GJK (Alstynne, 1977).

5.2. Procesi i rregullt ligjor sipas Sistemit Gjyqësor në Gjermani

Rregullimi federativ i shtetit gjerman, që pas ribashkimit me Gjermaninë Lindore numëron 16 Lande, pasqyrohet edhe në sistemin gjyqësor, por duke i dhënë vend një përvijimi organizativ të ndryshëm nga ai i Shteteve të Bashkuara. Përveç kësaj, në mënyrë të ngjashme me vendet e tjera kontinentale, juridiksioni është i ndarë në nënsisteme të veçanta. Në Gjermani gjykata të larta janë vetëm ato federale, të vendosura në majë të secilës piramidë juridiksionale dhe kompetenca e tyre shtrihet në tërë territorin. Gjykatat në Gjermani ndahen varësisht nga çështjet që i shqyrtojnë. Ato janë të ndara në: Gjykala e zakonshme, në kuadër të së cilës hyjnë, Gjykata e Lartë Federale, e ndarë në seksionin civil dhe penal. Gjykata e Apelit të shteteve e cila ndahet në seksionin civil, penal dhe të të miturve, Gjykatat e shteteve-juridiksioni i përgjithshëm, si dhe Gjykatat e shteteve-juridiksioni i kufizuar. Gjykata administrative-në kuadër të së cilës hyjnë: Gjykata e Lartë administrative, Gjykata e Apelit administrativ dhe Gjykatat administrative.

Gjykata e financave- Gjykata e Lartë e financave dhe Gjykata e financave. Gjykata e punës- Gjykata e Lartë e punës, Gjykata e apelit të punës dhe Gjykata e punës. Gjykata e sigurimit shoqëror, Gjykata e Lartë e sigurimit shoqëror, Gjykata e apelit të sigurimit shoqëror dhe Gjykata e sigurimit shoqëror.

Procesi gjyqësor në Gjermani; Nisma penale ushtrohet nga prokurori mbi bazën e parimit të detyrueshmërisë. Në fakt, mundësia e nismës penale u fut për herë të parë më 1924, e cila u zgjerua në mënyrë të ndjeshme me reformën e vitit 1975 që më vonë u zgjerua edhe më tepër. Prokurori duhet t'i shqyrtojë të gjitha njoftimet për krime të transmetuara nga policia dhe ta ushtrojë veprimin penal. Duke lënë me një anë faktin se barra e provës bie mbi prokurorin, të cilit i takon të provojë se akuza është e bazuar.

Në Gjermani roli i gjyqtarit është i madh, sepse ky gëzon të drejtën që të drejtojë një procedim që ka për qëllim kërkimin autoritar të së vërtetës. Më 1975 u hoq gjykatësi hetues, tek cili përqendroheshin kompetenca dikur hetimore. Sot, këto vendime i kanë kaluar një gjykatësi të specializuar Ermittlungsrichter. Sa i përket fazës së ballafaqimit, dëgjimi i dëshmitarëve është një e drejtë e mbrojtjes, e cila zhvillohet me një teknikë *cross examination* e ashtuquajtur-shqyrtimi i kryqëzuar, që i lë një hapësirë më të gjerë avokatit.

Gjykata Kushtetuese Federale; Gjykata Kushtetuese Federale është institucion tjetër shtetëror (e përbërë nga 2 kolegje). Rregullimi i drejtësisë së zakonshme, ndonëse disi i ndërlikuar, në vijat e veta të përgjithshme nuk ndryshon në thelb, nga ai i sistemeve të tjera kontinentale. Gjykata Kushtetuese Federale ka zhvilluar gjatë afro 60 viteve të ekzistencës së saj një jurisprudencë të shkëlqyer para së gjithash në drejtim të drejtës institucionale shtetërore dhe veçanërisht në fushën e të drejtave themelore duke e kthyer këtë organ në një aktor të respektuar mes organeve shtetërore në

Republikën Federale të Gjermanisë. Ajo e ka ndërtuar dhe ndikuar jetën politike dhe shoqërore në Gjermani si asnjë institucion tjetër. Mes shtetasve gjermanë Gjykata Kushtetuese Federale gëzon respekt dhe vlerësim të lartë. Kjo në një masë të madhe shpjegohet edhe nga ekzistenca e ankimit kushtetues individual, i cili me disa dallime bën pjesë edhe tek sfera e kompetencave të Gjykatave Kushtetuese të vendeve të tjera.

Funksioni i Gjykatës Kushtetuese Federale është për të interpretuar Kushtetutën gjermane, e cila si shumë kushtetuta të tjera në botë është e hapur, nuk është i lehtë.

Mbrojtja e Kushtetutës nuk është vetëm detyrë e Gjykatës Kushtetuese, megjithëse e fundit për shkak të Kushtetutës ka rol parësor si “Roje e Kushtetutës”. Mbrojtja e Kushtetutës dhe e të drejtave që ajo përmban është më shumë një detyrim që u drejtohet ligjvënësit dhe gjyqësorit, si edhe shtetasve në përgjithësi.

5.3. Procesi i rregullt ligjor në sistemin inkuizitor

Sistemi inkuizitor bazohet mbi “parimin e autoritetit”, sipas të cilit e vërteta pranohet më mirë kur i jepet më shumë autoritet subjektit që ushtron funksionin e dhënies së drejtësisë. Sipas këtij sistemi procedural te ky subjekt procedural përmblihen të gjitha funksionet procedurale, në të vepruarit si gjyqtar, si prokuror edhe si mbrojtës i të pandehurit. Në vijim të kësaj logjike, te një subjekt i vetëm procedural, duhet që të konsistojnë disa funksione procedurale, qoftë në marrjen e iniciativës për të filluar një proces gjyqësor, qoftë në drejtim të formimit dhe të vlerësimit të provave. Ky subjekt procedural që po flasim, i cili del në pah në mënyrë të veçantë në sistemin inkuizitor, ka pasur në vite emërtime të ndryshme, prej të cilave më i përdoruri është emërtimi “gjyqtar hetues”. Nuk është e rëndësishme nëse bëhet fjalë për një gjyqtar të vetëm apo për një trupë gjyqësore, por ajo që ka rëndësi është tërësia e kompetencave

procedurale që gëzon ky subjekt procedural në modelin e sistemit inkuizitor. Pra, përkrahësit e këtij sistemi procedural besojnë në bashkimin e funksioneve procedurale penale në një organ të vetëm dhe unik. Rrjedhimisht, sipas këtij sistemi procedural nuk i njihet asnjë kompetencë palëve të tjera në procesin penal, ku mbrojtësi dhe i pandehuri janë objekte të gjyqimit, ndërsa të gjitha kompetencat e tjera i përkasin gjyqtarit.

Duke u nisur nga parimi i bashkimit të kompetencave procedurale, që përshkruan sistemin procedural inkuizitor, arrihet që të dalin në pah disa karakteristike parësore të këtij sistemi procedural, siç janë;

- a) Iniciativa kryesisht. Iniciativa për fillimin e procesit penal i përket gjyqtarit hetues, është ai që duhet të vërtetojë të vërtetën dhe të drejtën, proces në të cilën palët janë inaktive,
- b) Iniciativa kryesisht për kërkimin dhe mbledhjen e provave. Gjyqtari hetues nuk pret iniciativën e palëve për të kërkuar dhe administruar provat që kanë rëndësi për çështjen penale, por gjyqtari hetues e ka kompetencën për të kryer vetë një veprim të tillë,
- c) Karakteri sekret i procesit. Gjyqtari hetues kërkon të vërtetën pa iu nënshtruar kontradiktoritetit dhe debatit mbi provat e palëve të tjera të procesit,
- d) Procesi është i shkruar, pra mungon oraliteti,
- e) Nuk ka kufizime lidhur me administrimin e provave, ajo që është e rëndësishme është rezultati që arrihet nga provat e marra, pra e vërteta, dhe nuk është e rëndësishme mënyra se si organi procedural ka administruar provën, se si ai ka arritur që të marrë provën,
- f) Prezumimi i fajësisë, sipas sistemit procedural inkuizitor është e mjaftueshme ekzistenca e disa indicieve kundër të pandehurit, qoftë edhe një kallëzim

anonim, dhe iu kërkohet të pandehurve që të shfajësojnë veten e tyre. Në këtë mënyrë është i pandehuri ai që duhet që të provojë pafajësinë e tij nëpërmjet provave, dhe nëse i pandehuri dështon që të provojë fajësinë e tij, ai duhet që të dënohet për veprën penale që akuzohet,

- g) Masat personale parandaluese, nëse ekzistojnë indicje kundër të pandehurit se ka kryer veprën penale, ai prezumohet fajtor, dhe në mungesë të provave që do ta shfajësonin, i pandehuri mundet që të vendoset edhe masa e arrestit në burg. Ndaj të pandehurit mundet që të vendoset një masë e tillë para se ai të dënohet edhe pa e njohur me faktin penal në ngarkim të tij dhe provat që ekzistojnë kundër të pandehurit.

Në sistemet e pastra inkuizitore nuk mundet që të konceptohet barazia midis akuzës dhe mbrojtjes, po kështu nuk mundet të realizohet barazia e kundërshtimeve midis palëve. Sistemi inkuizitor ka filluar që të funksionojë në vendet e Evropës kontinentale në periudhën e mesjetës, por që aktualisht ekziston vetëm në disa shtete të veçanta. Sistemi procedural inkuizitor është përdorur gjerësisht nga shtetet ish-komuniste, ku pa dyshim bënte pjesë edhe Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë i vitit 1979. Por ky sistem procedural aplikohet edhe në vende demokratike si Franca, në disa kantone në Zvicër, Greqi etj. Megjithatë, në sistemet procedurale inkuizitore në këto vende në vazhdimësi i janë bërë përmirësime në drejtim të demokratizimit, duke siguruar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të të pandehurit, zbutjen e diferencës së midis palëve, ndryshime këto që ka bërë të mundur krijimin e “sistemit inkuizitor të garantuar”, i cili siguron realizimin dhe garantimin e të drejtave të individit në procesin penal, siguron respektimin e standardit të procesit të rregullt gjyqësor të njohur nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

5.4. Procesi i rregullt ligjor në sistemin akuzator

Duke u bazuar në parimin e mësipërme në procesin penal pushteti procedural i njërit prej subjekteve është i balancuar nga ai që i njihet njëkohësisht edhe subjektit tjetër. Është e nevojshme sipas këtij sistemi që një gjyqtari i paanshëm të jetë në gjendje që të njohë dy pozicionet e ndryshme të dy palëve në procesin gjyqësor dhe pretendimet e tyre, duke qëndruar vetë në një pozicion neutral. Kjo që sapo përmendëm mund të përkufizohet si “ndarja e funksioneve procedurale”, dhe kërkohet që të evitohet mundësia që përdorimi i pushtetit procedural të shkojë deri në abuzim të tij, në dëm të të drejtësisë dhe në dëm të të drejtave të palës kundërshtare.

Nga kuptimi i drejtë të parimit “të ndarjes së funksioneve procedurale” derivojnë edhe disa karakteristika esenciale të sistemit procedural akuzator, karakteristika të cilat janë të vendosura në pozicione të kundërta logjike me ato që karakterizojnë sistemin inkuizitor, siç janë;

- a) Iniciativa e palëve, gjyqtari nuk mundet që të procedojë kryesisht për të vendosur lidhur me objektin e gjykimit, pasi në të kundërt do të demonstronte anësi në gjykimin e çështjes. Iniciativa në procesin penal sipas këtij sistemi iu përket vetëm palëve, “akuzatorit” nga dhe ka marrë emrin ky sistem procedural. Në fillimet e funksionimit të këtij sistemi iniciativa për të vënë në lëvizje gjyqtarin i perkiste një akuzatori privat, personit të dëmtuar nga vepra penale apo çdo qytetari, por me kalimin e kohës ky pushtet procedural iu atribua një organi publik, prokurorit,

- b) Iniciativa provuese e palëve, kompetencat procedurale për kërkimin, administrimin dhe vlerësimin e provave nuk i atribuohen vetëm njërit prej subjekteve procedurale, qoftë gjyqtari apo prokurori, por ato janë të ndara midis gjyqtarit, prokurorit dhe mbrojtjes, në mënyrë që asnjëra nga palët të mos abuzojë në përdorimin e këtyre kompetencave.

Në sistemin akuzator akuza ka barrën që të kërkojë provat e duhura dhe të bindë gjyqtarin për fajësinë e të pandehurit. Mbrojtja duhet që të ketë mundësinë që të kërkojë prova në bazë të të cilave të mund të bindë gjyqtarin që i pandehuri nuk është fajtor, apo që mënyra se si pala e akuzës ka arritur në konkluzionet e saj mbi faktin objekt gjykimi, duhet të ishte kryer në një mënyrë tjetër të ndryshme nga ajo që ka kryer akuza. Gjyqtari duhet që vetëm të vendosë nëse e pranon të shqyrtojë llojin e provës që i kërkohet nga palët dhe kufizohet në vlerësimin e saj, nëse ajo konfirmon pretendimet e ngritura nga palët në proces. Provat marrin vlefshmërinë e tyre dhe formohen vetëm gjatë gjykimit dhe ato nuk kanë vlerë të paracaktuar.

Të dyja palët në procesin gjyqësor, si pala e akuzës dhe ajo e mbrojtjes, kanë mundësinë që të paraqesin prova para gjykatës që të provojnë pretendimet e tyre, të kundërshtojnë argumentet e palës së kundërt. Palët në këtë sistem procedural kanë “barazinë e armëve” për të bindur gjyqtarin që të vendosë në favor të argumenteve të tyre.

- c) Kontradiktoriteti, ndarja e funksioneve procedurale të subjekteve procedurale në sistemin akuzator është arritur edhe më anë të parimit të kontradiktoritetit. Ekzistenca e këtij parimi siguron që, gjyqtari para se të marrë vendimin lejon palët e interesuara që të paraqesin parashtrimet e veta dhe të debatojnë lidhur me provat dhe argumentet e palës së kundërt. Sa më i zgjatur të jetë

kontradiktoriteti, aq më shumë mundësi ka që të pranohet më mirë e vërteta.

Çdo palë në respektim të këtij parimi duhet që ti jepet mundësia që të vërë në dyshim ekzistencën e faktit dhe të provave të paraqitura nga pala tjetër;

- d) Oraliteti, ekziston oraliteti në kuptimin që ata palët në proces mundet që ti bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje nga ata që dëgjojnë, dëshmitari, eksperti etj, të cilët japin shpjegimet e tyre para gjykatës. Oraliteti lejon që të vlerësohet besueshmëria e tyre, prej kësaj derivon rregulli procedural në sistemin akuzator, i mosvlerësimit në marrjen e vendimit të deklaratave të shkruara, nëse personat e pyetur nuk japin shpjegimet e tyre para gjykatës;
- e) Kufizimet lidhur me mënyrën e administrimit të provave, në sistemin akuzator mbahet në konsideratë fakti se është shumë e rëndësishme “mënyra” nëpërmjet të cilës arrihet që të formohet prova. Vetëm nëse mënyra e formimit të provës është në përputhje me rregullat procedural, pra është respektuar ana formale, prova mundet që të jetë e pranueshme dhe e përdorshme në funksion të provimit të ekzistencës së një fakti;
- f) Prezumi i pafajësisë, kushdo që akuzon një person për kryerjen e një krimi duhet që të bindë gjyqtarin nëpërmjet provave që personi i akuzuar ka kryer veprën penale;
- g) Kufizimi i masave të sigurimit, meqë i pandehuri prezumohet i pafajshëm deri në përfundim të gjykimit, ai nuk mundet që të trajtohet si i fajshëm. Ajo që mundet të aplikohet në bazë të këtij sistemi janë vetëm masat e sigurimit, të cilat vendosen kur ekzistojnë prova që të tregojnë konkretisht nevojat e sigurimit.

KAPITULLI VI: GJYKATA, PROKURORIA DHE ROLI I SAJ PËR NJË PROCES TË RREGULLT LIGJOR

6.1. Përbërja e gjykatës dhe parashikimi në ligj

Një tjetër element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e krijuar me ligj. Neni 42 i Kushtetutës parashikon që kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.” Po ashtu, Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kërkon që “...çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë. Kështu pra, gjykimi nga një gjykatë e drejtë, e pavarur, e paanshme, e caktuar me ligj përcaktohen nga Kushtetuta si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Kjo e drejtë madje nuk duhet thjesht të jetë formale, pra thjesht e parashikuar me ligj, por edhe të shihet që po respektohet. Si elementi objektiv, pra dhënia e garancive të nevojshme gjyqtarit për gjykim të paanshëm, ashtu edhe ai subjektiv, i lidhur ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, janë elementë të rëndësishëm të kërkesës për një gjykatë të pavarur e të paanshme. Veçanërisht përbërja e trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv është adresuar nga GJK në vendimet e saj.

Në Vendimin Nr.43/1999, GjK konsideroi cenim të procesit të rregullt ligjor pjesëmarrjen në gjykim të disa anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë si dhe Gjykatës së Kasacionit për një çështje të cilën ata e kishin shqyrtuar më parë. Kjo situatë i bënte këto organe të paanshme e kështu pra, cenonte parimin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme kërkuar nga Kushtetuta. Të njëjtin qëndrim mbajti GjK edhe në Vendimin Nr. 48/1999, ku theksoi se: ...pjesëmarrja si gjyqtarë e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Në praktikën gjyqësore nuk përjashtohen edhe rastet edhe kur në varësi të ndryshimit të akuzës që bën prokurori, të ndryshojë edhe përbërja e trupit gjykues. Marrim një rast kur gjykimi ka vazhduar ndaj të pandehurit me akuzën e kryerjes së veprës penale “vjedhja duke shpërdoruar detyrën” e parashikuar nga neni 135 i K.Penal dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor prokurori ndryshon akuzën duke e akuzuar të pandehurin për veprën penale “vjedhja” të parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal. Nëse vepra penale e parashikuar nga neni 135 i K.Penal gjykohet në shkallë të parë me trup gjykues me tre gjyqtarë, vepra penale e parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal gjykohet nga gjyqtari i vetëm. Kështu që, me ndryshimin e akuzës duhet të ndryshojë edhe në këtë rast edhe trupi gjykues dhe çështja të vazhdojë të gjykohet nga gjyqtari i vetëm. Nëse do të ndodhte e anasjellta, pra nëse prokurori do të ndryshonte akuzën nga neni 134/1 në nenin 135 të K.Penal, atëherë çështja penale nuk do të gjykohej më nga gjyqtari i vetëm por nga trupi gjykues. Pasoja e ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues në këtë rast do

të sillte si pasojë edhe fillimin e shqyrtimit gjyqësor nga fillimi pavarësisht nëse faza e shqyrtimit gjyqësor para ndryshimit të akuzës nga prokurori mund të ishte në fazën e diskutimeve përfundimtare.

6.2. Kuptimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm

Siç është thënë më parë procesi gjyqësor fillon vetëm me kërkesën e palëve. Mirëpo kërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor është e pandashme nga përmbushja e detyrimeve prej tyre gjatë këtij procesi. Ato janë të detyruara t'i nënshtrohen rregullit të vendosur nga gjykata gjatë procesit gjyqësor, siç janë respektimi i afateve brenda të cilave detyrohen të paraqesin faktet në mbështetje të pretendimeve të bëra në proces, kërkesat e ndryshme procedurale, ose të respektojnë radhën për kryerjen e veprimeve procedurale. *Nga ana tjetër edhe gjykata ka detyra të caktuara në Kodin e Procedurës përmbushja e të cilave përbën **condicio sine qua non** për një proces të rregullt ligjor. Të tilla detyra të parashikuara shprehimisht për gjykatën janë verifikimi i çështjes së kompetencës e juridiksionit të saj, i përbërjes së rregullt të trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes, i njoftimit të palëve dhe subjekteve të tjerë pjesëmarrës në procesin gjyqësor, i legjitimitetit të palëve ose të vetë personave si palë dhe të përfaqësuesve të tyre, si formimi drejt ndërgjyqësor. Në qoftë se gjykata nuk e përmbush këtë detyrë që në fillim të procesit gjyqësor ose edhe gjatë këtij procesi, si një pjesë përbërëse të procesit ligjor, nuk mund të thuhet se ajo ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm. Duke ia lënë rastësisë çështjen e ekzistencës së elementeve të mësipërm, si gjykata ashtu edhe pala e interesuar nuk janë asnjëherë të sigurt për ligjshmërinë e procesit gjyqësor.*

Lidhur ngushtë me hetimin e plotë e të gjithanshëm është edhe përfundimi i

çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Kjo sanksionohet direkt në kushtetute në nenin 42 paragrafi 2. Madje e gjejmë edhe në Konventën Europiane të drejtave të njeriut. Nocioni “afat i arsyeshëm” është i gjerë. *Me “afat të arsyeshëm” nuk duhet kuptuar vetëm përfundimin e çështjes në një shkallë gjykimi.* P.sh. në shkallë të parë çështja mund të përfundojë formalisht brenda afatit të arsyeshëm, por vendimi i gjykatës të shfuqizohet nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë dhe çështja të fillojë nga e para. Në këtë rast nuk mund të bëhet fjalë për afat të arsyeshëm për shkak se vendimi është prishur dhe çështja duhet të rishqyrtohet (Novicki, 2003: 200-203).

6.3. Kuptimi pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës

Termi pushtet zakonisht shoqërohet me një mbiemër, si “pushtet politik”, “pushtet vendor”, “pushtet ekzekutiv” etj. Termi “pushtet” nuk duhet ngatërruar me termin “shtet”, siç ndodh ndonjëherë në jetën e përditshme. “Pushteti i një shteti është një mjet për kryerjen e funksioneve të tij”. Nocioni pushtet është i gjerë. Si nocion shoqëror mund të flitet për pushtet midis subjekteve. Pushteti është “e drejta dhe mundësia që ka dikush për të urdhëruar dikë”, p.sh pushteti prindëror. Pra ka pushtete të ndryshme. Ajo që duhet pasur parasysh është se çdo pushtet ka një farë imponimi të dukshëm ose të padukshëm. Ushtrimi i tij kurdoherë ka si synim arritjen e një qëllimi. Po nga të gjitha llojet e pushteteve dallohet pushteti shtetëror. Ai ka monopolin e imponimit e shtrëngimit dhe këtë e ushtron me anë të një aparati të veçantë që quhet aparat shtetëror. Në kuadrin e pushtetit shtetëror si një tërësi, ushtrojnë pushtetin organet e ndryshme të shtetit. Në këto organe bëjnë pjesë edhe gjykatat. Pushteti që ato ushtrojnë gjatë veprimtarisë së tyre është quajtur pushtet gjyqësor. Dhe pushtetin gjyqësor e ushtrojnë vetëm gjykatat, asnjë organ tjetër. *Ky është parimi themelor i sanksionuar në nenin*

135.1 të Kushtetutës.

“Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga Gjykata e Apelit e Shkallës së Parë, të cilat krijohen me ligj”, thuhet në këtë dispozitë. Asnjë organ tjetër nuk ka të drejtë të ndërhyjë në ushtrimin e pushtetit gjyqësor nga gjykatat. Pra, pushteti gjyqësor është i pavarur nga çdo pushtet tjetër. Ndikimet apo presionet e organeve të tjera shtetërore mbi gjykatat cenojnë parimin e pavarësisë së tyre dhe nga ky cenim cenohet dhënia e drejtësisë. Dhënia e drejtësisë presupozon marrjen e vendimeve vetëm në bazë të ligjeve. Prandaj është organizuar ushtrimi i veprimtarisë së gjykatave në tri shkallë, si metodë e kontrollit më të plotë të zbatimit të ligjeve”.

Një kontroll të veçantë dhe ekskluziv lidhur me respektimin e parimit kushtetues të procesit të rregullt gjyqësor nga ana e gjykatave, e ushtron Gjykata Kushtetuese. Kjo gjykatë ushtron kontroll kushtetues jo vetëm mbi aktet e organit ligjdhënës dhe atij ekzekutiv por edhe gjykatat. Kështu që është krejt pa vend insinuata për këtë gjykatë si gjykatë e shkallës së katërt. Kontrolli i fortë kushtetues i Gjykatës Kushtetuese ndikon mjaft në respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve dhe goditjen e veprimeve në kundërshtim me Kushtetutën e ligjet nga ana e organeve të ndryshme shtetërore, sidomos në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Si shembull tipik të rolit të madh të Gjykatës Kushtetuese mund të marrim atë të Gjermanisë. Pa mohuar meritën e vetë gjykatave të zakonshme të këtij vendi, një rol të madh luan edhe Gjykata Kushtetuese.

Gjykata e ushtron pavarësinë e saj në raport me organet dhe institucionet e tjera, madje edhe vetë gjyqtarët, në çështjet që gjykojnë janë të pavarur nga hierarkia administrative gjyqësore, që nga kryetari i gjykatës përkatëse e deri te Këshilli i Lartë i Drejtësisë si organ emërtese për gjyqësorin. *Gjithashtu gjykata është e paanshme dhe e ushtron paanësinë e saj në raport me palët në çështjen konkrete. Pavarësisht se çfarë*

përfaqësojnë këto palë, individë apo institucione shtetërore qofshin edhe ato më të lartat, gjykata duhet të jetë e paanshme. Kjo për faktin se gjykata është i vetmi institucion, arbitër, që jep drejtësi dhe pikërisht në pavarësinë dhe paanësinë e saj garantohen dhe mbështeten liritë e qytetareve (Agaj, 2012).

6.4. Prokuroria si organ Kushtetues dhe roli i saj në Procesin e Rregullt Ligjor

Jurisprudenca kushtetuese ka trajtuar, gjithashtu, një sërë aspektesh që lidhen me organin e Prokurorisë. Identiteti kushtetuese i këtij organi është formësuar në mënyrë graduale dhe të vazhdueshme në periudha të ndryshme, kjo në varësi të kërkesave që janë marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese si në lidhje me kontrollin abstrakt të normës ashtu dhe në çështje të kontrollit konkret.

Statusi i prokurorisë është analizuar edhe në varësi të ndryshimeve të kuadrit kushtetues e ligjor përkatës. Sipas kuadrit kushtetues e ligjor që ka ekzistuar para viteve '90, prokuroria nuk ishte konceptuar si organ i pavarur. Ky konceptim shpjegohej me faktin se organizimi i shtetit dhe veprimtaria shtetërore bazohej në parimin e unitetit të pushtetit. Ndryshimet demokratike të fillimit të viteve '90 sollën ndryshime në fushën e organizimit shtetëror. Përveç kontrollit të zbatimit të ligjeve, organit të prokurorisë iu caktua edhe funksioni i ndjekjes penale dhe ai i mbrojtjes së akuzës në gjyq (neni 1 i ligjit nr.7538, datë 17.12.1991 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 6298, datë 27.03.1981 “Për Prokurorinë”), si dhe u sanksionua parimi se prokuroria është e pavarur në ushtrimin e funksioneve të saj dhe se vepron vetëm në bazë të ligjit (neni 2). Këto parime u risanksionuan, me disa ndryshime, edhe në kuadrin kushtetues të fillimit të viteve 90 (ligji nr.7561, datë 29.04.1992, “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7451, datë 29.04.1991”, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, nenet 13 e 14). Në këtë rregullim kushtetues sanksionohet përsëri pavarësia e prokurorëve nga pushtetet e tjera,

ndërsa prokuroria organizohet dhe funksionon brenda pushtetit gjyqësor si organ unik e i centralizuar (neni 13). Por njëkohësisht, në këtë ligj kushtetues janë bërë përpjekje për të futur elementet që garantojnë pavarësinë e këtij organi, duke parashikuar zgjedhjen e titullarëve të tij, konkretisht të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të zëvendësit të tij, nga dy organe kushtetuese, nga Kuvendi Popullor me propozim të Presidentit të Republikës (neni 14). Parimet e sanksionuara në ligjin “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, mbi të cilat mbështetej statusi i prokurorisë, gjetën pasqyrim edhe në Kushtetutën e vitit 1998. Kështu, në këtë ligj organi i prokurorisë ruan, në thelb, po atë funksion, po ato parime organizimi, duke parashikuar, gjithashtu, se në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Neni 148/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: “Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit”. Për t’i dhënë një theks më të dukshëm pavarësisë së prokurorisë në ndryshim nga ligji “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, Kushtetuta ka zgjedhur, në thelb, procedurën e emërimit dhe të shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm, duke mos ia lënë këtë proces vetëm një organi kushtetues si edhe duke specifikuar në të shkaqet e shkarkimit. Kështu, emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm bëhet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit, ndërsa prokurorët e tjerë emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm (neni 149/1/2/3), ndërsa shkarkimi i tij i është besuar Presidentit të Republikës me propozim të Kuvendit (Shih vendimin nr.26, datë 04.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese të RSH). Organi i prokurorisë ka disa veçori, të cilat janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligj, të cilat e vendosin këtë organ në një pozitë të dallueshme nga pushtetet e tjera, dhe veçanërisht: a) si organi i vetëm në vend që ushtron ndjekjen penale; b) si organ që përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit,

që disponon mbi çështjet që ndodhen në gjykim dhe që është i lirë në kërkimin e llojit dhe të masën së dënimit ndaj personave që i rezultojnë fajtorë; c) si organ me pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve, duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, gjë që do të thotë se fillimi i procedimit penal, vënia para përgjegjësisë penale, pushimi, pezullimi i çështjeve ose dërgimi në gjyq, janë attribute të prokurorisë; d) si organ i centralizuar që funksionon sipas rregullit se urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët, ndërsa ligjshmëria e vendimeve ose e veprimeve si dhe rregullsia ose plotësia e hetimeve të kryera nga prokurorët më të ulët kontrollohen vetëm nga prokurori më i lartë (neni 24/4/5 i ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”), me përjashtim të rasteve kur ligji procedural ia njeh gjykatës një të drejtë të tillë (Shih vendimin nr.26, datë 04.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese të RSH).

6.5. Pozita procedurale e prokurorit

Argumentet kushtetuese mbi pozitën procedurale të prokurorit janë pasuruar në mënyrë të vazhdueshme, duke e përcaktuar atë si të një lloji të veçantë. Prokurori nuk është palë në debatin gjyqësor që zhvillohet midis të pandehurit dhe të dëmtuarit akuzues. Për këtë kategori veprash penale ai është i përjashtuar me ligj nga roli i tij si përfaqësues i akuzës dhe si autoritet që ushtron ndjekjen penale (Shih vendimin nr.39, datë 23.06.2000 të Gjykatës Kushtetuese të RSH).

Për të ngritur akuzë kundër këtyre subjekteve, duhet të mbledhë fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit që akuzohet. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka, kundër çdo të dyshuari. Akuza është

procedimi penal i një personi, ndaj të cilit bien dyshime si autor i kryerjes së një vepre penale, të parashikuar si të tillë nga legjislacioni penal. Ngritja e akuzës publike nga prokurori konsiderohet si hapi i parë i ndjekjes penale të personit të dyshuar. Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, me ndjekje penale duhet të kuptohet veprimi juridik që ndërmerret kundër dikujt që ka shkelur ligjin (Shih vendimin nr.39, datë 23.06.2000 të Gjykatës Kushtetuese të RSH). Pra, ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i personit të akuzuar për kryerjen e një vepre penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Elementë të këtij procesi janë: caktimi i masave të sigurimit, njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit, këqyrja dhe kontrolli i personit ose i banesës, sekuestre, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe mbledhja e provave të tjera.

Vendimmarrja e prokurorit në çdo rast udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë. Kjo do të thotë, se përcaktimi i rasteve (kriterëve ligjore) të mos-fillimit apo pushimit të çështjes penale është bërë në nivel qendror nga ana e shtetit/ligjvënësit. Prokurorit nuk i lejohet një modus operandi i tillë ku të vendosë të pushojë një çështje penale jashtë kriterëve ligjore. Diskrecioni i prokurorit qëndron vetëm në faktin se atij i është lënë kompetenca të vlerësojë nëse, në procedimet konkrete që ka për trajtim, përmbushen ose jo këto kriterë. Pavarësia e prokurorit në organizimin e hetimeve paraprake dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë, është një vlerë kushtetuese. Megjithatë, kjo pavarësi, e sanksionuar në Kushtetutë, nuk mund të interpretohet se, në procesin penal, prokurorët nuk janë të detyruar të respektojnë ligjet dhe/ose udhëzimet apo vendimet e gjykatës.

6.6. Veprimet procedurale gjatë fazës së hetimit paraprak

Kuptimi i provave penale dhe procesit të provuarit, pësuan ndryshime rrënjësore me miratimin e K.Pr.Penale, ligjin Nr 7905 datë 21.03.1995, duke e bërë atë pjesë të sistemeve procedurale akuzatore, të aplikuara gjerësisht në vendet e Evropës Perëndimore. Veçori e procesit tonë penal është karakteri i pastër akuzator, me barazi të e plotë të palëve në fazën e gjykimit çështjes, me të drejta më të gjëra të organit ndjekjes penale gjatë hetimit paraprak, të drejta këto të cilat verifikohen, kontrollohen e miratohen nga ana e gjykatës për veprimet dhe disponimet kryesore procedurale. Instituti i provave dhe procesit të provuarit, është nga institutet më të rëndësishme të së drejtës procedurale penale. Ai me të drejtë është konsideruar si “institut bosht” i kësaj të drejtë, sepse ky institut lidhet me vetë përmbajtjen dhe detyrat e kësaj shkence, me atë që quhet procesi i zbulimit dhe i provuarit të së vërtetës në procesin penal.

Ligjvënësi sa i takon llojit dhe vlerës së provave penale në raport me fazën në të cilën ato janë marrë i ka klasifikuar në; prova penale të marra gjatë fazës së hetimit paraprak dhe provat e penale gjyqësore të marra në seancë gjyqësore nga gjykata mbi kërkesat e palëve apo kryesisht. Në nenin 151/1 të K.Pr.Penale, përcaktohet se gjatë hetimeve paraprake, provat merren nga organi që procedon, në rastin konkret nga policia gjyqësore dhe prokurori. “hetimi i çështjes, marrja e provave që i përkasin çdo çështje penale dhe paraqitja e tyre para gjykatës është detyrë e organit të prokurorisë, ndërsa vlerësimi i tyre përfundimisht bëhet nga gjykata e cila me vendim zgjidh çështjen”(Arsyetim në vendimin Nr 154 datë 29.03.2006 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë). Një çështje tjetër arsyetohet se; “në mënyrë të gabuar nga gjykatat arsyetohet se deklaratimet e bëra nga disa persona gjatë hetimit paraprak e të pranuar për lexim në gjykatë nuk merren të besueshme, sepse prova formohet në gjykatë... në nenin 151/1

theksohet se gjatë hetimeve paraprake, provat merren nga organi që procedon... (në këtë rast nga policia gjyqësore e prokurori si organ procedues gjatë hetimit paraprak)” (Vendimi Nr 13 datë 18.01.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me të gjykuar V.L.). Në nenin 316/ç të K.Pr.Penale, ndër të tjera i ka njohur të drejtën prokurorit dhe të pandehurit, që kryerja e procesit të ballafaqimit të realizohet nga gjykata në seancë gjyqësore, edhe se çështja ndodhet ende në fazën e hetimit paraprak. Kjo e drejtë e palëve, u lind kur rezultojnë deklarime apo thënie me përmbajtje të kundërt, dhe nga kryerja në kohë e këtij procesi ballafaqimi, vlerësohet se do të sigurohen njoftime të rëndësishme për objektin e të provuarit. Kryerja që në këtë fazë e ballafaqimit bëhet e domosdoshme jo vetëm për shkak të rrethanave të njohura dhe të trajtuara në institutin e sigurimit të provës por edhe të faktit që rezultatet e këtij ballafaqimi të marrë vlerën e provës gjyqësore. Në këtë rast gjykata merr një provë me vlerë gjyqësore dhe nën kontradiktorialitetin e palëve në proces, të cilat realizojnë të drejtat e tyre në marrjen e kësaj prove. Në këtë drejtim duhet thënë që praktika gjyqësore ka qenë e mangët. Vlerësoj se kjo ka ndodhur edhe për shkak të mosvlerësimit sa duhet nga ana e palëve në proces të kësaj mundësie që ka parashikuar ligji si dhe të mbivlerësimit të bërë nga gjykata të akteve dhe rezultateve të dala nga procesi i ballafaqimit gjatë hetimit paraprak. Paraqitja për njohje gjatë hetimit paraprak, kryhet nga Prokurori, por mund të kryhet edhe nga o.p. gjyqësore i ngarkuar nga prokurori për kryerjen e hetimeve paraprake. Megjithatë duke qenë se është veprim i rëndësishëm dhe i ndërlikuar procedural, këshillohet të kryhet nga prokurori. Për kryerjen e procesit të njohjes gjatë hetimeve paraprake, ligjvënësi nuk ka parashikuar që organi hetimit të disponojë me urdhër apo vendim të veçantë për kryerjen e njohjes, sikurse kërkohet domosdoshmërisht për kryerjen e ekspertimit dhe eksperimentit hetimor (Neni 177/1,

179/2 dhe 182 të K.Pr.Penale). Në seancën gjyqësore të marrjes së provave gjykata duhet të disponojë me vendim të ndërmjetëm për realizimin e paraqitjes për njohje si për marrjen e çdo prove në gjykim. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe arsyetuar edhe praktika gjyqësore, për disa nga burimet e provave sikurse janë, marrja e deklarimeve, njohjet, ballafaqimet, pyetja e të pandehurit, të kryera gjatë hetimeve paraprake nga policia gjyqësore dhe prokurori. Me mjaft rëndësi është respektimi i të drejtës së mbrojtjes kur procesi i paraqitjes për njohje realizohet për të pandehurin apo personin e dyshuar për kryerjen e veprës penale, pra personin ndaj të cilit zhvillohen hetime, kur në ngarkim të tij rezultojnë të dhëna si autor i veprës penale, pavarësisht se ndaj tij nuk është ngritur akuzë sipas nenit 34/1 të K.Pr.Penale. Pavarësisht se në dispozitat për njohjen kjo e drejtë nuk është shprehimisht e përkufizuar ajo buron si kërkesë detyruese në respektim të parimit të përgjithshëm të sigurimit të mbrojtjes gjatë gjithë procesit penal. Gjkata Kushtetuese si dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i ka konsideruar si shkelje të së drejtës së mbrojtjes rastet kur nuk është siguruar prania e mbrojtësit në procesin e paraqitjes për njohje të personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale, dhe konkretisht; “e drejta e mbrojtjes në lidhje me veprimin procedural të paraqitjes për njohje të personit rrjedh nga përcaktimi i pozitës juridiko-procedurale penale të tij përpara dhe gjatë kryerjes së këtij veprimi procedural” (Vendimi Nr.19 datë 02.04.2012 i Gjykatës Kushtetuese). Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vendimin *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë*, e cila ka përkufizuar se ligjshmëria e përfitimit të të dhënës, të provës, nëpërmjet veprimit të njohjes së personit është e lidhur ngushtë si me respektimin e të drejtës së mbrojtjes ashtu edhe me vetë procedurën e kryerjes së saj.

KAPITULLI VII: DISA VËSHTRIME RRETH VËSHTRËSIVE QË SHFAQEN NË PRAKTIKË LIDHUR ME PROCESIN E RREGULLT LIGJOR NË SHQIPËRI

Problemet të cilat shfaqen në praktikë, për sa i përket zbatimit të gjykimit publik, janë të natyrave të ndryshme. Ato janë të ndërlidhura ngushtë me faktorë objektivë apo subjektivë. Prandaj, gjykata duhet t'i ofrojë palëve në proces mundësi të barabarta, të qarta, praktike dhe efektive. E drejta për akses në gjykatë përfshin detyrimin pozitiv për t'i shërbyer palëve në mënyrë që ato t'i informojë lidhur me datat e seancave dhe vendimet e nxjerra gjatë procedurës. Si rezultat i kësaj, për të realizuar me sukses këtë parim, një vëmendje parësore, gjykatat duhet t'i kushtojnë çështjes së informimit të qytetarëve për datën, orën e gjykimeve dhe çështjeve, të cilat kanë një rëndësi thelbësore në korrektësinë e zhvillimit të procesit gjyqësor (Çështja Konig kundër Gjermanisë, GJEDNJ, vendim i 28 qershorit 1978, paragrafi 105). Gjkata, sipas bindjes së lirë dhe të brendshme, vlerëson se cilat informacione do t'ë japë për qytetarët për të bërë punën e vet më transparente. Në të shumtën e rasteve, informacionet vendosen në brenda apo në pjesën e jashtme të objektit të gjykatës. Mirëpo, duhet t'i kushtohet rëndësi që këto informacione të jenë të lexueshme nga të gjithë dhe të vendosen në vende të përshtatshme, duke iu përmbajtur edhe gjuhës që përdoret. Arsytet e mosrespektimit të orareve të gjykimit, ka raste kur janë të natyrës objektive, por në shumicën e rasteve, ato janë për arsye subjektive, të lidhura me mos menaxhimin si duhet të punës në gjykatë, me moskoordinimin e punës ndërmjet gjykatave dhe hallkave të tjera që kanë lidhje me sistemin gjyqësor, si dhe me mungesën e kërkesës së llogarisë. Shkak për mosrespektimin e orareve të gjykimeve, shpesh bëhet edhe

mosparaqitja ose paraqitja me vonesë e palëve në gjykim. Në korrelacion me këtë, gjykata nuk është përgjegjëse për vonesën e shkaktuar nga sjelljet e palëve në procesin gjyqësor. Palët gjyqësore gëzojnë të drejtën për të shfrytëzuar plotësisht të drejtat e veta procedurale. Megjithatë, kur duke e bërë këtë vonon procedurën, gjykata nuk do të jetë përgjegjëse për atë pjesë të vonesës, që e ka shkaktuar njëra apo pala tjetër. Pamundësia dhe procedimi jo nëme kohë i çështjeve gjyqësore, që janë objekt shqyrtimi gjyqësor, për shkak të vështirësive të ndryshme, mund të pengojë administrimin e mirëfilltë të drejtësisë në çështjet penale, dhe kjo do të ndikojë negativisht në të drejtën e personit të akuzuar që të gjykohet brenda kohës së arsyeshme. Gjyqtarët kanë detyrimin që të sigurohen në vazhdimësi, se drejtësia është ajo që do të shërbehet, duke i marrë në konsideratë të gjitha elementet komplekse të të gjitha çështjeve për të cilat do të vendosë gjykata. Po të veprojnë ndryshe, do të rrezikojnë dhënien e drejtësisë që është aq prioritare për shoqërinë dhe shtetin, sa që do ta bënte lirinë dhe sigurinë e qytetarëve më të pasigurt dhe shtetin ligjor më pak funksional. Një gjë është e qartë, se gjykatat kanë nevojë për një menaxhim sa më të mirëfilltë të çështjeve gjyqësore, për shkak se hapësirat kohore janë në disa raste edhe imperative, të cilat, po të shkelen, barra e përgjegjësisë i bie gjyqtarit të çështjes. Prandaj, gjykatat duhet të kenë parasysh që:

- Të vlerësojnë, se është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme që t'i kushtohet rëndësi shpalljes së lista-ve të Gjykimeve në mjedise të caktuara të Gjykatës në kohë dhe në hapësirë;
- Të zbatojnë praktika të favorshme për respektimin e orareve të gjykimeve;
- T'i identifikojnë të gjitha ato raste kur bëhen shtyrje të gjykimit dhe t'i evitojnë maksimalisht shtyrjet e paarsyeshme;

- T'i kushtoj rëndësi informimit për kohën e takimeve dhe respektimit të orarit të takimeve.

Njoftimet për pritjen e qytetarëve duhet të bëhen rregullisht në mjediset e të gjitha gjykatave. Ato përfshijnë njoftimet që përcaktojnë ditën dhe orarin e pritjes. Zakonisht, njoftimet vendosen në pjesët e gjykatës për t'ë dhënë informacionet përkatëse për qytetarët. Për sa i përket administrimit të drejtësisë penale, është e nevojshme që gjykata, të përqendrohet më tepër në zhvillimin e marrëdhënieve më të mira, dhe t'i trajtojë në mënyrë të veçantë nevojat dhe shqetësimet e të gjithëve.

Në njërin nga rekomandimet e Këshillit të Evropës, ndër të tjera, theksohet se për dhënien e shërbimeve gjyqësore dhe ligjore, komunikimi me gjykatat përmes mjeteve të reja të teknologjisë, duhet të lehtësohet sa më shumë, duke u bërë thirrje sistemeve të gjykatave që informacionin e tyre, si dhe praktikën gjyqësore, ta bëjnë të disponueshme për publikun, me qëllim që opinioni të ketë informacione në kohë rreth funksionimit më efektiv të gjyqësorit.

Për sa i përket orarit të takimeve të kryetarit të gjykatës me qytetarët, ato janë të ndryshme, në varësi të gjykatës. Pothuajse në të gjitha rastet e studiuara, pritjet bëhen nga kryetari, por ka edhe çështje për të cilat pritjen e bëjnë nënkryetari i gjykatës, e në raste të rralla, në varësi të rëndësisë së informacionit, nga kancelari i gjykatës. Kjo praktikë vlerësohet si jo e përshtatshme ose duhet të sqarohet më mirë.

Problemet të tilla si: zvarritja e procedurave, zvarritja e proceseve gjyqësore për shkaqe të natyrave të ndryshme objektive apo subjektive, moszbardhja në kohë e vendimeve të formës së prerë, favorizimi i palëve kundërshtare, vonesa e arsytimit të vendimeve të dhëna, sidomos të vendimeve të ankimuara në Gjykatën e Shkallës së Dytë, ankesa lidhur me zhvillimin e procesit, moskalimi në kohë i dosjeve nga një

gjykatë në tjetrën, ankesa në lidhje me regjistrimin e kërkesave, me një palë, etj, janë stuhitë, të cilat shkaktojnë, vështirësi serioze në funksionimin normal të gjykatës, duke u shëndrruar në pengesa serioze për zgjidhjen e një çështjeje penale. Prandaj, gjykata duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme që këto probleme ti shmangë sa më shumë që të jetë e mundur.

7.1. Shpallja e listave të gjykimeve në mjedise të caktuara të gjykatës

Gjykata vlerëson se cilat informacione do të vendosen në brendësi apo në pjesën e jashtme të objektit të gjykatës, që do të thotë se këto informacione duhet të jenë të lexueshme nga të gjithë dhe të vendosen në vende të përshtatshme dhe të dukshme. Zakonisht, këto vendosen në tabelën e shpalljeve për gjykimet publike, shënohet emri, mbiemri, ora e mbajtjes së seancës dhe çështja e cila do të jetë objekt i konsultimit nga publiku.

Në praktikë ekzistojnë raste kur listat janë të vendosura në vende të papërshtatshme, njëra mbi tjetrën, ose në mjedise të jashtme, ku mund të dëmtohen nga persona të papërgjegjshëm. Përpos vështirësive për marrjen e informacionit në lidhje me vendin dhe datën e mbajtjes së seancave dëgjuese, ka pasur raste kur aksesii publikut në gjykim ka qenë i kufizuar. Në disa raste, vetëm personat e thirrur për të marrë pjesë në gjykim apo personat e ndërlidhur me palët në procedurë, janë lejuar të hyjnë në gjykatë, dhe me këtë është penguar aksesii publikut në gjykata.

Shumica e gjykimeve që mbahen në gjykata, zakonisht mbahen në zyrën e kryetarit të trupit gjykues. Për shkak të mungesës së sallës së gjykimit, apo si pasojë e numrit të madh të seancave gjyqësore, sallat e gjykatave janë të mbingarkuara.

Sipas studimeve të bëra në mbarë Shqipërin, gjykimet mbahen pothuajse çdo ditë pune dhe në 90% të rasteve ato parashikohen të fillojnë në orën 10:00. Për të evituar këtë paradoks do të ishte më mirë që gjyqtarët të organizohen dhe të hartojnë vetë kalendarin e gjykimeve që do të zhvillohen brenda ditës.

Duhet të jemi të vetëdijshëm se mbajtja e seancave gjyqësore në zyre të gjyqtarëve është jo efektive, së pari për gjyqtarin, por edhe për palët po ashtu, për shkak se këto nuk janë të dizenuara për mbajtje të seancave gjyqësore. Paraprakisht, prania e personelit gjyqësor, e palëve dhe e përfaqësuesve të tyre ligjor, zë pjesën më të madhe të hapësirës, duke u krijuar kështu një atmosfere pune jo e përshtatshme, që do të ndikonte negativisht në efektivitetin e punës.

Praktikat e paraqitura më lart, shpeshherë, vështirësojnë mundësitë që publiku të marrë pjesë gjatë seancave publike në gjykata. Edhe pse informimi dhe aksesimi në gjykim, eventualisht, mund t'i mundësohet një numri të caktuar të pjesëtarëve të publikut, që kanë njohuri për sistemin, kërkohet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për ta hequr këtë pengesë për vëzhgimin e gjykimit nga ana e publikut, që në një formë apo tjetër, është pak a shumë njohur me aktivitetet që zhvillojnë gjykatat.

7.2. Respektimi i orareve të gjykimeve

Një element shumë i rëndësishëm i menaxhimit të mirë të sistemit gjyqësor, që ndikon te besimi i publikut ndaj gjyqësorit, është respektimi i orarit të gjykimeve. Në bazë të studimeve të bëra, ka rezultuar se, pothuajse në të gjitha gjykatat, seancat gjyqësore, zakonisht në shumicën e rasteve, caktohen të fillojnë në orën 10:00. Mirëpo, mospërfillja e këtij orari të përcaktuar paraqet mungesë serioziteti nga ana e gjykatave,

të japin indikacione jo të mira për respektimin e të drejtave të palëve, duke ndikuar ndjeshëm në imazhin e tyre për sistemin e drejtësisë.

Në të shumtën e rasteve, vonesat e fillimit në kohë të seancave kanë pasoja, siç mund të ndodhë p.sh. në rastin e transportimit i të paraburgosurve. Shpeshherë këta vijnë në gjykatë të stërlodhur, në gjendje jo të mirë shëndetësore, të pa ushqyer, të prangosur, etj. Duhet pasur parasysh që orari i punës në gjykata duhet të shfrytëzohet në mënyrë efektive. Orari i punës nuk duhet të përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i tij ka për qëllim përmbushjen e detyrimeve në përputhje me ligjet.

Zakonisht si arsye të mosrespektimit të orareve të gjykimit janë rastet e natyrës objektive, por, në shumicën e rasteve, ato janë subjektive, të lidhura me mosmenaxhimin si duhet të punës në gjykatë, moskoordinimin e punës ndërmjet gjykatave dhe hallkave të tjera, që kanë lidhje me sistemin gjyqësor, si dhe me mungesën e kërkesës së llogarisë. Afatet e përcaktuara kohore, të cilat gjykata është e detyruar t'i respektojë, japin një sinjal të qartë dhe një balancë midis disa faktorëve, siç janë:

- Mundësia e imponimit të rreptë të ligjit mbi krimet, duke mbrojtur në të njëjtën kohë individët nga paraburgimet e tejzgjatura;
- Paqartësitë dhe pasiguritë, të cilat mund të shfaqen rreth zbatimit konkret ligjor;
- Marrja në konsideratë e metodave alternative për të zgjidhur të gjitha çështjet, për të cilat japin mundësi dispozitat ligjore ekzistuese; Prandaj, vonesat që rezultojnë nga zvarritjet e gjata të gjykimeve në sistemin gjyqësor, shoqëruar me mosmarrjen e masave korrigjuese nga ana e shtetit, janë konsideruar si shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pra, është përgjegjësi

e gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor, shmangia e vonesave të panevojshme, që mund të rezultojnë në shkeljen e së drejtës për një gjykim të drejtë, duke ndikuar negativisht në besimin e publikut tek administrimi i drejtësisë

Shkak për mosrespektimin e orareve të gjykimeve, shpeshherë, është edhe mosparaqitja ose paraqitja me vonese e palëve, siç janë:

- Vonesat e prokurorit për shkak të mbingarkesës me shumë çështje;
- Mosardhja e dëshmitareve në kohë apo mosparaqitja fare në seancë;
- Vonesat e paraqitjes së avokatit në seancën gjyqësore;
- Pengesat objektive dhe subjektive në transportimin e të paraburgosurve;
- Pengesat të cilat shfaqen për shkak të mos funksionimit të pajisjeve teknike (kompjuterave dhe pajisjeve të tjera audio në sallën e Gjykimit);
- Si dhe probleme tjera, të cilat mund të shfaqen para fillimit të mbajtjes së seancave.

7.3. Shtyrja e gjykimit si faktor negativ në publicitetin e gjykimit

Është kërkesë e kohës dhe në të mirë të funksionimit efikas të gjykatave, që të bëjnë përpjekje që çështjet gjyqësore t'i përfundojnë brenda kornizave të parashikuara procedurale. Shqyrtimet gjyqësore përfundojnë shumë rrallë brenda një seance gjyqësore, ndërkohë që në vend që të vazhdojnë ditën tjetër të punës, zakonisht shtyhen për periudhën maksimale që lejon ligji, d.m.th. shpesh vazhdojnë për periudha të zgjatura kohe dhe, në disa raste, përfundojnë pas disa vitesh. Jemi të vetëdijshëm se *drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*, prandaj, shtyrjet dhe vonesat shkaktojnë zhvlerësim dhe krijojnë ankth dhe pasiguri për palët e përfshira në proces, të cilat rezultojnë në humbjen apo dëmtimin e provave, në bazë të të cilave përcaktohen të drejtat. Gjykatës i takon që të ndërmarrë të gjitha masat për të eliminuar shkaqet e

vonesave duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat objektive dhe subjektive. Shtyrjet e seancave gjyqësore japin një sinjal të funksionimit të dobët të Gjyqësorit, duke e vënë atë para kritikave të publikut dhe më gjerë. Prandaj, koncepti është i qartë se, gjyqtari i çështjes gëzon autoritetin absolut për të arritur dhe mbajtur rrjedhën e duhur të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore. Gjyqtarët përbëjnë “*lojtarin e tretë të paanshëm*” në procesin e zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje. Ata janë të vetmit që mund të përcaktojnë ecurinë e procesit gjyqësor, pavarësisht nga interesat e palëve. Për këtë arsye, ata duhet të luajnë një rol pro-aktiv për të garantuar një shqyrtim të drejtë dhe përshtatshëm në aspektin kohor të çështjes, sipas afateve të përcaktuara. Referuar praktiës gjyqësore në Shqipëri, një rast flagrant i zvarritjes së procesit pafundësisht dhe mosrespektimit të procesit të rregull ligjor konstatohet në çështjen, **civile me nr. 570 me palë paditëse Anna Vebi Nordstrom dhe i paditur Ferik Vebi Velija, me objekt “Njohje trashëgimie”, e cila ka filluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 19.01.2011 dhe ka mbaruar më datë 03.06.2013, vetëm pas ndërhyrjes së Gjykatës Kushtetuese e cila me vendimin nr. 35 datë 17.07.2013, ka konstatuar cënimin e një procesi të rregullt ligjor në dëm të shtetases suedeze Anna Vebi Nordstrom (pra ky vendim është marrë vetëm pasi Gjykata Kushtetuese kishte miratuar shqyrtimin e ankesës së paditëses).**

Në gjykimin e kësaj çështjeje në shkallën e parë më shumë se **14 (katërmëdhjetë)** gjyqtarë, kanë dhënë dorëheqjen njeri pas tjetrit nga gjykimi i kësaj çështjeje.

Edhe heqja dorë e këtyre gjyqtarëve tregon të qënurit të njëanshëm të gjyqtarëve dhe jo profesionalë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj nr. 6144 datë 03.06.2013, ka rrëzuar kërkesën e paditëses Anna Nordstrom duke i lejuar vetes të japë të dhëna të rreme duke mos bërë vlerësimin e duhur të provave të administruara e për më tutje duke iu bërë një interpretim joreal provave të shqyrtuara në seancat gjyqësore.

Nga data 03.06.2013, për gjykimin në Apel të kësaj çështjeje palës paditëse i është dashur të presë një afat kohor mbi një vit.

Gjykata e Apelit Tiranë ka çelur shqyrtimin gjyqësor dhe ka marrë prova të reja, dhe pasi ka administruar të gjitha këto prova të reja, me vendimin nr. 3315 datë 07.10.2014, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe kthimin për rigjykim të kësaj çështjeje.

Një sorollatje e tillë ndikon në vonesën në procesin gjyqësor.

Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh se jurisprudenca e KEDNJ-së (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut), e cila është e aplikueshme në Republikën e Shqipërisë, specifikon se “pasiviteti i gjykatave”, “plogështia gjyqësore në mbledhjen e provave” dhe “mungesa e plotë” e interpretimit nga ana e autoriteteve gjyqësore” në disa raste, kanë qënë shkaqe të shkeljes së të dretjës për një proces të rregullt ligjor.

Një fakt tjetër shqetësues është humbja e kontrollit të gjyqtarit mbi çështjet gjyqësore, që shkakton pasivitet procedural. Kjo humbje kontrolli shkakton pasiguri dhe probleme të mëvonshme të cilat, në të shumtën e rasteve, bëhen serioze për çështjen, e cila është objekt i shqyrtimit në procesin gjyqësor. Sikurse edhe për vonesat në gjykim, arsyet e shtyrjes së gjykimeve janë nga më të ndryshmet dhe si të tilla ato mund të jenë:

- Kur prokurori nuk paraqitet në seancat gjyqësore, atëherë shtyhet shqyrtimi gjyqësor;
- Nevoja për paraqitjen e akuzës së re;

- Nevoja për mbledhjen e provave të reja (Komisioni Evropian për Efektshmerine e Drejtësisë, viti 2006);
- Mosparaqitja e njërës prej palëve, e dëshmitarëve, ekspertëve, e avokatëve në shqyrtimin gjyqësor;
- Mosveprim i trupit gjykues, apo paraqitja me vonesë e kërkesës për përjashtim të gjyqtarit të çështjes apo të ndonjërit nga anëtarët e trupit gjykues;
- Mungesa e adresave të palëve (të pandehurve, të dëshmitarëve), ose pasaktësia në dokumentacion për sa i përket adresave të tyre;
- Zvarritja e proceseve nga disa avokatë, të cilët mundohen të përfitojnë nga afatet ligjore për të shtyrë seancat, gjë që mund të jetë në dobi të tyre apo të palëve që ata mbrojnë, mirëpo me efekt negativ për zhvillim normal dhe efektiv të procesit gjyqësor;
- Kërkesa për tërheqje të gjyqtarit nga gjykimi ose për shtyrje të gjykimit kur pretendohet për të sjell prova të reja;
- Mbingarkesa në punë e avokatëve gjatë ditës (kur mbrojnë disa çështje në të njëjtën kohë), sidomos kur njëkohësisht avokatët kanë çështje në gjykatën e shkallës së parë dhe në atë të dytë; Shpeshherë, shtyrjet e gjykimeve të pamotivuara kanë çuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të qytetarëve, si dhe në një sërë anomalish të tjera për vetë gjykatën.

Në bazë të disa studimeve që janë bërë, shpeshherë ndodhin shtyrje të seancave të gjykimit për shkaqe të pajustificuara. Me gjithë shqetësimet dhe ankesat e tyre, vëzhguesit nuk kanë konstatuar asnjë rast ku të jetë marrë ndonjë masë kundrejt gjyqtarëve, për të cilët qytetarët janë ankuar për zvarritje të papërligjura të proceseve

gjyqësore. Për të shmangur çdo lloj zvarritjeje, është e nevojshme të nxirren rregulla të brendshme dhe këto të shpërndahen anëtarëve të gjykatës - gjyqtareve, me qëllim të rregullimit të disiplinës në punë në gjykata, dhe me qëllim të shmangies së zvarritjeve të paarsyeshme të zhvillimit të seancave gjyqësore, si dhe për respektimin me të denjë të etikës profesionale me qytetarët dhe me kolegët nëgjyqësor.

7.4. Numri i madh i çështjeve gjyqësore dhe efektet e tyre negative në procesin e rregullt gjyqësor.

Gjykatat mund të funksionojnë me efektivitet dhe me cilësi, vetëm nëse mbështeten, nga një sistem i shëndoshë dhe i mirë menaxhimi. Sfidat e vërtetë e konceptimeve të një sistemi të caktimit të çështjeve mishërohet në atë mënyrë, që efekti i tyre të maksimizohet në mënyrë që palët t'i realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me ligj. Si rezultat i kësaj, suksesi i çdo sistemi të caktimit të çështjeve gjyqësore, varet nga shkathtësia e gjyqtarit lidhur me çështjet me të cilat është ngarkuar. Aftësia për të ushtruar një kontroll të tillë varet nga përkushtimi i kryetarit të gjykatës, si dhe nga gjyqtarët e çështjeve. Secili gjykatës ka autoritet formal ndaj procedimit të çështjeve me të cilat është ngarkuar për t'i zgjidhur ato. Është përgjegjësi e secilit gjyqtar që t'i zgjidhë çështjet brenda afatit të përcaktuar procedural duke i kushtuar rëndësi që gjykimet të mbahen sa më shpejt që është e mundur dhe njëkohësisht, duke pasur parasysh çdo rast veç e veç.

Në bazë të saj, vëmendje parësore i duhet kushtuar problemeve të cilat mund të shfaqen në praktikë, sfidat:

- Procesi i marrjes së informacionit në lidhje me çështjet gjyqësore;
- Klasifikimi i tyre në ato që janë prioritet;
- Burimet që mund të përdoren për të përballuar ngarkesën e çështjeve;

- Numri i çështjeve me të cilat është ngarkuar gjyqtari, natyra dhe kompleksiteti i çështjes;
- Caktimi i orëve kohore për të gjitha fazat e çështjes, sidomos për ato që janë kritike dhe kërkojnë urgjencë në procesin gjyqësor.
- Identifikimi në kohë të gjitha çështjeve dhe problemeve të cilat mund të shkaktojnë zvarritjen e procesit gjyqësor.
- Respektimi i afatit për fillimin e proceseve gjyqësore në datën e caktuar;
- Marrja parasysh, që gjyqtarët dhe personeli tjetër ndihmës të jenë në shërbim të funksionimit sa më efikas të shtetit.

Prandaj, është detyrë e gjykatësve që të marrin në dorë drejtimin dhe administrimin kohor të procesit gjyqësor, e jo të lënë çështjet në harresë dhe në stuhi të kohës.

Pavarësisht nga kompleksiteti i çështjeve që janë objekt i shqyrtimit gjyqësor, duhet të bëhet përpjekje që të krijohet një atmosferë që e favorizon administrimin e suksesshëm të procesit gjyqësor.

Gjykatësit gëzojnë pushtet të mjaftueshëm, duke qenë në gjendje ta ushtrojnë atë pushtet, brenda autoritetit dhe përgjegjësiwe maksimale me ndërgjegjshmëri. Gjykatësit kanë për detyrë, të sigurojnë që ligji të zbatohet ashtu siç duhet, dhe që çështjet të trajtohen në mënyrë të drejtë, efikase dhe me shpejtësi, pa dëmtuar, të drejtat e palëve.

KAPITULLI VIII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

E drejta përnjë proces të rregullt ligjor përbën një nga të drejtat e parashikuara në Kushtetutën tonë dhe në Konventën Europiane, e cila lidhet me garancitë që u ofrohen palëve gjatë një gjykimi në drejtim të respektimit të atyre parimeve që përbëjnë thelbin e procesit.

Standarde të tilla kushtetuese si e drejta për t'ju drejtuar gjykatës e drejta e mbrojtjes, paanësia në gjykim, gjykimi publik, prezumimi i pafajësisë etj., përbëjnë elementë kryesorë që Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar në jurisprudencën e saj për kuptimin sa më të plotë të se drejtës për një proces të rregullt gjyqësor.

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë kushtetuese. Ajo garanton të drejtën e çdo personi që për mbrojtjen e interesave të tij të ligjshme, t'i drejtohet gjykatës apo, organeve kompetente.

Gjykimi i drejtë është një koncept kompleks që sidoqoftë reduktohet në një gjykim që zhvillohet nga një gjykatë kompetente në bazë të ligjeve përkatëse. Është një e drejtë që përfshin të gjithë procesin gjyqësor penale. Nuk mund të ketë asnjë arsye të ligjshme që të privojë ndonjë person apo ndonjë kategori personash nga kjo e drejtë e rëndësishme.

Një sërë nenesh të tjera të Kushtetutës që garantojnë të drejtat e qytetarit në përgjithësi si dhe të drejtat e individit në procesin penal, lidhen drejtpërdrejt me të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor (e drejta për t'u mbrojtur vetë ose me anën e një mbrojtësi ligjor, e drejta për të pasur kohën dhe lehtësitë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen).

Kështu ato mund të bëhen padyshim objekt gjykimi nga Gjykata jonë

Kushtetuese, ku kjo e fundit merr në shqyrtim kërkesat e individëve për një proces të rregullt ligjor.

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një gur themeli në sistemin e të drejtave themelore të personave, prandaj është detyrë e të gjitha organeve shtetërore dhe jo vetëm e Gjykatës Kushtetuese, që t'i kushtojnë më tepër vëmendje respektimit të kësaj së drejte. Përkëtë temë, mund të shkruhet tepër, por po mjaftohem që të theksoj se respektimi i kësaj së drejte nga të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor do të ishte një garanci mjaft e rëndësishme për të gjithë dhe do të rriste besueshmërinë e sistemit gjyqësor.

Funksionimi i gjykatave të rretheve gjyqësore të vëzhguara ka përmirësime të ndjeshme, megjithatë ka nevojë për një menaxhim më të mirë të tyre.

Parimi i publicitetit të seancave gjyqësore në përgjithësi respektohet në të gjitha gjykatat e vëzhguara. Me gjithë përmirësimet e bëra në infrastrukturën e gjykatave, ende ka probleme, të cilat çojnë në mosrespektimin e parimeve dhe të publicitetit të seancave gjyqësore.

Pavarësia e gjykatave dhe vërejtjet ose pretendimet për korrupsion vazhdojnë të jenë shqetësuese për sistemin e drejtësisë shqiptare. Kjo e ka lëkundur deri në një farë mase besimin e shtetasve ndaj gjyqësorit, gjë që ka ndikuar edhe në kërkesat për përjashtimin e gjyqtarëve.

Organizimi i punës në gjykatë lë mjaft për të dëshiruar. Zvarritjet ose shtyrjet e seancave gjyqësore janë dukuri e shpeshtë në gjykatat e vëzhguara. Zvarritjet e proceseve gjyqësore kanë qenë një nga shkaqet për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarëve nga gjykimi. Ato kanë ndikuar edhe në uljen e besimit të publikut tek sistemi gjyqësor.

Ndonëse shumë qytetarë ankohen për zvarritje dhe shtyrje të pamotivuara të

seancave, deri më sot nuk del të jetë marrë asnjë masë ndaj gjyqtarëve përkatës.

Menaxhimi efektiv i sistemit gjyqësor varet edhe nga funksionimi i hallkave të tjera të administratës publike, sidomos i organeve të qeverisjes vendore. Mangësitë e informacionit për adresat, emrat e rrugëve, mosregjistrimi i qytetarëve janë disa nga shkaqet që ndikojnë në mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor.

Shërbimi i avokatisë jo gjithënjë mundëson zhvillimin në kohë dhe me cilësi të proceseve gjyqësore.

E drejta për informimin e publikun në përgjithësi është respektuar. Informimi i palëve për seancat e gjykimit afishohet në vende të dukshme. Megjithatë, ka ende vend për përmirësime të mëtejshme.

Shtetasve u janë krijuar mundësi për kontakte të drejtpërdrejta me drejtues si dhe me gjyqtarë të gjykatave. Oraret e pritjes së popullit në përgjithësi respektohen në të gjitha gjykatat e vëzhguara.

Aksesi i medias në gjykatë në përgjithësi është mundësuar. Ka vend për krijimin e lehtësirave më të mëdha dhe garantimin e dhënies së informacionit në kohë dhe për të gjithë gazetarët.

Njohja dhe sensibilizimi i publikut për rolin e drejtësisë për funksionimin dhe organizimin e gjykatës është në nivel jo të kënaqshëm. Aksesi i publikut tek gjykatat shpesh çënohet për shkak të mungesës së informimit për to. Megjithatë ka nisma dhe janë bërë përpjekje nga ana e gjykatës për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të publikut tek gjykatat. Përsëri mbetet shumë për të bërë.

Përgjithësisht, shërbimet që u ofrohen qytetarëve nga administrata e gjykatës reflektojnë etikë profesionale, por shërbimet ndaj qytetarëve kanë vend për përmirësime të ndjeshme.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë kjo e drejtë përmendet në mënyrë specifike në dy nene të saj. Neni 42 e rendit atë krahas të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, ndërsa neni 131 shkronja “f” e përcakton sinjë çështje juridiksioni për Gjykatën Kushtetuese. Në të dy dispozitat ky parim i rëndësishëm shfaqet sinjë garanci kushtetuese për individët ndaj çdo privimi që mund t’u bëhen të drejtave të tyre themelore nga shteti nëpërmjet organeve të tij vendimmarrëse.

Neni 42 i Kushtetutës sanksionon mbrojtjen e të gjitha të drejtave të njohura në Kushtetutë dhe me ligj, duke veçuar si të drejta kryesore lirinë, të drejtën e pronës, si dhe të drejtën përnjë proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë duket se nuk mban tënjëtin qëndrim ndaj të drejtave. Ka të drejta që mund të kufizohen, ashtu siç ka disa të drejta të tjera, për të cilat kufizimi është i papranueshëm për çdo rast.

Nëse e vështrojmë me kujdes nenin 42 pika 1, do të na rezultojë se liria, prona apo të drejta të tjera të njohura me Kushtetutë mund të kufizohen, mjafton që procesi ligjor të jetë i rregullt. Shprehja e përdorur në këtë dispozitë se *“nuk mund të cenohen panjë proces të rregullt ligjor”*, e nënkupton se kushti i vetëm për të mos u prekur këto të drejta është respektimi i procesit ligjor. Por në qoftë se procesi ligjor respektohet me përpikëri, që do të thotë se zbatohet kushti i domosdoshëm i pikës 1 të nenit 42, atëherë ndaj lirisë, pronës ose të drejtave të tjera, mund të lejohet ushtrimi i kufizimeve kushtetuese.

Është e parashikuar në nenin 27 të Kushtetutës: *“Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj”*.

Në nenin 41 lejohet shpronësimi ose kufizimi në ushtrimin e të drejtës së pronës vetëm për interesa publike. Ka edhe të drejta të tjera në Kushtetutë që mund të kufizohen për arsye të përligjura, të cilat njihen si kufizime kushtetuese.

E drejta përnjë proces të rregullt ligjor përmendet gjithashtu edhe në nenin 131 shkronja “f” të Kushtetues sinjë ndër kompetencat e kufizuara të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me të drejtën e saj për të shqyrtuar ankesat e individëve. Në dallim nga dispozitat e mëparshme kushtetuese që lejonin Gjykatën Kushtetuese të zgjidhte përfundimisht ankesat e personave të paraqitura në rrugën e kontrollit kushtetues për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme, neni 131 shkronja “f” paraqitet më i kushtëzuar. Në të thuhet :

“Gjykata Kushtetuese vendos për ... gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese përnjë proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetët juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”.

Po t’i referohemi nenit 6 të KEDNJ-së, do të gjejmë një kuptim më të gjerë në formulimin e tij. Në këtë nen përfshihen, e drejta për t’u dëgjuar, e drejta e një gjykimi të drejtë, procesi i hapur publik, zhvillimi i gjykimit brendanjë afati të arsyeshëm, pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës, parimi i prezumimit të pafajësisë, e drejta e të akuzuarve për tu informuar brendanjë afati sa më të shkurtër dhe në gjuhën e tij për akuzën, e drejta e tij për tu mbrojtur, e drejta të bëjë pyetje dhe të kërkojë thirrjen e dëshmitarëve, të ndihmohet falas nganjë përkthyes kur nuk kupton gjuhën e përdorur etj.

Për aq sa ka thënë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për procesin e rregullt ligjor, dalin dy momente thelbësore:

Së pari : shtetasit duhet t’i jenë cenuar liria, prona dhe të drejtat kushtetuese e ligjore;

Së dyti : cenimi i tyre duhet të ketë ndodhur pa u realizuar një proces i rregullt ligjor.

Të kuptuarit e kësaj dispozitë vështirësohet, pasi nuk jepet ndo një përkufizim për procesin e rregullt ligjor. Atë që nuk e jep Kushtetuta, është përpjekur ta zgjidh praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila është orientuar kryesisht nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe e disa gjykatave të tjera kushtetuese evropiane.

Gjykata Kushtetuese është përpjekur në praktikën e saj gjyqësore të bëjë një dallim thelbësor të rolit të saj si autoritet që garanton respektimin e Kushtetutës, nga funksioni i dhënies së drejtësisë që mbetet atribut i organeve të pushtetit gjyqësor. Prirja për ta orientuar Gjykatën Kushtetuese në një pozicion që të mos konfundohej me shkallët e tjera të gjyimit, por të nxjerrë në pah nga kontrolli i kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore vetëm problemet esenciale që prekin procesin e rregullt ligjor, ndjehet vazhdimisht në praktikën e saj.

E drejta përnjë seancë të drejtë e të ndershme, përfshin të gjitha procedurat dhe garancitë dhe qëndron në thelb të konceptit për gjykim të drejtë. E drejta përnjë shqyrtim të drejtë në gjykimet penale specifikohet nganjë numër i të drejtave konkrete, si e drejta për t'u konsideruar i pafajshëm, e drejta për t'u gjykuar pa vonesë të panevojshme, e drejta për të përgatitur mbrojtjen, e drejta për tu mbrojtur vet ose përmes avokatit, e drejta për të thirrur dëshmitarë etj.

E drejta për seancë publike, është garanci thelbësore e ndershmërisë, e drejtësisë dhe e pavarësisë së procesit gjyqësor, si dhenjë mënyrë e mbrojtjes së besimit publik në sistemin e drejtësisë. Përveçse në rrethana të përcaktuara me ligj, të gjitha seancat dhe gjykimet duhet të jenë publike. E drejta për seancë publike do të thotë që jo vetëm palët në proces, por, gjithashtu, edhe publiku në përgjithësi kanë të drejtën të jenë të pranishëm. Publiku ka të drejtën të dijë si administrohet drejtësia dhe çfarë vendimesh merren nga sistemi gjyqësor. E drejta për seancë të hapur mbështetet tek prania e

vëzhguesve. E drejta e vëzhguesve gjyqësor për të ndjekur seancat publike si dhe për të formuar opinion mbi pajtueshmërinë e tyre me ligjin dhe me detyrimet e angazhimet ndërkombëtare, përfshihet si një e drejtë në legjislacionin ndërkombëtar dhe në atë vendas.

Një seancë publike kërkon që seancat për dëgjimin e fakteve të çështjes të bëhen në publik, përfshirë edhe median. Gjykatat duhet të informojnë publikun rreth kohës dhe vendit të seancave dhe të sigurojnë lehtësi të përshtatshme brenda kufijve të arsyeshëm për pjesëmarrjen e të interesuarve nga publiku.

Arsyet për të cilat media dhe publiku mund të përjashtohen nga të gjitha seancat ose pjesë të tyre janë : *moral*i (si p.sh disa seanca që kanë të bëjnë me abuzime seksuale), *rendi publik* që lidhet kryesisht me rregullin brenda sallës së gjyqit, *sigurimi kombëtar*, *jeta private* e palëve ose rrethana të posaçme, ku publiciteti sipas mendimit të gjykatës do të paragjykonte interesat e drejtësisë.

Një parim themelor dhe parakusht për gjykim të drejtë është që gjykata e ngarkuar me përgjegjësinë e bërjes së vendimeve përnjë çështje, *duhet të jetë e krijuar me ligj, si dhe duhet të jetë kompetente, e pavarur dhe e paanshme*. Garancia parësore institucionale për një gjykim të paanshëm është se vendimet nuk merren nga institucionet politike, por nga gjykata kompetente, të pavarura e të paanshme, të krijuara me ligj.

Kjo e drejtë është absolute dhe nuk mund të ketë asnjë përjashtim. Kjo e drejtë nuk mund të pezullohet qoftë edhe në gjendjen e emergjencës. E drejta për gjykim përpara një gjykate kompetente, të pavarur e të paanshme të krijuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet dhënë, por ajo gjithashtu duhet të shihet se po jepet.

E drejta për t'u dëgjuar në seancë nga një trup gjykues i krijuar me ligj.

Qëllimi i kësaj kërke në çështjet penale është të sigurojë se gjykimet nuk kryhen nga gjykata të krijuara për të vendosur për çështjen e një rasti të veçantë. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese është konsideruar shkelje e procesit ligjor rasti i dhënies së vendimit nganjë gjyqtar i vetëm, ndërkohë që ligji kërkonte trup gjykues. Dhënia e vendimit nga një gjyqtar i vetëm në rastin konkret lidhet me mungesën e kompetencës së organit përkatës dhe njëkohësisht shkel konceptin kushtetues që parashikohet në nenin 42 të saj për zhvillimin e gjykimit nganjë gjykatë e caktuar me ligj.

E drejta për t'u dëgjuar në seancë nga një trup gjykues kompetent.

E drejta për seancë përparanjë gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen. Një gjykatë që është ligjërisht kompetente, për të shqyrtuar një çështje i është dhënë kjo fuqi prej ligjit; ajo ka juridiksion mbi temën e çështjes e të personit dhe gjykimi zhvillohet brenda çdo kufiri kohor të zbatueshëm të parashikuar me ligj.

E drejta për t'u dëgjuar në seancë nganjë trup gjykues i pavarur.

Pavarësia e gjykatës është thelbësore përnjë gjykim të drejtë. Ajo do të thotë që vendimmarrësit nënjë rast të dhënë janë të lirë të vendosin me paanësi për çështjen në bazë të fakteve dhe në pajtim me ligjin, pa asnjë ndërhyrje, presion ose ndikim të papërshtatshëm prej çdo dege të qeverisë ose tjetërkujt. Ajo gjithashtu, do të thotë që njerëzit e emëruar si gjyqtarë janë përzgjedhur në radhë të parë në bazë të aftësisë së tyre juridike.

E drejta për t'u dëgjuar në seancë nganjë gjykatë e paanshme.

Paanshmëria e vërtetë dhe të hequrit si i paanshëm janë që të dyja themelore për ruajtjen e respektit ndaj administratës së drejtësisë. E drejta përnjë gjykatë të paanshme

kërkon që gjyqtarët të mos kenë interesa nënjë çështje të veçantë dhe të mos kenë mendime të paraformuara rreth saj. Gjyqësori kërkohet të sigurojë që procedurat të drejtohen ndershmërisht e drejtësisht dhe që të respektohen të drejtat e të gjitha palëve. Paanshmëria nënkupton që gjyqtarët nuk duhet të fshehin paragjykime rreth çështjes të vënë përpara tyre dhe se ata duhet të mos veprojnë në mënyra që nxisin interesat enjërës palë. Sfidat ndaj paanshmërisë së gjykatës janë shkaktuar në kontekste të ndryshme, përfshirë rastin kurnjë gjyqtar ka marrë pjesë në shkallë të tjera të proceseve në cilësi tjetër, si dhe kur gjyqtarët kanë pasur interes vetjak në proceset ose ndonjë marrëdhënie menjë nga palët.

Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese ka disa raste të shkeljes së këtij parimi të rëndësishëm. Një gjyqtar, i shkarkuar me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se është shkelur parimi i paanshmërisë pasi në përbërje të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që kishin gjykuar ankesën e tij ndaj shkarkimit nga detyra kishin marrë pjesë dy anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.48/1999 konkludon se pjesëmarrja si gjyqtarë e dy anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pavarësisht nga ndikimi i pranisë dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhenjëkohësishtnjë garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje. Fakti që dy gjyqtarë të Kolegjeve të Bashkuara marrin pjesë në shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore, ku palë ndërgjyqës është institucioni ose organi, anëtarë të të cilit ata janë zgjedhur, është një shkak i arsyeshëm që nuk mënjanon të kërkuesi dyshimin që në rastin konkret objektivisht ekziston.

Cilido që është i akuzuar përnjë vepër penale ka *të drejtë për t'u mbrojtur* kundër akuzave. E drejta për t'u mbrojtur përfshin të drejtën *për të mbrojtur veten personalisht* si dhe *të drejtën për t'u mbrojtur nga avokati*.

E drejta për t'u mbrojtur nga avokati përfshin të drejtën për njoftimin e gëzimit të së drejtës për avokat, të drejtën për t'u takuar dhe për të zhvilluar komunikime konfidenciale me të, si dhe të drejtën për ndihmë nga avokati që zgjedh i akuzuari ose nganjë avokat i kualifikuar, i caktuar për të. Cilido person që do të jetë përballë një gjykimi penal duhet të njoftohet për të drejtën e tij për tu mbrojtur nga avokati. Kjo e drejtë është e zbatueshme, pavarësisht nëse i akuzuari është arrestuar, mbajtur në izolim ose jo para gjyqit. Për të siguruar që ky njoftim të jetë i efektshëm, ai duhet të jetë nënjë kohë të konsiderueshme para gjykimit, për të lejuar kohë dhe lehtësi të përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen.

Për shkak të rëndësisë që ka besimi dhe konfidenca midis të akuzuarit dhe avokatit, në përgjithësi ai mund të zgjedh se cili avokat do ta përfaqësoj.

Është tashmë e njohur gjerësisht se mundësia e menjëhershme dhe e rregullt, për të marrë avokat përnjë të ndaluar përbën mbrojtje të rëndësishme kundër torturave, keqtrajttimeve, pohimeve nën shtrëngim dhe abuzimeve të tjera. Garantimi qënjë person i ndaluar ka mundësinë të marrë avokat ështënjë siguri e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave, prandaj standardet ndërkombëtare e përkrahin dhënien të dënuarve të mundësisë për të pasur avokat pa vonesë pas arrestimit.

E drejta për të qenë i pranishëm në gjykim, është pjesë përbërëse e të drejtës për të mbrojtur veten. Megjithëse kjo e drejtë nuk është shprehimisht e përmendur në Konventë, Gjykata Europiane ka deklaruar se qëllimi dhe objekti i nenit 6 nënkuptojnë

qënjë person i akuzuar përnjë vepër penale ka të drejtë të marrë pjesë në seancë gjyqësore. E drejta, për të qenë i pranishëm në gjykim, i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë të akuzuarin dhe mbrojtësit në kohë të mjaftueshme, për datën dhe vendmbajtjen e procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë në to të akuzuarit dhe për të mos e përjashtuar padrejtësisht të akuzuarin nga gjykimi. Në vendimin nr.17/2001, Gjykata Kushtetuese arsyeton:

“ ...Mosvënia e të pandehurit në dijeni të apelit të prokurorit dhe mosnjoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes...i kanë mohuar atij... njëkohësisht disa të drejta themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane për të drejtat e njeriut, si e drejta për t'u mbrojtur ... e drejta për t'u dëgjuar para se të gjykohet ... shkelje këto që e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt... ”.

E drejta për t'u gjykuar pa vonesa të panevojshme.

Procedurat duhet të fillohen dhe të përfundojnë brendanjekohe të arsyeshme. Kjo kërkesë do të thotë që të vëna përballë të drejtës të të akuzuarit për kohë dhe lehtësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, procedurat duhen filluar dhe gjykimi përfundimtar duhet dhënë (pas gjithë apeleve) pa vonesë të panevojshme. Kjo e drejtë i detyron autoritetet që të sigurojnë që të gjitha procedurat nga fazat e paraprake, deri tek apeli përfundimtar, të përfundojnë dhe të jepen gjykimet brendanjekohe të arsyeshme. Për cilindo që është i akuzuar për veprën penale dhe që është mbajtur në gjendje arresti, shpejtimi i procedurave të gjykimit është i domosdoshëm. Ndajnjë të arrestuari, sa më minimale të jenë vonesat, aq më të arsyeshme konsiderohen ato. Standardet ndërkombëtare kërkojnë qënjë person i akuzuar për vepër penale të lirohet nga gjendja e arrestit në pritje të gjyqit, nëse kalohet koha që konsiderohet e arsyeshme për këtë mbajtje në gjendje arresti.

Garancia për gjykim të me njëhershëm në procedurat penale është e lidhur me të

drejtën e lirisë, me prezumimin e pafajësisë dhe me të drejtën për t'u mbrojtur. E drejta për t'u gjykuar me njëherë përmban në vetvete maksimën që drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar.

Periodha kohore që merret në shqyrtim, për të përcaktuar nëse kjo e drejtë është respektuar, fillon në kohën kur i dyshuari njoftohet se autoritetet po ndërmarrin hapa specifikë për ta marrë në ndjekje penale. Ajo kohë mbaron kur janë ezauruar rrugët përfundimtare të apelit dhe janë dhënë gjykimet. Se çfarë është një kohë e arsyeshme, gjykohët nga rrethanat e secilit rast. Elementet që merren në shqyrtim përfshijnë *legjislacionin ndërkombëtar, nëse i akuzuari është në gjendje arresti, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e të akuzuarit dhe sjelljen e autoriteteve*. Janë konsideruar nga jurisprudenca ndërkombëtare të arsyeshme gjykime që kanë vazhduar deri në dhjetë vjet, ashtu siç janë konsideruar të shtyrë pa arsye gjyqe të tjerë që kanë zgjatur më pak senjë vit.

Një kriter thelbësor injë seance të drejtë e të ndershme nënjë çështje është *parimi i "barazisë së armëve"* midis palëve. Barazia e mjetëve, që duhet respektuar gjatë gjithë procesit të gjykimit, do të thotë që të dyja palët të trajtohen nënjë mënyrë që i siguron ato të kenë pozitë të barabartë procedurale gjatë rrjedhës së gjykimit dhe të jenë në pozita të barabarta për të paraqitur çështjen e tyre. Ajo do të thotë që secilës palë duhet t'i ofrohet mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet në kushte që nuk e vënë atë në disavantazh të konsiderueshëm ndaj palës kundërshtare. Në gjykimet penale, ku prokurori ka të gjithë makinerinë e shtetit pas tij, parimi i barazisë së armëve është një garanci thelbësore e të drejtës për të mbrojtur vetveten. Ky parim siguron që mbrojtja të ketë mundësi të arsyeshme për të përgatitur e paraqitur çështjen e vet në pozita të barabarta me atë të prokurorit.

Mohimi i të drejtës për tu ankuar ndajnjë vendimi gjyqësor, prek drejtpërdrejtë të drejtën e individit pënjë proces të rregullt ligjor. E drejta e ankimit ndajnjë vendimi gjyqësor është e drejtë kushtetuese dhe askush nuk mund ta privojë shtetasin nga realizimi i saj. Çdo shkelje që lidhet me këtë të drejtë kushtetuese sigurisht që cenon procesin ligjor. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë menjë vendim unifikues, kishin vendosur të mos lejonin mbrojtësin e të gjykuarit në mungesë të caktuar nga familjarët e tij ose kryesisht nga gjykata, që të ushtronte të drejtën e ankimit. Çështja u paraqit në Gjykatën Kushtetuese nga avokati i të gjykuarit në mungesë, me pretendimin se mbrojtësi i pajisur me prokurë nga familjarët ose i caktuar kryesisht nga gjykata gëzon të gjitha të drejtat e mbrojtësit, ku përfshihet edhe e drejta e ankimit. Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se moslegjitimimi i mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët e të gjykuarit në mungesë, për të bërë ankim ndaj vendimit gjyqësor, cenon parimin kushtetues të mbrojtjes në procesin penal. E drejta e ankimit ndaj vendimit të fajësisë si pjesë e së drejtës së mbrojtjes është në favor të të pandehurit dhe jo në disfavor të tij, prandaj mosushtrimi i tij cenon të drejtat ligjore të të pandehurit. Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara ishte rrjedhojë enjë procesi të parregullt ligjor edhe për shkak se i vinte palët në pozita të pabarabarta, sepse nganjëra anë pranonte të drejtën e prokurorit për të ushtruar ankim kundër vendimit gjyqësor, ndërkohë që nuk legjitimonte mbrojtësin e caktuar nga familjarët e të pandehurit për të bërë ankim. Një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim edhe me kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së dhe praktikën e Gjykatës Europiane që respekton *parimin e barazisë së armëve*, i cili i siguron secilës palë mundësinë për t'i parashtruar çështjet në kushte që nuk i vendosin ato në gjendje të pafavorshme ndajnjëra-tjetrës.

Një parim themelor i të drejtës për gjykim të ndershëm është *e drejta* e çdo

personi të akuzuar për veprën penale, *për t'u prezumuar i pafajshëm*, derisa të provohet fajësia e tij ligjërisht. E drejta për t'u prezumuar i pafajshëm përdoret jo vetëm për trajtimin në gjykatë dhe vlerësimin e dëshmisë, por, gjithashtu, edhe për trajtimin përpara gjykimit. Ajo përdoret ndaj të dyshuarve përpara se të paraqiten akuzat penale përpara gjykimit dhe mbahet në përdorim derisa të konfirmohet gjetja me faj pas apelit përfundimtar.

E drejta për të mos u detyruar të dëshmosh kundër vetes ose të pranosh faj dhe e drejta e heshtjes, e lidhur me të, janë të rrënjësura në prezumimin e pafajësisë. E drejta për prezumim pafajësie kërkon që gjyqtarët të mos paragjykojnë asnjë çështje.

Ajo, gjithashtu, zbatohet për të gjithë punonjësit tjerë publik. Kjo do të thotë që autoritetet publike, në veçanti prokurorët e policia, nuk duhet të bëjnë deklaratat rreth fajësisë a pafajësisë tënjë të akuzuari përpara përfundimit të gjykimit.

Për sa më sipër rekomandoj:

- Përmirësimin e standarteve dhe kërkesave për gjyqtarët, me qëllim pasqyrimin e një sjelljeje të paanshme jo vetëm thellësisht, por edhe në dukje të gjyqtarit, gjatë procesit gjyqësor.
- Sugjerojmë të rishikohet sistemi i vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, duke mbajtur parasysh jurisprudencën më të re në këtë fushë. Me organizmin ligjor ekzistues një detyrë e tillë mundet të kryhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
- Përmirësimin e kushteve në gjykata në mënyrë që të respektohet solemniteti në gjykimin e çështjeve.
- Rritjen e numrit të gjyqtarëve në mënyrë që numri i vogël i tyre të mos ndikojë

në shpejtësinë e gjykimit.

- Krijimi dhe institucionalizimi i rrjetit të ekspertëve, psikologëve dhe punonjësve socialë, që do të ndihmojnë me ekspertizë procesin gjyqësor. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Gjykatat, Ministrinë që ndjek çështjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Vendosja e tarifave për shërbimin e ekspertëve, psikologut dhe të punonjësit social në proceset e ndryshme gjyqësore. Të parashikohen rastet kur ky shërbim duhet të jepet falas. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave. Udhëzimi ekzistues i Këshillit të Ministrave Nr.4 datë 12.12.2012, për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor, ka nevojë për plotësime lidhur me këtë ekspertizë. Ose mund të ketë një udhëzim të ri vetëm me këtë objekt.
- Vendosja e kërkesave dhe standardeve për ekspertët, psikologët dhe punonjësit socialë që do të japin ekspertizë në gjykatë. Trajnimi i tyre. Kjo, është detyrë e ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Sociale.
- Krijimi dhe institucionalizimi i rrjetit të avokatëve që do të ndihmojnë me ndihmë ligjore falas, viktimat e trafikimit, dhunës në familje në procese të ndryshme. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.
- Të përmirësohen standardet dhe kërkesat për avokatët, me qëllim që të njohin mirë sjelljen e avokatit në proceset gjyqësore dhe atë të gjyqtarit, në kuadrin e parimit të gjykatës së paanshme.
- Të shtohen dhe të përmirësohen studimet në këtë fushë, për të gjykuar më mirë

mbi parametrat e institutit të heqjes dorë të gjyqtarit në rastet kur ka dyshime për anshmëri. Kjo bëhet me qëllim që të mos cënohen afatet e gjykimit dhe thelbi i vetë procesit gjyqësor. Kjo detyrë kryhet nga Gjykatat, Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

- Të shtohen dhe të përmirësohen studimet në këtë fushë, me qëllim kuptimin më të mirë të këtij parimi në të gjithë dimensionin dhe ndërveprimin e tij me kuptimin një gjykatë të pavarur dhe të pakorruptuar. Detyrë e institucioneve të arsimit juridik.
- Gjykatat duhet të respektojnë parimin e publicitetit të seancave gjyqësore si edhe parimin e solemnitetit.
- Drejtuesit e gjykatave të tregojnë kujdes të madh për organizimin më të mirë të punës në gjykata dhe përnjë planifikim dhe koordinim më të efektshëm të ngarkesës së gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore.
- Koordinimi i punës ndërmjet institucioneve të policisë dhe prokurorisë dhe të gjykatës është kërkesë e domosdoshme për të siguruar mbarëvajtjen më të mirë të seancave gjyqësore.
- Të bëhet decentralizimi i prokurorisë, duke i garantuar prokurorit pavarësi të plotë.
- Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet të jenë njëherazi edhe gjyqtarë, me qëllim për të shmangur konfliktin e interesit.
- Drejtuesit e gjykatave, Ministria e Drejtësisë dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë të analizojnë zvarritjet e papërligjura të seancave gjyqësore dhe të marrin masa për parandalimin e tyre.
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të analizojë punën dhe etikën profesionale

të avokatëve dhe të marrë masa ndaj avokatëve që shkelin etikën profesionale.

- Me gjithë përpjekjet pozitive në drejtim të rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit të publikut nga ana e gjykatës, duhet bërë më shumë për të orientuar qytetarët për mënyrën si mund t'u drejtohen gjykatave. Për këtë, krahas punës që mund të bëjnë vetë gjykatat, Ministria e Drejtësisë, ndihmesë jo të vogël mund të japin edhe organizatat joqeveritare.
- Të merren masa konkrete për të rritur efikasitetin dhe shpejtësinë e shërbimeve të ofruara qytetarëve nga ana e administratës gjyqësore. Përmirësimi i administrimit të informacionit dhe përdorimi i sistemit kompjuterik është kërkesë urgjente që do të ndikojë në rritjen e shpejtësisë dhe të cilësisë së shërbimeve.
- Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, duhet të ndërmarrë një program të plotë trajnimi të administratës gjyqësore, jo vetëm për shërbimet e dhëna, por edhe për të lehtësuar informimin e publikut.
- Ndonëse bëhen shumë përpjekje për të rritur shkallën e informimit të publikut, vetë gjykatat dhe organizmat e tjerë joqeveritarë duhet të hartojnë strategji më plotë dhe më konkrete për informimin e publikut dhe rritjen e aksesit të publikut tek drejtësia. Për këtë, rol të madh mund të luajnë studentët e Fakultetit të Drejtësisë dhe ata të Magjistraturës.
- Qeveria shqiptare duhet të parashikojë buxhete të mjaftueshme për përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave dhe krijimin e mundësive për një shërbim më të mirë ndaj publikut.
- Të gjitha organet përgjegjëse kundër dhunës, të kujdesen që provat të përgatiten paraprakisht dhe jo në ditët e gjykimit. Subjekti që ndihmon viktimën për të

përgatitur kërkesën (Policia, OJF-ja, avokati, etj), në mënyrë që ta shoqërojnë kërkesën me provat përkatëse paraprakisht. Këto detyra duhet të kryhen nga të gjitha organet e rrjetit kundër dhunës dhe avokatët.

- Krijimi dhe institucionalizimi i rrjetit të Detektivëve privat, nëpërmjet rregullimit ligjor të vepritarisë së tyre, me një ligj të posaçëm, duke qenë se kontributi i tyre mund të jetë i vlefshëm për procesin e të provuarit, dhe në të njëjtën kohë do të krijonte më shumë garanci për palët e përfshira në një proces gjyqësor.
- Do të ishte e dobishme që, kur viktimat ndihmohet nga institucione që kanë mundësi, këto të fundit të përgatisin një raport me faktet që disponojnë, ose një raport të psikologut kur është nevojë veçanërisht për dhunën ndaj fëmijëve, dhe ta dorëzojnë atë së bashku me kërkesëpadinë. Kjo do ta ndihmonte shumë gjykatën që të mos humbë afatet e gjykimit.
- Është e nevojshme që të zbatohet nga gjykata edhe rregullimi i shpenzimeve gjyqësore në ngarkim të të pandehurve me qëllim që të funksionojë instituti i mbrojtjes falas dhe i psikologëve falas.
- Sygjerohet përcaktimi i tarifave për shërbimin e psikologut duke mbajtur parasysh edhe të ardhurat e palëve, përveç kritereve të tjera.
- Të zbatohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të hartohen komentare për zbatimin e këtyre vendimeve nga gjykatat, me qëllim që ato të shërbejnë për të gjithë praktikën gjyqësore.
- Të rriten mundësitë për bashkëpunimin e OJF-ve me Komisionin shtetëror të Ndihmës Juridike me qëllim zbatimin efektiv të ligjit "Për ndihmën Juridike".
- Të bëhet ministudim mbi efektivitetin e legjislacionit aktual mbi taksat

gjyqësore në RSh dhe të vlerësohet ky legjislacion në lidhje me mundësitë që ofron për përjashtimet dhe lehtësimet tatimore të shtetasve nga taksat gjyqësore. Nga rezultatet e ministudimit të përgatiten paketat e nevojshme për ndryshim.

- Sugjerojmë të rishikohet Sistemi i vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, duke mbajtur parasysh jurisprudencën më të re në këtë fushë. Kjo detyrë duhet të kryhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
- Vendosija e kërkesave dhe standardeve për psikologët dhe punonjësit socialë që do të japin ekspertizë në gjykatë. Kjo, është detyrë e ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me ministrinë e çështjeve sociale.
- Të përmirësohen standardet dhe kërkesat për avokatët, me qëllim që të njohin mirë sjelljen e avokatit në proceset gjyqësore dhe atë të gjyqtarit, në kuadrin e parimit gjykatë e paanshme. Kjo detyrë kryhet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.
- Të krijohen ambiente të përshtatshme për avokatët që presin, me qëllim që ata të marrin njoftim të sigurt për fillimin e seancave gjyqësore.
- Të krijohen ambiente të përshtatshme për palët që presin, me qëllim që ata të marrin njoftim të sigurt për fillimin e seancave gjyqësore.
- Thirrja e palëve për fillimin e procesit gjyqësor në korridoret e Gjykatës të jetë i kuptueshëm dhe të komunikohet emri i gjyqtarit, si dhe ambienti ku do të zhvillohet gjykimi.
- Të bëhet kujdes për përpunimin e të dhënave në database, me qëllim që ato të japin të saktë orën dhe fazat e zhvillimit të seancës.
- Mendojmë se gjykata duhet të riorganizojë njoftimet në mënyrë të tillë që avokati dhe pala të kenë më shumë senjë alternativë njoftimi.

- Gjyqtarët duhet ta respektojnë rregullin për të qëndruar me uniformë gjatë procesit gjyqësor.
- Duhet të ndalohet kategorikisht përdorimi i celularit gjatë seancave gjyqësore.
- Të bëhet rregullnjë periudhë pushimi pas çdo seance gjyqësore, me qëllim që gjyqtarët të përfundojnë komunikime të ndryshme jashtë seancave ose urgjenca personale.

LISTA E REFERENCAVE/BIBLIOGRAFIA

A. LITERATURË

- Agaj, E. (2012). *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, St. GoVlora, Vlorë.
- Alstyn V, William. (1977). *Cracks in the New Property: Adjudicative Due Process in the Administrative State*, 62 Cornell Law Review 445.
- Brugger, W. (2010). *Democracy and Organisation in the Chinese Industrial Enterprise (1948-1953)*, Cambridge University Press.
- Cassese, A. (2005). *E drejta ndërkombëtare*, Oxford University Press.
- Chemerinsky, E. (2006). *Constitutional Law, Principles and Policies*. Aspen Law & Business 3d ed.
- Çeço, S. (1986). *E drejta procedurale civile e RPSSH*, Universiteti i Tiranës "Enver Hoxha", Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike.
- De Salvia, M. (1995). *La Convention europeenne des droits de l’homme*, Paris.
- Delmas, M. (1987), *La Matiere penale au sens de la CEDU, flou du droit penal*, Paris.
- Edisofer S.L, Euros Editores, B. de F Ltda. (2006). *Discurso penai de la exclusion*, voi. II, Madrid-Buenos Aires-Montevideo.
- Elezi, I, Kacupi S. Haxhia, M. (2007). *“Komentari i së drejtës penale”*.Tirane.
- Ferrajoli, (2000). *Diritto e ragione. Teoria del garantismo penale*, Laterza, Bari.
- Guerini, (2005). *“Ligji Penal i së Drejtës Ndërkombëtare”*, Tirane.
- Hames Banker, J & Ekern, Y. (2005). *“Constitutional Law, Principles and Practice”*.1st Edition.
- Hysi, V. (2012). *Penologjia*. Tiranë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

- Kasa A, (2013). *Kundërvajtja Administrative Në Republikën E Shqipërisë*, Universiteti “Aleksander Moisiu” Durrës.
- M. A Nowicki. (2003). *Reth Konventës Europiane. Porcesi brenda një afati të arsyeshëm* Botim i Q.SH.D.NJ. Tiranë.
- M. De Salvia, (1995). *La Convention europeenne des droits de l’homme*, Paris.
- M. Delmas. (1987). *La Matiere penale au sens de la CEDU, flou du droit penal*, Paris.
- Marchesi. (2005). *Të Drejtat e njeriut dhe Kombet e Bashkuara. Të drejtat, detyrimet dhe garancitë*, Milano.
- Mole. N, Harby. C. (2003). *E drejta për një proces të drejtë gjyqësor*, Një udhëzues për implementimin e Nenit 6, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Europës, Gent Graf.
- Novicki, M. (2003). Rreth Konventës Evropiane, “*Procesi brenda një afati të arsyeshëm*” Botim i Q.SH.D.NJ, Tiranë.
- Omari, L. (2002), *Shteti i së drejtës*, Tiranë.
- Omari, L. Anastasi. A. (2010). *E drejta kushtetuese*. Ribotim, Tiranë : Sh.B. ABC
- Omari, L.(1993). *Parime dhe institucione të së drejtës publike*, Tiranë. Botimet “Elena Gjika”.
- Ovey C, White R, (2006).*European Convention on Human Rights*.Oxford: OUP.
- Pradel, J. Corstens, G. Vermeulen, G. (2010). *E drejta penale evropiane*, Botimet. Papirus, Tiranë.
- Rubin, E. (1984). *Due Process and the administrative state*, 72 California law review 1044.
- Sadushi, S. (2004). *Kontrolli kushtetues*, Tiranë.

- Sadushi, S. (2011). *Drejtësia Kushtetuese në zhvillim*, Tiranë.
- Vorpsi, A. (2011). *Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë* , Fondacioni Konrad Adenauer, Botime Maluka, Tiranë.
- Xhafo, J. (2009). *E drejta penale ndërkombëtare*, Tiranë.
- Zaganjori, Xh. Anastasi, A. Çani, E (Methasani). (2011). *Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*, Shtëpia Botuese Adelprint, Tiranë.

B. BURIME PARËSORE

- AKTE NORMATIVE

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998, Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor.
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e vitit 1950 dhe protokollet shtesë të saj.
- Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948.
- Pakti Ndërkombëtarë i të Drejtave Civile dhe Politike me Protokollet e vitit 1966.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Kodi i Procedures Penale i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji “Për Gjykatat”, Ligji nr.03/L-199,G.Z.79/2010 dhe Nr.03/L171,G.Z.nr. B28/201.

C. BURIME DYTËSORE

- Avokati i Popullit (2012) “*Raport i Veçantë për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë*”:

http://www.parlament.al/ëeb/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_154131.pdf).

- Avokati i Popullit, *Të drejtat e të burgosurve, Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve jashtë Shqipërisë*, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Shqipëri, 2009.
- Council of Europe, *European Rules for Juvenile Offenders Subject to Sanctions Or Measures Business & Economics* – 2009.
- Cowdery, N. AM QC, *Effectiveness of the criminal law*, Legal Studies State Conference 2008, Rosehill, 27 Mars 2008.
- Debati Kushtetues – Diskutimet në Komisionin Parlamentar për Hartimin e Projekt-Kushtetutës së vitit 1998, Vëllimi i Dytë (2006).
- ECHR, *Dybeku v. Albania*, 2007:
<http://www.shendetesia.gov.al/al/neësroom/deklarata-per-shtyp/spitali-i-psikiatri-se-ligjore-beqaj-detyrim-per-ata-qe-kanë-nevoje-per-kete-sherbim>, aksesuar më Maj 2014.
- European Commission For The Efficiency Of Justice (CEPEJ) ” *Enforcement of court decisions in europe*, University Nancy (France) / Sëiss Institute of comparative laë and discussed by the CEPEJ-GT-EVAL at their 8th meeting, Fq. 28:
http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/series/etudes8execution_en.pdf, akses i fundit 12/06/2014.
- Frowein/Peukert, *EMRK-Kommentar*, (1996).
- Gazeta Shqip, 30 shtator 2012, Magna Carta themeli i lirisë ndoshta e mbivlersur.
- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës, Rezoluta për etikën gjyqësore, Shkurt 2013, paragrafi 3.

- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e Këshillit të Evropës, Etika Gjyqësore, Art. II. Paanshmëria.
- Justicia, (2011). *E Drejta për një Proces Të Rregullt Ligjor Sipas Konventës Evropiane*, <http://drejtesiashqiptare.com>.
- Kodi i Etikës gjyqësore, dt. 05.12.2000, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe Selim Kryeziu, “Etika e gjyqtarit, në “Revista Juridike”, nr.2, dhjetor 2005.
- Kola F. Tafaj,(2010), “Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit”, në “Jeta Juridike”, Nr.1, Mars.Tiranë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi 20.11.2013, aksesuar më 25.05.2014 nga http://www.parlament.al/ëeb/pub/ligjet_20_11_2013_14414_1.pdf.
- Konferenca kombëtare, Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore te formës se prere ne mbrojtje të të drejtave te individëve, Tiranë, 2003:
<http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Konf2003.pdf>.
- Kontrolli-i-ndërsjellë-dhe-balancimi-i-pushteteve-sipas-Kushtetutës-së Shqipërisë 1.pdf. aksesuar në dhjetor 2015.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut- Botim i Këshillit të Evropës, Ekstrakte kyç nga jurisprudenca e Konventës Evropiane të të Drejtave te Njeriut – Botim i Këshillit të Evropës, 2004.
- Leksione legjislacioni, Portali online Juridikal:
<https://sites.google.com/site/juridikal/leksione/legjislacioni-kombeetar/moduli-i-parimi-i-kushtetueshmerise-dhe-ligjshmerise>.
- Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut - element themelor në funksionimin e shtetit modern, 09.12.2011, Marrë nga faqja online:

<http://www.telegrafi.com/lajme/mbrojtja-e-lirive-dhe-te-drejtave-te-njeriut-element-themelor-ne-funksionimin-e-shtetit-modern-26-4474.html>.

- Medrano, J Casadevall. (2012) “Gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, kumtesë e mbajtur në Konferencën “Reforma gjyqësore, si një ndër 12 prioritetet e sfidës së integritetit të Shqipërisë në BE”, Tiranë.
- Nesturi, M. (2010), “Gjykimi i të pandehurit në mungesë , e drejta e rivendosjes në afat të ankimit dhe pozita procedurale e mbrojtësit të tij. Problemet që dalin nga praktika gjyqësore dhe çështje që lidhen me ligjin”, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.
- Një udhëzues për implementimin e Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Nuala Mole dhe Catharina Harby, Manuali e të drejtave të njeriut, Nr. 3, F-67075, Strasbourg Cedex, faqe 11.
- Portali i Këshillit Europian, E drejta për proces të rregullt:
<http://www.coe.int/sq/web/echr-toolkit/droit-a-un-proces-equitable?inheritRedirect=true>, aksesuar në Janar 2016.
- Roagna, I. 2012. “Mbrojtja e së Drejtës për Respektimin e Jetës Private dhe familjare sipas Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut”; Doracakët për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, Këshilli i Evropës, Strasburg.
- Të drejtat e Njeriut në Evropë (Jurisprudencë dhe Komentet)- Botim i Qendrës Evropiane.
- Zendeli E, (2009). *E Drejta E Gjykimit Brenda Afatit Të Arsyeshem* Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca,.
- Cartledge (1995) in: Harris, R. et al Probation Round the World, Coles, B. (1995) Youth and Social Policy, London: UCL Press.
- http://ligjet.info/kodi_proc_penale/pjesa_i/titulli_v/kreu_i/seksioni_i/neni_228.

- <http://aksp.rks-gov.net/?page=2,144>.
- <http://balkaninsight.com/en/main/news/944>.
- http://www.ahc.org.al/site/doc/Raport_burgje_paraburgim_final%20shkurt%2021.pdf.
- <http://www.docstoc.com/docs/81466758/Drejtoria-e-Pergjithshme-e-Burgjeve>.
- <http://www.euromove.org.uk/index.php?id=13934>.
- http://www.kas.de/wf/doc/kas_22459-1522-33-30.pdf?110526130640.
- <http://www.ligjet.org>.
- http://www.parlament.al/web/pub/ligjet_20_11_2013_14414_1.pdf.
- http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004_46law.pdf.

- **Praktikë Gjyqësore**

- Çështja Andronicou dhe Constantinou kundër Qipros, 5 korrik 1995.
- Çështja Bram kundër United States, 168 U.S. 532 (1987).
- Çështja Corigliano kundër Italisë, 10 Dhjetor 1982, Seria A nr.57.
- Çështja Darby kundër Spanjës, 23 tetor 1990.
- Çështja Dewer kundër Belgjikës, 27 Shkurt 1980, Seria A nr. 35 – B.
- Çështja Eckle kundër Spanjës, 15 Korrik 1982, Seria A nr. 51.
- Çështja Engel dhe të tjerët kundër Hollandës, 8 Qershor 1976, Seria A nr. 22 – B.
- Çështja Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, 21 Shkurt 1975, Seria A nr. 18.
- Çështja Herini kundër Italisë, 18 Tetor 2006.
- Çështja Hornsby kundër Greqisë, 19 Mars 1997, Seria A nr. 229 – B.
- Çështja Isgro kundër Italisë 19 Shkurt 1991, Seria A nr. 34 – B.

- Çështja Konig kundër Spanjës 28 Qershor 1978.
- Çështja Law less kundër Irlandës, 14 Nëntor 1960, Seria A, nr. 1
- Çështja Lutz kundër Spanjës 25 Gusht 1987, Seria A nr. 123 – B.
- Çështja Martins Moreira kundër Portugalisë, 26 Tetor 1988, Seria A nr. 143.
- Çështja Philis kundër Greqisë, 27 Qershor 1997, Seria A nr.12 dhe çështja Portington kundër Greqisë, 23 Shtator 1998.
- Çështja Piersack kundër Belgjikës, 1 Tetor 1982, Seria A nr. 53.
- Çështja Ringeisen kundër. Austrisë, 22 qershor 1972.
- Çështja Saraiva de Carvalho kundër Portugalisë, 22 Prill 1994, Seria A nr. 286-B.
- Çështja Solesbee kundër Balkcom, 339 U.S. 9 (1950).
- Çështja Sutter kundër Zvicrës 22 Shkurt 1984, Seria A nr.74.
- Çështja Sutter kundër Zvicrës 22 Shkurt 1984, Seria A nr.74. 404 Çështja Menet kundër Francës, 14 Qershor 2005
- Çështja Vayic kundër Turqisë, 20 Qershor 2006.
- Çështja Vermillo kundër Francës, 20 Shkurt 1991, Seria A nr. 198 dhe Çështja Dobbartin kundër Francës, 25 Shkurt 1993, Seria A nr 256 – D.
- Çështja, Fey kundër Austrisë, 24 Shkurt 1993.
- Çështja civile me nr. 570, Anna Vebi Nordstrom kundër Ferik Vebi Velija, (Vendimi Gjykatës Kushtetuese me nr. 35 datë 17.07.2013; Vendimi I Gjykatës së Lartë me nr. 454 datë 18.10.2012; Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 6144 datë 03.06.2013; Vendimit i Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. 3315 datë 07.10.2014).
- GJEDNJ, Driza kundër Shqipërisë, vep. cit., fq.116.
- Vendim i GJK, nr.2/1992.

- Vendim i GJL, Lochner kundër New York, 198 U.S 45 (1905).
- Vendim i GJL, Murray's Lessee k. Hoboken Land & Improv.Co. 59 U.S. 272 (1856).
- Vendim i GJL, Roe kundër Wades, 410 U.S. 113 (1973).
- Vendime të GJK, nr.10/1992; nr.4/1993.
- Vendime të GJK, nr.3/1992; nr.5/1992.
- Vendime të GJK, nr.5/1992; nr.6/1992; nr.11/1992; nr.4/1994; nr.8/1994; nr.9/1995.
- Vendimet dt. 26 nëntor 1982 F. Lombardo k. Italisë dhe G. Lombardo. k Italisë
- Vendimi dt. 26 shkurt 1993 në çështjen Salesi k. Italisë.
- Vendimi i GJL të SHBA Mayer k. Nebraskas, 262 U.S 390, 399 (1923).
- Vendimi nr, 76, dt. 25. 04. 2002 të Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, 2001-2002.
- Vendimi Nr. 8, dt. 25. 03. 2003 të Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, 2003.
- Vendimi Nr. 517 Akti, Nr. 330 , Gjykata e Apelit Tiranë, Kolegji Penal.